



KRIMET SPECIALE NË KOSOVË

Prishtinë, nëntor 2020

Autorë: Leotrim Gashi dhe Mirvet Thaqi

Ekipi redaktues: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Gzim Shala dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rrustem Statovci

Prishtinë

E: info@kli-ks.org

www.kli-ks.org

Nëntor, 2020

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**

Supporting freedom around the world

Përmbajtja

1.	Përmbledhje ekzekutive.....	6
2.	Metodologjia.....	8
3.	Korniza ligjore dhe praktika ndërkombëtare për gjykim të drejtë.....	9
4.	Garancitë kushtetuese dhe korniza ligjore të sistemit gjyqësor në Kosovë.....	15
4.1.	Mandati ligjor i PSRK-së.....	16
4.2.	Kompetencat e veçanta dhe plotësuese të PSRK-së.....	18
5.	Performanca e PSRK-së në ndjekjen penale në vitet 2016 - 2019.....	19
5.1.	Numri i prokurorëve të angazhuar në PSRK.....	19
5.2.	Efikasiteti i prokurorëve të PSRK-së gjatë viteve 2016-2019.....	21
5.3.	Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga PSRK-së gjatë viteve 2016-2019.....	23
5.4.	Aktgjykimet sipas akteve akuzuese të PSRK-së gjatë viteve 2016-2018.....	24
6.	Vendimet e PSRK-së sipas veprave karakteristike për persona, sipas Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional (MPN) për vitet 2016-2019.....	27
6.1.	Vendimet e PSRK-së sipas veprave karakteristike për persona, sipas Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për vitin 2016.....	27
6.2.	Vendimet e PSRK-së sipas veprave karakteristike për persona, sipas Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për vitin 2017.....	28
6.3.	Vendimet e PSRK-së sipas veprave karakteristike për persona, sipas Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për vitin 2018.....	29
6.4.	Vendimet e PSRK-së sipas veprave karakteristike për persona, sipas Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për vitin 2019.....	29
7.	Dështimi i PSRK-së përballë korrupsionit të profilit të lartë dhe rasteve të shënjestruara në periudhën 2016-2019.....	31
8.	Vendimet gjyqësore të aktakuzave të PSRK-së për profilin e lartë.....	32
9.	Trajtimi i krimeve të luftës nga ana e PSRK-së.....	35
9.1.	Ngarkesa me lëndë të krimeve të luftës në PSRK.....	35
10.	Transparenca e PSRK-së gjatë vitit 2019.....	37
11.	Krijimi dhe mandati ligjor i Departamentit Special (DS) të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit.....	38
11.1.	Rruga deri te krijimi i DS-së.....	38
11.2.	Mandati ligjor i DS-së.....	40
11.3.	Parregullsitë në funksionalizimin e DS-ve.....	40
11.4.	Mos pajtimet e gjyqtarëve të Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore në Prishtinë me Ligjin për Gjykatat.....	43
12.	Ngarkesa me lëndë e Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë gjatë vitit 2019 dhe efikasiteti i saj.....	45

13.	Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rasteve dhe punën e Departamentit Special	49
14.	Departamenti Special i Gjykatës së Apelit.....	54
15.	Anex 1. Analizë e rasteve karakteristike të trajtuara nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë	56
16.	Trajtimi i rasteve të terrorizmit nga Republika e Kosovës.....	65
16.1.	Gjetjet kryesore të IKD-së në trajtimin e rasteve të terrorizmit në Departamentin Special	70
17.	Anex 2. Analiza e rasteve të terrorizmit.....	75
18.	Përfundimet	104
19.	Rekomandimet.....	107

Lista e shkurtesave

DKR	Departamenti i Krimeve të Rënda
DP	Departamenti i Përgjithshëm
DS	Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit
DUDNJ	Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut
GJEDNj	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
KEDNJ	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës
MTPN	Tribunalet Penale Ndërkombëtare
NHKL	Njësia për hetimin e krimeve të luftës të Policisë së Kosovës
PK	Policia e Kosovës
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
PSH	Prokurori i Shtetit
TNPJ	Tribunali Ndërkombëtarë Penal për ish-Jugosllavinë

1. Përmbledhje ekzekutive

Në vitin 2008, Kuvendi i Republikës së Kosovës me ligj të veçantë kishte themeluar PSRK-së, derisa një departament ekuivalent në gjyqësor ishte themeluar në vetëm në vitin 2019, përkatësisht Departamenti Special për Rastet e PSRK-së në Gjykatën Themelore në Prishtinë dhe Gjykatën e Apelit.

Raportet e institucioneve ndërkombëtare si të Departamentit Amerikan të Shtetit dhe Raporti i Progresit për Kosovën i Bashkimit Evropian, ashtu edhe në ato të organizatave jo qeveritare në vend, pasqyrojnë se Kosova është ende larg luftës efektive kundër korrupsionit, e veçanërisht të korrupsionit të profilit të lartë.

Edhe pse në raportet vjetore, PSRK-ja numrin më të madh të aktakuzave i ka ngritur për vepra penale të korrupsionit, në bazë të analizës së IKD-së, rezulton se të gjitha aktakuzat e PSRK-së ndaj të akuzuarve të profilit të lartë, kanë dështuar.

Nga monitorimi i punës së PSRK-së, IKD gjen se kjo prokurori ka treguar efikasitet të ulët, përkundër rritjes së numrit të prokurorëve. Përderisa në fillim të vitit 2016 kjo prokurori ka pasur 541 lëndë të pazgjidhura, në fund të vitit 2019 e njëjta prokurori ka lënë të pazgjidhura gjithsej 1,799 lëndë. Përgjatë katër (4) viteve, PSRK nuk ka arritur që të zgjidhë lëndë aq sa edhe ka pranuar. Përgjatë këtyre katër (4) viteve, në mesatare, prokurorët e PSRK-së kanë arritur përmbushjen e normës orientuese vetëm në vitin 2019, derisa këtë normë nuk e kanë arritur në tri (3) vitet e tjera. Raporti në mes të lëndëve të zgjidhura dhe atyre të pranuar në PSRK ka një bilanc të theksuar negativ, që nënkupton se stabiliteti me lëndë në PSRK vetëm sa është duke pësuar regres, dhe asnjë progres minimal. Në këtë drejtim, IKD vlerëson se kjo situatë është alarmante, jo për nga numri i lëndëve, por nga trendi i arritjes së stabilitetit.

Gjatë vitit 2016, në kohën kur kishte vetëm 10 prokurorë, PSRK ka ngritur aktakuza ndaj 352 personave, ndërsa një vit më pas edhe pse me 14 prokurorë, nuk ka ngritur aktakuza as sa gjysma e vitit paraprak. Në vitin 2017 kjo prokurori ka ngritur aktakuza vetëm ndaj 209 personave, ndërsa trendi më negativ ka ndodhur në vitin 2018, ku 15 prokurorë, kanë arritur të ngritin aktakuza vetëm ndaj 98 personave, ndërsa në vitin 2019, 14 prokurorë kanë ngritur aktakuza ndaj 144 personave.

Gjykatat e Kosovës, sipas Raportit të Punës të PSH-së për vitin 2017, kanë shpallur fajtorë 38 persona që ishin akuzuar nga PSRK, ndërsa në vitin 2018, ishin shpallur fajtorë 99 persona, kurse në vitin 2019, janë shpallur fajtorë 26 persona.

Edhe pse në të gjitha raportet e punës së Prokurorit të Shtetit, theksohet se puna e PSH-së është transparente për publikun, nga të dhënat lidhur me kërkesat për qasje në dokumente zyrtare dhe informata që IKD duke u bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike ka parashtruar në PSRK, rezulton se kjo prokurori ka një qasje jo-transparente përballë publikut, e cila qasje manifestohet nëpërmjet mos zbatimit të dispozitave ligjore të përcaktuara në Ligjin nr.06/L-081 për Qasje në Dokumentet Publike.

Që nga themelimi i DS e deri më 31 dhjetor 2019, DS i Gjykatës Themelore në Prishtinë ka shpallur 13 aktgjykime dënuese, ku shtatë (7) dënime janë me burgim efektiv, gjashtë (6) dënime me burgim me kusht dhe tre (3) dënime me gjobë. Gjatë kësaj periudhe kohore, ky departament nuk ka shpallur asnjë aktgjykim lirues. Në një rast, IKD ka gjetur se DS i Gjykatës Themelore në mënyrë të kundërligjshme kishte amnistuar dy (2) të pandehur nga dënimi me gjobë, duke shqiptuar vetëm dënim me burgim. Për të njëjtin vendim, PSRK nuk kishte ushtruar ankesë, derisa kundërligjshmëria ishte konstatuar edhe nga DS i Gjykatës së Apelit.

Sa i përket afateve ligjore, Departamenti Special ka arritur që në masë të madhe të procedojë me kohë me lëndët që kanë qenë objekt shqyrtimi, duke marrë parasysh faktin se gjyqtarët e këtij departamenti kanë pasur një numër jo aq të madh të lëndëve në punë gjatë kësaj periudhe raportuese.

Në anën tjetër, IKD që nga themelimi i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë e deri në mars të vitit 2020, ka monitoruar gjithsej 25 raste të terrorizmit, prej të cilave 28 persona janë të akuzuar, nga të cilët gjashtë (6) persona i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 22 persona të tjerë i takojnë gjinisë femërore. Nga këto 25 raste të monitoruara, procedura penale në shkallë të parë ka përfunduar ndaj 25 personave. Ndaj këtyre 25 personave, janë shqiptuar gjithsej 26 dënime. Ndërsa DS i GjTh në Prishtinë nuk ka shqiptuar asnjë aktgjykim lirues apo refuzues. Prej këtyre 25 aktgjykimeve dënuese, pesë (5) persona janë dënuar me burgim efektiv, 20 persona janë dënuar me kusht dhe ndaj një (1) personi krahas dënimit me burg, është shqiptuar edhe dënimi me gjobë.

Ndërsa, Departamenti i Gjykatës së Apelit, që nga funksionalizimi i tij e deri më 31 dhjetor 2019, ka pranuar 17 lëndë, prej të cilave shtatë (7) i kishte zgjidhur, ndërsa kishin mbetur të pazgjidhura 10.

2. Metodologjia

IKD me qëllim që të përpilojë një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, në lidhje me punën dhe vlerësimin e krimeve më të rënda të cilat ndëshkohen me konventa ndërkombëtare, Kodin Penal të Kosovës dhe ligjeve të tjera, të cilat ndjekjen nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës dhe Departamentit Special të Republikës së Kosovës, ka përdorur metodologji të përzier të hulumtimit.

Për draftimin e këtij hulumtimi, IKD ka përdorur dokumente të ndryshme zyrtare (legjislacionin primar dhe sekondar, raporte të ndryshme zyrtare të KGJK-së dhe KPK-së, si dhe të dhëna të tjera të siguruar nga këto institucione përmes kërkesave për qasje në dokumente publike).

IKD me qëllim të këtij hulumtimi ka bërë edhe intervista me akterët e sistemit gjyqësor dhe prokurorial.

Përpos këtyre, draftimi i këtij raporti është bazuar në monitorimin e drejtpërdrejtë të performancës së prokurorive dhe gjykatave në zbatimin e ligjit, politikave dhe planeve të veprimit për trajtimin e rasteve të PSRK-së dhe Departamentit Special. Për të dhënat e grumbulluara gjatë procesit të monitorimit të sistemit të drejtësisë, IKD tanimë ka lansuar për publikun edhe Platformën e Monitorimit të Gjyqësorit (<https://ejudiciary.org/>).

IKD bazuar në obligimet ligjore dhe planet e veprimit ka krijuar indikatorë të qartë për matjen e progresit dhe regresit të sistemit prokurorial dhe atij gjyqësor. Ky raport përfshin monitorimin e rasteve të Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, për periudhën kohore 1 korrik – 31 dhjetor 2019.

Ndërsa ka analizuar edhe punën dhe vendimmarrjen e prokurorëve të PSRK-së në periudhën kohore 1 janar 2016 - 31 dhjetor 2019. Për të njëjtën periudhë kohore, raporti i bënë një trajtim të veçantë rasteve të terrorizmit të cilat janë monitoruar nga IKD.

Lidhur me këtë IKD ka analizuar ngarkesën me lëndë, trendin e efikasitetit, mënyrën e zgjidhjes së lëndëve, si dhe performancën individuale të prokurorëve dhe gjyqtarëve etj. Për të gjitha këto, IKD në këtë raport ka dhënë edhe vlerësimet dhe rekomandimet.

Sa i përket rasteve të terrorizmit, IKD ka analizuar trajtimin e këtyre rasteve nëpër të gjitha fazat e procedurës penale, që nga ngritja e kallëzimit penal e deri në shpallje të aktgjykimit nga gjykatat e shkallës së parë, duke analizuar bazën ligjore si dhe politikën ndëshkimore.

Në këtë raport, fillimisht trajtohen të gjeturat kryesore për këto raste, ndërsa në anexet 1 dhe 2 të këtij raporti, trajtohen të gjeturat për secilin rast veç e veç.

3. Korniza ligjore dhe praktika ndërkombëtare për gjykim të drejtë

Të gjitha shtetet demokratike synojnë të ndërtojnë një sistem shoqëror të vlerave ku rendi dhe ligji garantohen në mënyrë të barabartë për të gjithë. Demokracitë e reja, në kuadër të të cilave bën pjesë edhe Kosova, janë kujdesur që në aspektin formal të garantojnë një paqe mes shtresave të ndryshme shoqërore, duke i kushtuar një rëndësi të veçantë lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, si kusht esencial për ndërtimin e shtetit të së drejtës.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e cila tash së fundmi ka festuar 12 vjetorin, bën pjesë në kuadrin e kushtetutave më moderne, e cila ndërtohet mbi bazën e ndërtimit të një rendi kushtetues dhe juridik i cili rend para së gjithash, mbron të drejtat e njeriut dhe liritë themelore. Mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore përcaktohet ndërtohet sipas kapitullit II të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili kapitull nuk mund t'i nënshtrohet as amendamentimit kushtetues nga Kuvendi i Republikës së Kosovës¹.

Tutje, Kushtetuta e Republikës së Kosovës rëndësi të veçantë i kushton edhe instrumenteve ndërkombëtare të nxjerra në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Me anë të nenit 22 të Kushtetutës, Kosova ka sanksionuar zbatimin e drejtpërdrejtë të tetë (8) instrumenteve ndërkombëtare, të cilat garantojnë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, si dhe kanë epërsi në rast konflikti me aktet vendore².

Ndërsa, interpretimi i të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, duhet të bëhet në harmoni me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNj)³.

GJEDNj ka për kompetencë të vlerësojë dhe konstatojë shkeljet e të drejtave që rrjedhin nga KEDNj, dhe vendimet e kësaj gjykate janë të detyrueshme për shtetet që e kanë ratifikuar konventën.

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut morën një vëmendje të veçantë pas luftës së dytë botërore ashtu që tanimë janë ndërtuar mekanizma jo vetëm kombëtare por edhe ndërkombëtare, për të mbikëqyrë, kontrolluar dhe vlerësuar respektimin efektiv të tyre. Pra fillimisht tentohet që të drejtat dhe liritë themelore të garantohen nga sistemet e brendshme të vetë shteteve, e në rastet kur këto shtete dështojnë të ofrojnë mbrojtje efektive, secili individ

¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar më 9 prill 2008. “Ndryshimet në këtë Kushtetutë mund të miratohen nga Kuvendi vetëm pasi të ketë adresuar Kryetari i Kuvendit të Kosovës amendamentin e propozuar në Gjykatën Kushtetuese për të vlerësuar paraprakisht nëse ndryshimi i propozuar nuk pakëson ndonjë të drejtë dhe liritë e përcaktuara në Kapitullin II të Kushtetutës”.

² Po aty. Neni 22. “Të drejtat dhe liritë e njeriut të garantuara me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare në vijim, garantohen me këtë Kushtetutë, zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike: (1) Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut; (2) Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollit e saj; (3) Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollit e saj; (4) Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare; (5) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor; (6) Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas; (7) Konventa për të Drejtat e Fëmijës; (8) Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Më të Rënda, Jonjerëzore dhe Poshtëruese”.

³ Po aty. Neni 53. “Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

ka të drejtë të kërkojë mbrojtje të këtyre të drejtave themelore edhe nga mekanizmat ndërkombëtarë, të themeluar sipas të drejtës ndërkombëtare. Mbi këtë logjikë, është ndërtuar edhe kriteri i ezaurimit apo shterjes së mjeteve juridike kombëtare, para se një shtetas i një shteti anëtar i Këshillit të Evropës t’i drejtohet GjEDNj-së.

Krahas kapitullit të dytë, janë edhe shumë dispozita tjera kushtetuese të cilat përcaktojnë detyrimin e autoriteteve publike që gjatë zbatimit të autorizimeve të tyre të sigurojnë respektimin e këtyre të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të parapara me kushtetutë dhe instrumente ndërkombëtare⁴.

Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat dhe me të drejtë gjykatave u janë dhënë autorizimet që ndër të tjera duhet të garantojnë respektimin dhe mbrojtjen efektive të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, të garantuara me këtë Kushtetutë dhe me akte tjera të cilat përbëjnë rendin juridik në Republikën e Kosovës.

Kushtetuta e Kosovës ka absorbuar edhe një sërë parimesh dhe të drejta thelbësore, të cilat për shkak të rëndësisë së tyre mund të identifikohen si postulate kushtetuese, veçanërisht në fushën e drejtësisë penale. Si parime të tilla mund të listohen parimi i sundimit të ligjit, barazia para ligjit, ndalimi i torturës dhe trajtimit ç ‘njerëzor e drejta e lirisë dhe sigurisë, e drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, e drejta për mjete juridike, parimi i legalitetit dhe proporcionalitetit në të drejtën penale, parimi “*ne bis in idem*” dhe një sërë parimesh e të drejtash tjera themelore, të parapara me këtë Kushtetutë.

E drejta e përdorimit të mjetit efektiv juridik është garantuar në nenin 32 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ku është përcaktuar e drejta e çdo personi që të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative, përmes të cilave sipas ankuesit mund të cenohen të drejtat apo interesat e tij të parapara me ligj. Një postulat i tillë është inkorporuar edhe në nenin 8 të Deklaratës Universale për e të Drejtat e Njeriut (DUDNj), ku thuhet se “*Gjithkush ka të drejtë për mjete juridike të frytshme para gjykatave kompetente kombëtare për veprimet me të cilat shkelen të drejtat themelore të garantuara nga kushtetuta ose ligjet*”. E drejta për ankim efektiv është një e drejtë themelore e njeriut që nënkupton të drejtën e individit për ankim, pastaj prezumon ekzistencën e një organi të caktuar që do të shqyrtojë një ankimim të tillë, afate të arsyeshme për shqyrtimin e tij, një shqyrtim objektiv dhe një kontroll gjyqësor të saj. Po ashtu, kjo e drejtë sanksionohet edhe me nenin 13 të KEDNj-së, në të cilin nen përcaktohet se “*Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtar*”.

Po ashtu, ndalimi i diskriminimit dhe barazia para ligjit përbëjnë njërin ndër parimet bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, dhe si i tillë ky parim është sanksionuar në nenin 3 të saj, ku nënvizohet se “*Republika e Kosovës është shoqëri shumetnike, e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet tjera e cila qeveriset në mënyrë demokratike, me respektim të plotë të sundimit të ligjit, përmes institucioneve të veta legjislative, ekzekutive dhe gjyqësore*”. Barazia para ligjit

⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e miratuar më 9 prill 2008, Neni 3.2.

është proklamuar edhe në nenin 7 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut⁵ dhe në nenin 14 të KEDNJ⁶, dhe të dyja këto instrumente ndërkombëtare parashohin se gëzimi i të drejtave dhe lirive të përcaktuara me këto dy dokumente duhet siguruar për të gjithë personat dhe pa asnjë lloj dallimi, si dhe garantojnë mbrojtje efektive në rast të diskriminimit në baza të caktuara, të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike apo çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Tutje, e drejta për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm po ashtu përbën një të drejtë themelore të individëve, e cila e inkorporuar në nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës përcakton se çdo personit i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve tjera shtetërore dhe bartësve tjerë shtetërorë. Ndër të tjera, në paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet e drejta e çdo personi që çështja e tij të dëgjohet në një shqyrtim publik, të drejtë dhe të paanshëm, sa i përket vendimeve që ndërliidhen me të drejtat dhe obligimet e tij ose për çfarëdo akuze penale të ngritur ndaj tij. Pra, kushtetuta përcakton se realizimi i këtyre të drejtave duhet të bëhet nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e themeluar me ligj.

Sipas kësaj rezulton se asnjë pushtet tjetër nuk mund të shërbejë si gjykatë, se askush nuk mund të ndërhyjë në procesin e ndarjes së drejtësisë dhe se askujt nuk i lejohet që të vë në diskutim vlerën e këtyre vendimeve apo të refuzojë zbatimin e vendimeve të plotfuqishme. Kjo shërben si garanci se vendimet do të merren jo nga institucione politike, por nga gjykata kompetente, e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, pastaj se kjo çështje do të dëgjohet në një shqyrtim të hapur, ku nuk përjashtohet pjesëmarrja e publikut, parakushte këto që ndikojnë në forcimin e transparencës dhe besimit të publikut në procesin e administrimit të drejtësisë. Për më tepër, sa i përket publicitetit të gjykimit, GjEDNJ në një vendim të saj kishte theksuar se është pikërisht publiciteti i gjykimit që mbron qytetarët nga administrimi i drejtësisë në mënyrë të fshehur⁷.

Po ashtu, neni 31 ndërthen në vete edhe parime të tilla si prezumimi i pafajësisë, të drejtën e të akuzuarve për tu informuar lidhur me akuzën që u ngarkohet, në gjuhën që ata e kuptojnë dhe e flasin, të drejtën e të akuzuarit për të bërë pyetje dhe që të kërkojë paraqitjen e provave, publicitetin e gjykimin dhe mbylljen e tij vetëm në rastet e përcaktuara me ligj etj.

⁵ Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut. Miratuar më 10 dhjetor 1948. neni 7. “*Të gjithë janë të barabartë para ligjit dhe kanë të drejtë pa asnjë diskriminim të mbrohen barabar nga ligji. Të gjithë kanë të drejtën për t’u mbrojtur barabar kundër çdo diskriminimi që cenon këtë Deklaratë, si dhe kundër çdo nxitje për një diskriminim të tillë*”.

⁶ Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Miratuar në vitin 1950. Neni 14. “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*”.

⁷ “*Gjykata rithekson se mbajtja publike e seancave gjyqësore përbën një parim themelor të sanksionuar në paragrafin 1 të neni 6 të KEDNJ. Ky karakter publik i mbron palët ndërgjyqëse kundër administrimit të drejtësisë në mënyrë të fshehur pa shqyrtim publik. Gjithashtu, është një nga mënyrat me anë të së cilës mund të mbahet besimi në gjykata. Duke e bërë administrimin e drejtësisë në mënyrë transparente, publiciteti kontribon në arritjen e qëllimit të paragrafit 1 të neni 6 të KEDNJ, që nënkupton një gjykim të drejtë, garancion, i cili është një nga parimet themelore të çdo shoqërie demokratike, brenda kuptimit të KEDNJ*”. GjEDNJ. Malhous kundër Republikës së Çekisë. Paragrafi 55 dhe 56.

Roli i gjykatave të pavarura dhe të paanshme është një nga elementet themelore të funksionimit të sundimit të ligjit në kuadër të një sistemi juridik. E drejta për një proces të rregullt gjyqësor është përcaktuar edhe në nenin 6 të KEDNJ dhe përfshinë po ato garanci themelore të cilat kanë shërbyer si model dhe janë adoptuar edhe në nenin 31 të Kushtetutës sonë⁸.

Në vijim do të paraqiten edhe disa vendime gjyqësore nga jurisprudenca e GjEDNJ-it, lidhur me mbrojtjen efektive të të drejtave dhe lirive të garantuara me KEDNJ, me theks të veçantë në nenin 6 kësaj konvente, që proklamon të drejtën për një proces të rregullt gjyqësor.

Në çështjen “*Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë*”, GjEDNJ ka konstatuar shkelje të së drejtës për shkak të kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore. Lidhur me këtë, GjEDNJ u shpreh se: “*Problemi kryesor në çështjen në fjalë, të cilin Gjykata e ka shqyrtuar edhe në një çështje të mëparshme kundër shtetit të paditur, është kthimi i shpeshtë i çështjeve për rigjykim nga gjykatat më të larta te gjykatat më të ulëta. Gjykata është e mendimit se kjo vonesë i atribuohet tërësisht gjykatave të vendit. Në këtë rast procesi penal zgjati 6 vjet dhe 11 muaj, zgjatje e cila çoi në një shkelje që i atribuohet gjykatave të brendshme*”⁹.

Shkelja e parimit të sigurisë juridike, që presupozon parimin e çështjes (gjësë) së gjykuar dhe është atribut kryesor i një vendimi të formës së prerë është vlerësuar nga GjEDNJ në çështjen “*Xheraj kundër Shqipërisë*”.

Në këtë rast GjEDNJ ka konstatuar se vendimi i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë për të prishur vendimin e pafajësisë ishte një shkelje e parimit të sigurisë juridike dhe në këtë rast GjEDNJ ka tërhequr vëmendjen se nuk mund të lejohet rivendosja për të bërë ankim kundër vendimit gjyqësor të formës së prerë kur nuk ka arsye serioze ligjore që e lejojnë atë sikurse është konstatuar kjo praktikë e pranuar nga gjykatat e brendshme.¹⁰

Pra, sipas këtij vlerësimi të dhënë nga GjEDNJ, rezulton se asnjë palë nuk ka të drejtë të kërkojë rigjykimin e një çështjeje e cila është vendosur në formë të prerë, përveç nëse një rrethanë e tillë vlerësohet e domosdoshme dhe kur vërtetohen rrethana thelbësore dhe të pakontestueshme. Pra vendimet gjyqësore të formës së prerë parimisht janë shprehje e

⁸ KEDNJ, Neni 6.1. “*Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose të çdo akuze penale kundër tij, çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Vendimi duhet të jepet publikisht, por prania në sallën e gjykatës mund t'i ndalohet shtypit dhe publikut gjatë tërë procesit ose gjatë një pjese të tij, në interes të moralit, të rendit publik ose sigurisë kombëtare në një shoqëri demokratike, kur kjo kërkohet nga interesat e të miturve ose mbrojtja e jetës private të palëve në proces ose në shkallën që çmohet tepër e nevojshme nga gjykata, kur në rrethana të veçanta publiciteti do të dëmtojte interesat e drejtësisë. 2. Çdo person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm, derisa fajësia e tij të provohet ligjërisht. 3. Çdo i akuzuar për një vepër penale ka të drejtat minimale të mëposhtme: a) të informohet brenda një afati sa më të shkurtër, në një gjuhë që ai e kupton dhe në mënyrë të hollësishme, për natyrën dhe për shkakun e akuzës që ngrihet ndaj tij; b) t'i jepet koha dhe lehtësitë e përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes; c) të vetëmbrohet ose të ndihmohet nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij ose, në qoftë se ai nuk ka mjete të mjaftueshme për të shpërblyer mbrojtësin, t'i mundësohet ndihma ligjore falas kur këtë e kërkojnë interesat e drejtësisë; d) të pyesë, ose të kërkojë që të merren në pyetje dëshmitarët e akuzës dhe të ketë të drejtën e thirrjes dhe të pyetjes të dëshmitarëve në favor të tij, në kushte të njëjta me dëshmitarët e akuzës; e) të ndihmohet falas nga një përkthyes, në qoftë se nuk kupton ose nuk flet gjuhën e përdorur në gjyq*”.

⁹ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Kaçiu dhe Kotorri kundër Shqipërisë. Nr 33192/07 dhe 33194/07. Aktgjykim. Strasburg. 9 dhjetor 2013.

¹⁰ Po aty. Rasti Xheraj kundër Shqipërisë. Nr. 37959/02. Strasburg. 1 dhjetor 2008. paragrafi 70.

konkretizimit të së drejtës mbi një marrëdhënie juridike dhe synon që kësaj marrëdhënie t'i japë qartësi dhe siguri, dhe cenimi i këtij parimi është cenim i vet sigurisë juridike.

Prezumimi i pafajësisë, si një ndër elementet më të rëndësishme në një proces gjyqësor në lëmin penal, lidhet me një sërë parimesh të tjera, si detyrimi për të mos u vetë fajësuar, pastaj detyrimi për tu dëgjuar para se të gjykohesh etj. Nga ky parim rrjedh detyrimi që ka shteti për të provuar akuzën kundrejt të pandehurit dhe rregullon çështjen e barrës së provës në procedurë penale. Ky parim universal është adresuar nga GjEDNJ edhe në çështjen “*Telfner kundër Austrisë*”, ku GjEDNJ ka gjetur se prezumimi i pafajësisë shkelet në qoftë se barra e provës kalohet nga akuza tek mbrojtja, duke i kërkuar një të akuzuari që të japë shpjegime ndërkohë që akuza nuk e ka parashtruar akuzën e saj kundër tij qoftë edhe prima facie¹¹.

E drejta për tu mbrojtur vetë ose nëpërmjet një mbrojtësi përbën një ndër elementet qenësore që garantojnë një proces të rregullt gjyqësor dhe barazinë e armëve në kuadër të saj. Në jurisprudencën e GjEDNJ-it është përcaktuar se mundësia që një i akuzuar të konsultohet me mbrojtësin e tij është thelbësore për përgatitjen e një mbrojtje sa më efektive. Kjo është afirmuar edhe në vendimin e GjEDNJ-it të nxjerrë në çështjen “*Lanz kundër Austrisë*”. Gjatë adresimit të këtij rasti, Gjykata vuri në dukje se mbikëqyrja nga ana e një gjyqtari hetimor të kontakteve të një të paraburgosuri me avokatin e tij mbrojtës përbënte një ndërhyrje të rëndë në të drejtat e të akuzuarit për t'u mbrojtur dhe arsye shumë të forta do të duhej të jepeshin për të arritur në justifikimin e saj. Sipas këtij vendimi, gjykatat ose qeveria austriake nuk kishin ofruar argumente bindëse në këtë drejtim dhe Gjykata me unanimitet kishte vendosur se ka pasur shkelje të nenit 6 § 3 (b) dhe (c) të Konventës, pra të së drejtës për kohë dhe mundësi të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe të së drejtës për t'u mbrojtur vetë ose me anë të ndihmës ligjore të zgjedhur lirisht¹².

Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka paraparë edhe mundësinë e ofrimit të ndihmës juridike falas ndaj të akuzuarve që nuk kanë mjete financiare, kur vlerësohet se një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasje efektive në drejtësi¹³.

Për mundësinë e caktimit të një mbrojtësi të tillë, jurisprudenca e GjEDNJ-it ka vlerësuar se organet proceduese nuk duhet të mjaftohen vetëm në caktimin e ndihmës juridike falas, por edhe të ndërhyjnë në rastet kur ekzistojnë shkaqe që sjellin për pasojë mos realizimin e kësaj të drejte.

Kjo është bërë e ditur në rastin “*Kamasinski kundër Austrisë*”, ku GjEDNJ-i ka vendosur një standard sipas të cilit “*Shtetet nuk janë përgjegjës për të metat profesionale të avokatëve dhe nuk mund të ndërhyjnë në realizimin e mbrojtjes, si një çështje midis të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij. Por kur mbrojtësi, për shkaqe objektive apo për shkak të neglizhencës së tij, nuk e realizon*

¹¹ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Telfner kundër Austrisë nr. 33501/96. Aktgjykim. Strasburg. 20 mars 2001.

¹² Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Lanz kundër Austrisë nr. 24430/94. Aktgjykim. Strasburg. 31 janar 2002.

¹³ Kushtetuta e Kosovës. Miratuar më 9 prill 2008. Neni 31.6.

mbrojtjen, atëherë shteti duhet të ndërhyjë duke e zëvendësuar atë apo nëpërmjet dhomës së avokatisë, duke e detyruar të bëjë detyrën e tij”¹⁴.

Në çështjen *Balliu kundër Shqipërisë*, GjEDNj-i ka trajtuar një problem të rëndësishëm sa i takon mosparaqitjes së avokatit mbrojtës të zgjedhur prej të pandehurit me marrëveshje. GjEDNj-i kishte konstatuar se një subjekt – në rastin konkret një individ - nuk mund të pretendojë që t'i lindin të drejta nga qëndrime të tij të paligjshme ose nga mos-ushtrimi i këtyre të drejtave në instanca të mëparshme. Në këto kushte, përderisa kërkuesi në këtë çështje nuk kishte bërë përpjekje që të kishte një proces të rregullt përpara juridiksioneve shqiptare, qoftë për mangësi të tij, qoftë të avokatit, nuk mund të pretendonte se i lindnin të drejta në dëm të shtetit shqiptar.¹⁵

Në çështjen *“Rachdad kundër Francës”*, GjEDNj-i ka bërë të qartë edhe një herë se nëse një dënim bazohet vetëm në provat me të cilat i dënuari nuk ka pasur mundësi të ballafaqohet dhe t'i kundërshtojë, atëherë kemi shkelje të nenit 6 të Konventës. Pra, sipas jurisprudencës së GjEDNj-it nëse një dënim është bazuar vetëm provat që i akuzuari nuk ka pasur mundësi t'i kundërshtojë përbën shkelje apo do të ishte i papajtueshëm me nenin 6 të konventës.¹⁶

¹⁴ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Kamasinski kundër Austrisë. Nr. 9783/82. Aktgjykim. Strasburg. 19 dhjetor 1989.

¹⁵ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti Balliu kundër Shqipërisë. Nr. 74727/01. 16 nëntor 2005.

¹⁶ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rachdad kundër Francës. Nr. 71846/01. Strasburg. Aktgjykim. 13 nëntor 2003.

4. Garancitë kushtetuese dhe korniza ligjore të sistemit gjyqësor në Kosovë

Republika e Kosovës përmes Kushtetutës së saj ka përcaktuar në mënyrë të qartë ndarjen e pushteteve në funksionimin e saj. Përderisa pushtetin legjislativ do ta ushtroj Kuvendi i Kosovës, atë ekzekutiv do ta ushtroj Qeveria, ndërsa të ndarë nga këto dy pushtete, pushtetin gjyqësor do ta ushtrojnë gjykatat.

Në lidhje me pushtetin gjyqësor, Kushtetuta përcakton parimet e përgjithshme të tij. “*Pushteti gjyqësor në Republikën e Kosovës ushtrohet nga gjykatat*”¹⁷ dhe “*Pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë, apolitik e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata*”¹⁸. Kushtetuta po ashtu ka përcaktuar se organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i gjykatave të rregullta do të rregullohet përmes ligjit.

Kuvendi i Kosovës në korrik të vitit 2010, kishte miratuar ligjin nr. 03/L-199 për Gjykatat, me të cilin ishte plotësuar kërkesa e Kushtetutës për organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësorë, mirëpo shumica e neneve të këtij ligji, kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2013¹⁹.

Mirëpo ky ligj, pas dy (2) plotësim-ndryshimeve,²⁰ njërin në vitin 2012 e tjetri në vitin 2015, ishte shfuqizuar me Ligjin nr. 06/L - 054 për Gjykatat, i cili ka hyrë në fuqi më 3 janar 2019. Ky ligj, me nenin 7 të saj, ka siguruar qasje dhe trajtim të barabartë për të gjithë qytetarët e Kosovës, të cilët kërkojnë drejtësi në gjykatë²¹.

Me anë të këtij ligji është përcaktuar se sistemi i gjykatave në Kosovë përbëhet nga shtatë (7) gjykata themelore dhe me degë të saj, në shtatë (7) rajone të Kosovës, si gjykata të shkallës së parë, ndërsa si instancë e dytë gjyqësore është përcaktuar Gjykata e Apelit, derisa si shkallë e fundit e gjyqësorit të rregullt, është përcaktuar Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, me këtë ligj përcaktohet edhe organizimi i brendshëm i secilës prej gjykatave. Gjykatat Themelore në kuadër të saj përfshijnë Departamentin e Krimeve të Rënda, Departamentin për të Mitur dhe Departamentin e Përgjithshëm. Derisa në shtatë (7) seli të këtyre gjykatave funksionojnë të gjitha departamentet, në degët e gjykatave funksionojnë vetëm Departamenti i Përgjithshëm, me tri (3) divizionet e tij (Penal, Civil, Kundërvajtje).

Por për dallim nga gjashtë (6) gjykatat e tjera themelore, në Gjykatën Themelore në Prishtinë përpos këtyre departamenteve, funksionojnë edhe Departamenti Special për Lëndët e PSRK-së²², Departamenti për Çështje Administrative dhe Departamenti për Çështje Ekonomike.

¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Miratuar më 9 prill 2008. Neni 102.1.

¹⁸ Po aty. Neni 102.2.

¹⁹ Ligji nr. 03/L-199 për Gjykatat. Neni 43.

²⁰ Ligji nr. 04/l-171 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 03/l-199 për Gjykatat; Ligji nr. 05/l -032 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/l-199 për Gjykatat.

²¹ Ligji Nr. 06/L - 054 për Gjykatat. Neni 7.

²² *Shënim*: Themelimi i Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, është përcaktuar me Ligjin nr. 06/l - 054 për Gjykatat.

Sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, institucioni i Prokurorit të Shtetit është autoriteti i pavarur dhe përgjegjës për ndjekjen penale të personave të akuzuar për ndonjë veprë penale ose për ndonjë veprë tjetër, sikurse është rregulluar me ligj²³. Ngjashëm si me sistemin gjyqësor, edhe për Prokurorin e Shtetit, Kushtetuta ka përcaktuar se organizimi, kompetencat dhe detyrat e Prokurorit të Shtetit përcaktohen me ligj.

Për të zbatuar këtë obligim kushtetues, Kuvendi i Kosovës në shtator të vitit 2010, ka miratuar Ligjin nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i cili ka hyrë në fuqi më 1 janar 2013 dhe ka pasur dy ndryshime dhe plotësime.²⁴ Edhe sistemi prokurorial është i ndarë në shtatë (7) prokurori themelore dhe Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK)²⁵, që vepron para gjykatave të shkallës së parë, Prokuroria e Apelit, që vepron për lëndët që trajtohen në Gjykatën e Apelit dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKSH), me mandat ekskluziv në lëndët e iniciuara sipas mjeteve të jashtëzakonshme juridike.

Kushtetuta, me qëllim të sigurimit të pavarësisë, paanshmërisë, pasqyrimin e multietnicitetit, rekrutimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve ka përcaktuar edhe funksionimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Këshillit Prokurorial të Kosovës, të cilat si kategori kushtetuese, rregullohen me ligje të veçanta²⁶.

4.1. Mandati ligjor i PSRK-së

Themelimi i PSRK-së si prokurori e specializuar, që do të vepronte në kuadër të Prokurorit të Shtetit, është bërë me Ligjin nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës.

Themelimi i kësaj prokurorie ishte bërë në kohën kur veç sa kishte filluar Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë, i njohur ndryshe si EULEX. Me anë të këtij ligji ishte paraparë që zyra e PSRK-së të përbëhej prej 10 prokurorëve vendor dhe pesë (5) të tjerë

²³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Miratuar më 9 prill 2008. Neni 109.1.; Shënim: Ky nen i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përbën një lëshim gjuhësor në dy aspekte. Fillimisht, Prokurori i Shtetit nuk bënë ndjekjen penale të personave të akuzuar, por ndjekjen penale të personave të dyshuar. Mbi bazën e dyshimit të bazuar mirë, Prokurori i Shtetit pas përfundimit të hetimit ngritë aktakuzë, për të cilën arsye ky institucion njihet edhe si “organi i akuzës”. Në anën tjetër, Prokurori i Shtetit mund të bëjë ndjekje penale vetëm nën dyshimin për kryerjen e një veprë penale, dhe asnjë veprë tjetër, siç përcaktohet me këtë nen të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Ky lëshim nuk është reflektuar në ligje, ku të njëjtat janë ndërtuar duke evituar këto dy lëshime të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

²⁴ Shënim: Ligji Nr. 05/L-034 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit nr.03/L-225 për Prokurorin e Shtetit dhe Ligji Nr. 06/L -025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L-034.

²⁵ Shënim: Themelimi dhe funksionimi i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, si prokurori e specializuar është bërë me ligjin special “Ligji nr.03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës”. Ky ligj është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 13 mars 2008 dhe ka pasur vetëm dy(2) plotësim-ndryshime (2014 dhe 2016)

²⁶ Shënim: Ligji nr. 06/l-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe Ligji Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

të misionit të EULEX-it, ndërsa kryeprokuror i kësaj prokurorie do të ishte nga misioni i EULEX -it, e zëvendës i tij, një prokuror vendor²⁷.

Duke marrë parasysh se misioni i EULEX-it, në atë kohë kishte kompetencat kryesore në hetimin dhe akuzimin e të dyshuarve për vepra penale, me këtë ligj ishte paraparë që Kryeprokurori i PSRK-së të jetë nën mbikëqyrje të Kryeprokurorit të EULEX-it.

Në prill të vitit 2014, ishte bërë ndryshimi i Ligjit për Prokurorisë Speciale dhe sipas tij nuk ishte vendosur me numër specifik se sa prokuror të EULEX-it do të angazhoheshin në PSRK, por ishte përcaktuar që kjo do të varej nga vendimi i përbashkët i Misionit të EULEX-it dhe KPK-së, ndërsa ishte larguar dispozita që prokurorin e misionit ndërkombëtarë e bënte Kryeprokuror të PSRK-së, ngase me ligjin e ndryshuar, një prokuror ndërkombëtarë do të ishte vetëm zëvendës i Kryeprokurorit të Shtetit, i cili do t'i udhëhiqte prokurorët e EULEX-it, të angazhuar në PSRK.²⁸

Mirëpo, me këtë ndryshim të ligjit, ishte shtuar një dispozitë e re, sipas të cilës, në PSRK do të krijohesh një Task-Forcë Speciale Hetuese (SITF) si njësit i pavarur nga PSRK e Kryeprokurori i Shtetit dhe me autonomi të plotë. *“SITF nuk do t'i nënshtrohet udhëheqjes apo mbikëqyrjes së Kryeprokurorit apo Zëvendës Kryeprokurorit të PSRK-së, as mbikëqyrjes së përgjithshme të Kryeprokurorit të Shtetit. Prokurorët dhe hetuesit e SITF do të kenë kompetencat e Prokurorëve të EULEX-it dhe Policisë së EULEX-it siç është rregulluar me Ligjin Nr. 03/L-053 mbi Juridiksionin dhe Kompetencat e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë”*.

Ndërsa edhe me plotësim/ndryshimin e Ligjit nr.03/l-225 për Prokurorin e Shtetit, ishte vendosur që Kryeprokurori i Shtetit, nuk do të mund të merr nën juridiksion të tij, raste të cilat i janë caktuar një prokurori të EULEX-t, pa pëlqimin e Kryeprokurorit të këtij misioni²⁹.

Ligji i PSRK-së, kishte ndryshuar edhe në qershorin e vitit 2016, ku në procesin e tranzicionit të kalimit gradual të kompetencave nga prokurorët e EULEX-it tek ata vendorë dispozitat të cilat parashihnin që zëvendës prokurori i PSRK-së të jetë nga misioni i EULEX-it dhe që ai të udhëhiqte prokurorët e tjerë të këtij misioni, ishin hequr nga ligji³⁰.

Mandati i misionit të EULEX-it, kishte përfunduar më 15 qershor 2018, ashtu siç ishte përcaktuar me Ligjin Nr. 05/l-102 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë³¹.

²⁷ Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Neni 15.

²⁸ Ligji nr. 04/l -273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovës. Neni 2.6.
Po aty. Neni 15.A.

²⁹ Ligji nr. 05/l-034 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.03/l-225 për Prokurorin e Shtetit. Neni 32/A.

³⁰ Ligji nr. 05/l-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Republikën e Kosovës. Neni 2.

³¹ Ligji nr. 05/l-102 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Misionin e Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë. Neni 1.2.1.

4.2. Kompetencat e veçanta dhe plotësuese të PSRK-së

Në bazë të Ligjit nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, PSRK-së si prokurori e specializuar i është dhënë mandat i veçantë për ndjekjen e disa veprave penale të Kodit Penal të Kosovës dhe Rregulloreve të UNMIK-ut, të cilësuar si veprat më të rënda penale. Në këtë grup të veprave bëjnë pjesë 23 vepra penale, duke përfshirë veprat penale kundër terrorizmit, krimet e luftës, gjenocidit e krimit të organizuar³².

Sipas këtij ligji, të gjithë prokurorët në nivel vendi, të cilët do të kenë ndonjë raport penal verbal ose me shkrim, që lidhet me veprat penale të cilat hynë në kompetencë të veçantë të PSRK-së, do të informojnë Kryeprokurorin e zyrës së tyre, i cili më pas do ta informoj Kryeprokurorin e PSRK-së, të cilit i mbetet të vendos nëse ajo lëndë të transferohet në PSRK apo jo³³. Ndërsa, në rast se Kryeprokurori i PSRK-së, beson se kjo prokurori nuk ka arsye që ta ushtroj kompetencën e saj të veçantë, atëherë lëndën penale mund ta dorëzoj te prokuroria që ka kompetencë lëndore dhe territoriale.

Ndërsa, përpos kompetencave të veçanta, PSRK-ja mund që kur e shih të arsyeshme të ushtroj edhe kompetenca plotësuese për ndjekjen e veprave penale, në të cilat bëjnë pjesë 49 vepra penale të Kodit Penal, ku përfshihen vrasja e rëndë, vrasja, vepra penale që lidhen me narkotikët dhe kundër integritetit seksual, dhe veprave të tjera e po ashtu edhe veprave penale që janë paraparë me rregulloret e UNMIK-ut dhe ish-Ligjit Penal të Kosovës.³⁴

Nga të gjitha këto mund të konkludohet se Ligji i PSRK-së, i ka dhënë shumë mundësi kësaj prokurorie që të bëj ndjekjen penale të veprave më serioze dhe të dyshuarve për këto vepra penale.

³² Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Neni 5.

³³ Po aty. Në neni 6.

³⁴ Po aty. Neni 9.

5. Performanca e PSRK-së në ndjekjen penale në vitet 2016 - 2019

Në rreshtat në vijim, IKD ka analizuar në mënyrë të detajuar performancën e PSRK-së.

Analiza e performancës dhe efikasitetit të PSRK-së është bërë duke u bazuar në të dhënat zyrtare të sistemit prokurorial mbi numrin e lëndëve dhe numrin e prokurorëve të angazhuar në këtë prokurori.

5.1. Numri i prokurorëve të angazhuar në PSRK

Bazuar në raportet vjetore të punës së PSH-së nga viti 2016 e deri në vitin 2019, numri i prokurorëve të angazhuar në këtë prokurori ka variuar nga 10 deri në 15 prokurorë të angazhuar, ndërsa aktualisht në këtë prokurori janë të angazhuar 14 prokurorë.

Bazuar në Raportin e Punës së Prokurorit të Shtetit të vitit 2016³⁵ rezulton se ky institucion në radhët e saj kishte 171 prokurorë, ku 10 prej tyre ishin pjesë e PSRK-së, përkatësisht Kryeprokurori i kësaj prokurorie dhe nëntë (9) prokurorë.

Ndërsa sipas raportit të vitit 2017³⁶, ishte parë se për një vit, Prokurorit të Shtetit i ishin shtuar vetëm gjashtë (6) prokurorë, ndërsa hap pozitiv ishte bërë në rritjen e numrit të prokurorëve në PSRK, pasi gjatë këtij viti kjo prokurori kishte 14 prokurorë, duke e përfshirë edhe Kryeprokurorin.


Kurse në raportin e punës së vitit 2018³⁷, pjesë e Prokurorit të Shtetit ishin 191 prokurorë, 15 nga të cilët të angazhuar në PSRK, derisa në vitin 2019, kjo prokurori ka mbetur përsëri me 14 prokurorë³⁸.

³⁵ “Raporti i Punës i Prokurorit të Shtetit 2016”. (shih linkun: http://www.psh-ks.net/repository/docs/2017_04_20_105803_Raporti_Prokurori_i_shtetit_2016_Final1.pdf). (Qasur për herë të fundit më 23.04.2020).

³⁶ “Raporti i Punës i Prokurorit të Shtetit 2017”. (shih linkun: <http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Statistika%20dhe%20Raporte/Raporte%20Vjetore/Raporti%20Vjetor%20i%20Pun%C3%ABs%202017%20i%20Prokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 23.04.2020).

³⁷ “Raporti i Punës i Prokurorit të Shtetit 2018”. (shih linkun: <http://kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Raporti%20Vjetor%20i%20Pun%C3%ABs%202018%20i%20Prokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 23.04.2020).

³⁸ “Raporti i Punës i Prokurorit të Shtetit 2019”. (shih linkun: <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Raporte/Raporti%20i%20pun%C3%ABs%20s%C3%AB%20Prokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit%20C%20p%C3%ABr%20vitin%202019.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 10.06.2020).



Grafiku 1. Numri i prokurorëve të angazhuar në PSRK përgjatë viteve 2016-2019³⁹.

Edhe pse me ligjin për PSRK-në është përcaktuar se kjo prokurori do t'i ketë 10 prokurorë, paragrafi 4 i nenit 3 të ligjit thekson se “Përbërja e PSRK-së mund të ndryshohet sipas nevojave dhe ngarkesës me punë të zyrës dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara sipas ligjit në fuqi⁴⁰”.

Andaj mbi këtë bazë, duke parë numrin e madh të rritjes së kriminalitetit të rëndë në fushën e krimit të organizuar e korrupsion, KPK ka dështuar që të rrisë numrin e prokurorëve të kësaj prokurorie me prokurorë të rinjë pasi nga viti 2016 kur në radhët e saj kanë qenë 10 prokurorë, e deri në vitin 2019, janë shtuar vetëm katër (4) prokurorë.

Efikasiteti i ulët i kësaj prokurorie, i arsytuar në rreshtat pasues të këtij raporti, dëshmon se kjo ngritje e numrit të prokurorëve në PSRK nuk paraqet ngritje të mjaftueshme.

Përmes Strategjisë për riorganizimin e PSRK-së⁴¹, e nxjerrë në shkurt të vitit 2020, në kuadër të kësaj prokurorie janë themeluar katër (4) departamente. Departamenti për Krime Luftë, Departamenti për Krim të Organizuar dhe krime tjera në kompetencë të PSRK-së, Departamenti për Terrorizëm dhe Departamenti për Korrupsion dhe Krim Financiar.

Sa i përket profilizimit të prokurorëve të PSRK-së, IKD vazhdimisht ka rekomanduar që nisur nga rëndësia dhe rrezikshmëria e veprave penale që trajtohen nga kjo prokurori, prokurorët e PSRK-së duhet të profilizohet dhe specializohen, i cili profilizim dhe specializim nuk ka ndodhur ende. Sipas KPK-së, ky profilizim pritet të ndodhë së shpejti⁴².

³⁹ *Shënim:* Në këtë numër përfshihet edhe kryeprokurori i PSRK-së.

⁴⁰ Ligji nr. 03/L-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës. Neni 3.4.

⁴¹ Strategjisë për riorganizimin e PSRK-së, e dërguar nga zëdhënësi i PSRK-së Ekrem Lutfiu. 27.04.2020.

⁴² Përgjigja për IKD-në e zëdhënësit të PSRK-së, Ekrem Lutfiu. 27.04.2020.

5.2. Efikasiteti i prokurorëve të PSRK-së gjatë viteve 2016-2019

Prokurorët e PSRK-së, gjatë periudhës 2016-2019, krahas lëndëve të trashëguara nga vitet paraprake, kanë pranuar 1,202 raste të reja, derisa për katër vite kanë zgjidhur vetëm 1.018 raste. Kurse, në fund të vitit 2019 kanë mbetur të pazgjidhura edhe 1.799 raste.

Mirëpo, nga trendi i rezultateve në këtë periudhë raportuese, është parë se dhe pse brenda PSRK-së, vit pas viti është rritur numri i prokurorëve, ka pasur regres në zgjidhjen e lëndëve, ndërsa të njëjtit nuk kanë mundur ta plotësojnë as normën prej dy (2) lëndëve në muaj.

Viti	Të pazgjidhura në fillim të viteve	Të pranuar në punë	Gjithsej lëndë në punë	Të zgjidhura gjatë viteve	Të pazgjidhura në fund të viteve
2016	541	108	649	207	442
2017	442	207	649	192	457
2018	1521	217	1738	227	1511
2019	1521	670	2,191	392	1,799
Gjithsej	/	1,202	/	1,018	/

Tabela.1 Efikasiteti i punës së prokurorëve në periudhën raportuese 2016-2019.

Në vitin 2016 kanë qenë të angazhuar vetëm 10 prokurorë dhe nga 649 lëndë në punë gjatë këtij viti, ishin zgjidhur 207 lëndë apo 31.90 % Nga kjo i bie që një prokuror i PSRK-së nuk ka mundur ta përmbush as normën e paraparë prej dy (2) lëndëve në muaj pasi për një muaj ka zgjidhur 1.72 lëndë, ndërsa kishin përfunduar 20.70 lëndë në vit, edhe pse me normë është dashur që, brenda vitit të përfundohen 22 lëndë.

Në bazë të raportit të punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2017, në kapitullin e numrit të prokurorëve është evidentuar se në PSRK gjatë vitit 2017 kanë qenë të angazhuar 14 prokurorë⁴³, duke e përfshirë edhe kryeprokurorin, ndërsa në pjesën e efikasitetit të lëndëve penale në PSRK është thënë se në PSRK janë angazhuar vetëm 11 prokurorë⁴⁴.

Në bazë të saj është thënë se 11 prokurorë, nga 649 lëndë në punë, kanë zgjidhur 192 lëndë apo 29.58%. Pra vetëm 1.45 lëndë në muaj për prokuror, ndërsa 17.45 lëndë në vit apo 4.55 lëndë më pak sesa norma e përcaktuar me udhëzim të Prokurorit të Shtetit.


⁴³ “Raporti i Punës së Prokurorit të Shtetit 2017”. Faqe 8. (Shih linkun: <http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Statistika%20dhe%20Raporte/Raporte%20Vjetore/Raporti%20Vjetore%20i%20Pun%C3%ABs%202017%20i%20Prokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit.pdf>). (Qasur për here të fundit më 22.04.2020).

⁴⁴ Po aty. Faqe 54.

Por, nëse e marrim parasysh se në PSRK gjatë vitit 2017 janë angazhuar 14 prokurorë, atëherë i bie se një prokuror i PSRK-së ka kryer vetëm 13.71 lëndë në vit apo 1.24 lëndë në muaj edhe pse është dashur që të përfundohen 2 lëndë në muaj.

Gjatë vitit 2018, PSRK duke llogaritur edhe kryeprokurorin, kishte të angazhuar 15 prokurorë, të cilët nga 1,738 lëndë⁴⁵, kanë zgjidhur vetëm 227 lëndë apo shprehur në përqindje vetëm 13.06%, që është edhe përqindja më e ulët e punës së PSRK-së, shprehur në raportin në mes lëndëve të zgjidhura dhe atyre të pazgjidhura. Edhe pse me rritjen e numrit të prokurorëve është menduar që të përfundohen më shumë lëndë, ka ndodhur e kundërta, pasi gjatë këtij viti 15 prokurorë kanë kryer më pak lëndë sa kanë kryer vetëm 10 prokurorë në vitin 2016. Gjatë këtij viti, një prokuror ka arritur të kryej vetëm 15.13 lëndë për një vit apo 6.87 lëndë më pak se norma e caktuar, ndërsa kanë arritur të kryej vetëm 1.26 lëndë në muaj. Ulja e numrit të lëndëve të zgjidhura përballë ngritjes së numrit të prokurorëve në PSRK paraqet theksim të faktit se ky institucion prokurorial nuk ka pasur vullnetin që resurset e shtuara t'i përkthejë në rezultate, përkundrazi, rritja e resurseve ka ndikuar në uljen e efikasitetit.

Ndërsa, sipas raportit të punës së vitit 2019, ka pasur një progres të lehtë të numrit të zgjidhjes së lëndëve. Gjatë vitit të kaluar, PSRK-ja kishte pranuar në punë 670 lëndë, ndërsa në punë i kishte 2,191 lëndë, prej të cilave i kishte zgjidhur 392, apo shprehur në përqindje, i kishte zgjidhur 17.89% të lëndëve. 14 prokurorë të PSRK-së, në vitin 2019 kanë zgjidhur 392 lëndë, duke bërë kështu që të kalohet edhe norma vjetore prej 22 lëndëve në vit, si dhe ajo mujore prej dy (2) lëndëve në muaj, pasi prokurorët e PSRK-së gjatë këtij viti kanë kryer 2.33 lëndë në muaj, apo mesatarisht nga 28 lëndë në vit.



Grafiku.2 Efikasiteti i punës së prokurorëve sipas lëndëve në punë, në periudhën raportuese 2016-2019.

⁴⁵ *Shënim:* Raporti i Punës së Prokurorit të Shtetit 2018 nuk ka dhënë asnjë sqarim se si në fund të vitit 2017 kishin mbetur të pazgjidhura edhe 457 lëndë, ndërsa në fillim të vitit 2018 janë pasqyruar 1521 lëndë.

Nisur nga fakti se mos pranimi i lëndëve të reja është fakt i paarritshëm, atëherë kalkulimi mbi përfundimin e lëndëve në punë, duke pranuar edhe lëndë të reja e vështirëson jashtëzakonisht shumë arritjen e stabilitetit me lëndë në PSRK.

Kjo për arsye se raporti në mes të lëndëve të zgjidhura dhe atyre të pranuar në PSRK ka një bilanc të theksuar negativ, që nënkupton se stabiliteti me lëndë në PSRK vetëm sa është duke pësuar regres, dhe në asnjë progres minimal.

Gjatë vitit 2019, PSRK ka pranuar në punë 670 lëndë të reja. Në raport me këtë numër të lëndëve të pranuar, PSRK ka zgjidhur vetëm 392 lëndë, i cili fakt nënkupton se në fund të vitit 2019, PSRK ka pasur të pazgjidhura 278 lëndë më shumë se sa në vitin paraprak. Pra, me këtë tempo, numri i lëndëve të pazgjidhura në KPK do të vazhdojë të rritet vit pas viti dhe secila rritje nënkupton vështirësim të theksuar në arritjen e stabilitetit me lëndë në PSRK.

Në këtë drejtim, IKD vlerëson se kjo situatë është alarmante, jo për nga numri i lëndëve, por nga trendi i arritjes së stabilitetit. Për këtë arsye, IKD konsideron se këtë çështje KPK duhet ta trajtojë menjëherë në dy drejtime.

Fillimisht, KPK përmes mekanizmave të brendshëm të kontrollit të prokurorëve, duhet të disiplinojë prokurorët të cilët nuk tregojnë efikasitet në trajtimin e lëndëve. Krahas kësaj, KPK duhet të bëjë një analizë të detajuar që trason rrugën për stabilitetin me lëndë të PSRK-së, mbi bazën e të cilës analizë, të marrë hapat konkretë për stabilizimin me lëndë në PSRK. Në të kundërtën, secila vonesë në ndërmarrjen e këtyre veprimeve, nënkupton rëndim të situatës për të arritur këtë stabilitet në PSRK, i cili do të vazhdojë të përkeqësohet.


5.3.Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga PSRK-së gjatë viteve 2016-2019

Raportet vjetore të PSH-së, pasqyrojnë se gjatë periudhës raportuese 2016-2019, me qëllim të ngritjes së efikasitetit të PSRK-së, KPK ka ngritur gradualisht numrin e prokurorëve të PSRK-së, mirëpo rritja e numrit të prokurorëve në PSRK nuk është përkthyer në efikasitet. Kjo pasi viti 2016 del të jetë më produktiv si në zgjidhjen e lëndëve, ashtu edhe me numrin e të akuzuarve, përkundër faktit se gjatë këtij viti, KPK kishte numrin më të ulët të prokurorëve.

Gjatë vitit 2016, në kohën kur kishte vetëm 10 prokurorë, PSRK ka ngritur aktakuza ndaj 352 personave, ndërsa një vit më pas edhe pse më 14 prokurorë, nuk ka ngritur aktakuza as sa gjysma e vitit paraprak. Në vitin 2017 kjo prokurori ka ngritur aktakuza vetëm ndaj 209 personave, ndërsa trendi më negativ ka ndodhur në vitin 2018, ku 15 prokurorë, kanë arritur të ngritin aktakuza vetëm ndaj 98 personave, ndërsa në vitin 2019, 14 prokurorë kanë ngritur aktakuza ndaj 144 personave.

Viti 2016 ishte më produktiv edhe sa i përket fillimit të hetimeve, pasi në atë kohë kishin filluar hetimet ndaj 1,137 personave, ndërsa një vit më pas hetimet kishin filluar ndaj 633 personave, ndërsa në raportin e punës së vitit 2018 dhe 2019, PSH-ja nuk ka pasqyruar efikasitetin e prokurorëve në vendimet për fillim të hetimeve.

PSRK-ja, gjatë katër (4) viteve kishte pushuar hetimet ndaj 636 personave, ka hudhur kallëzimet penal ndaj 91 personave, ndërsa ka dërguar në kompetencë procedurën për 218 persona.



Grafiku 3. Vendimet e prokurorëve të PSRK-së gjatë viteve 2016-2019, sipas personave.

Në këtë mënyrë, këto rezultate tregojnë se për trajtimin e krimeve më serioze nga organi i specializuar i akuzës, në rastin konkret PSRK-së, ka munguar vullneti i prokurorëve në PSRK dhe mungesa e llogaridhënies nga KPK dhe jo resurset e PSRK-së. Kjo për arsye se ngritja e resurseve është përkthyer në regres të efikasitetit dhe jo e kundërta.


5.4. Aktgjykimet sipas akteve akuzuese të PSRK-së gjatë viteve 2016-2018

Përpos vendimmarrjes së prokurorëve të PSRK-së në periudhën raportuese 2016-2019, IKD ka analizuar edhe aktgjykimet e gjykatave themelore lidhur me aktakuzat e kësaj prokurorie. Raporti i punës së PSH-së, i vitit 2016 nuk ka specifikuar se cilat kanë qenë vendimet gjyqësore për aktakuzat e PSRK-së, vetëm se në pjesën hyrëse të këtij raporti është thënë se nga 129 persona për të cilët janë marrë vendim gjyqësor, 110 prej tyre janë shpallur fajtorë për veprat për të cilat janë akuzuar, ndërsa për 19 të tjerë nuk është treguar se çfarë aktgjykimesh janë dhënë.

Gjykatat e Kosovës, sipas Raportit të Punës të PSH-së për vitin 2017, kanë shpallur fajtorë 38 persona që ishin akuzuar nga PSRK, ndërsa në vitin 2018, ishin shpallur fajtorë 99 persona, kurse në vitin 2019, janë shpallur fajtorë 26 persona.

Përpos aktgjykimeve dënuese, gjykatat në vitin 2017 kishin liruar shtatë (7) persona, ndaj tre (3) të tjerëve ishte hedhur aktakuza, ndërsa për tre (3) persona ishte marrë aktgjykim refuzues. Numri i personave të akuzuar nga PSRK-ja, por të cilët kishin “shpëtuar” nga to, ishte rritur në vitin 2018 ku 43 persona ishin liruar gjatë këtij viti, ndërsa ndaj një (1) personi ishte refuzuar aktakuza. Sipas Raportit të Punës së PSH-së, për vitin 2018, gjykatat nuk kishin hedhur asnjë

aktakuzë të PSRK-së⁴⁶. Ndërsa sipas Raportit të Punës së PSH-së, për vitin 2019, 26 persona janë dënuar, nëntë (9) persona janë liruar nga aktakuza e PSRK-së, ndërsa ndaj një (1) personi është refuzuar aktakuza.



Grafiku 4. Aktgjykimet sipas personave të akteve akuzuese të PSRK-së gjatë viteve 2017-2019.

Lidhur me punën e PSRK-së, IKD ka zhvilluar një intervistë me kryeprokurorin e kësaj prokurorie, Blerim Isufaj⁴⁷.

Sipas tij, kjo prokurori është duke bërë përpjeke të vazhdueshme për të ndërtuar të gjitha kapacitetet e brendshme, në mënyrë që të realizoj ndjeke sa më efikase të veprimtarive kriminale, ndërsa ka theksuar se kjo prokurori ka arritur që të përmbush obligimet ligjore që të akuzoj kryerësit e veprave penale, më qëllim që të njëjtit të dënohen.

Ai ka theksuar po ashtu se kjo prokurori tashmë ka nisur edhe procesin e profilizimit të prokurorëve.

⁴⁶ *Shënim*: Edhe pse në Raportin e Punës së PSH-së për vitin 2018 është thënë se gjykatat nuk kanë hedhur poshtë asnjë aktakuzë, në “Raportin Vjetor (2018) i Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për Veprat Penale Karakteristike” në veprat penale të “Krimin të Organizuar”, është evidentuar se aktakuza ndaj një personi për këtë veprë penale është hedhur poshtë. (Shih linkun: <http://www.kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Statistika%20dhe%20Raporte/Raporte%20Vjetore/RAPORTI%20VJETOR%202018%20I%20MEKANIZMIT%20P%C3%8BRCJELL%20ND%C3%8BRINSTITUCIONAL.pdf>) Faqe 34. (Qasur për herë të fundit më 21.04.2020).

⁴⁷ Përgjigja për IKD-në e Kryeprokurorit të PSRK-së, Blerim Isufaj. 12.05.2020.



“PSRK, si prokurori e specializuar në kuadër të PSH, kompetencat e veta i ushtron në bazë të Ligjit për PSRK-në. PSRK ka bërë dhe po bën përpjekje të vazhdueshme për të ndërtuar të gjitha kapacitetet e brendshme për të ushtruar këto kompetenca në mënyrën sa më të mirë. Ne konsiderojmë se PSRK përkundër sfidave të ndryshme me të cilat është përballur ka arritur të përmbush obligimet ligjore për akuzimin e personave që pretendohet se kanë kryer krime dhe përfaqësimin e të gjitha rasteve para gjykatave me qëllim që kryesit e pretenduar të dënohen sipas ligjit. Si Kryeprokuror kam hartuar një strategji për riorganizimin e PSRK-së ku është paraparë edhe profilizimi i prokurorëve. Në bazë të kësaj strategjie me kërkesën time, KPK ka marrë vendim për themelimin edhe të 3 departamenteve tjera përveç Departamentit për Krime të Luftës, dhe tashmë janë caktuar prokurorët që të punojnë në departamentet përkatëse. Në të njëjtën kohë ne vlerësojmë se këta prokurorë do të mbështeten edhe me programe adekuate trajnimi për tu përgatitur sa më mirë sipas kompetencave të secilit departament.

Blerim Isufaj - Kryeprokuror i PSRK-së

6. Vendimet e PSRK-së sipas veprave karakteristike për persona, sipas Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional (MPN) për vitet 2016-2019

Duke marrë parasysh rëndësinë e PSRK-së si prokurori e specializuar, IKD ka analizuar edhe veprimet e kësaj prokurorie për veprat penale karakteristike, të parapara me anë të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional, për vitet 2016-2019.

Veprat penale sipas këtij mekanizmi janë: Korrupsioni, Krimet ekonomike, Krimi i Organizuar, Nxitja e Urrejtjes, Drogat, Armët, Kontrabandimi me migrantë, Shpërlaja e parasë dhe Trafikimi me Qenie Njerëzore. Lidhur me këto vepra penale, IKD, ka analizuar vendimet e prokurorëve për të gjitha veprat penale karakteristike, vendimet e gjykatave dhe ankimin e tyre.

Gjatë viteve 2016-2019, PSRK-ja për këto vepra penale, ka akuzuar 492 persona, nga të cilët 278 për krim të organizuar, 160 për vepra penale të korrupsionit, 26 për shpërlarje të parave, nëntë (9) për krime ekonomike, shtatë (7) për kontrabandim me migrantë, nga pesë (5) për nxitje të urrejtës dhe vepra të narkotikëve dhe dy (2) për vepra penale të armëve. Po ashtu ajo ka pushuar hetimet për 388 persona, për 48 të tjerë ka hudhur kallëzimet penale, ndërsa për 11 persona, ka zgjidhur rastin duke bashkuar proceduat.

Nga analizimi i katër (4) raporteve të mekanizmit përcjellës për veprat penale karakteristike, nuk është evidentuar asnjë vendim i prokurorëve të PSRK-së, për veprën penale të trafikimit me njerëz

6.1. Vendimet e PSRK-së sipas veprave karakteristike për persona, sipas Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për vitin 2016

Në bazë të veprave penale karakteristike të MPN-së, PSRK-ja gjatë vitit 2016 ka ngritur aktakuza ndaj 239 personave, ka pushuar hetimet për 157 persona, ndërsa ka hedhur kallëzimet penale për 10 persona.⁴⁸

Nga të gjithë 239 personat e akuzuar, numri më i madh i tyre apo 122 persona janë të akuzuar për krim të organizuar, 97 të tjerë janë të akuzuar për vepra korruptive, shtatë (7) persona janë akuzuar për kontrabandim me migrantë, gjashtë (6) për krime ekonomike, nga tre (3) për shpërlarje të parave dhe nxitje të urrejtjes, ndërsa një (1) i akuzuar bënë pjesë në veprat penale të narkotikëve, ndërsa nuk ka pasur asnjë aktakuzë për trafikim me qenie njerëzore.

Numri më i madh i personave për të cilët kanë pushuar hetimet apo 61 prej tyre, bëjnë pjesë në veprat penale të krimit të organizuar, pastaj 54 të tjerë të veprave penale korruptive, ndaj 12 personave të dyshuar për narkotikë, nga 11 persona për veprat penale të armëve dhe shpërlarjës

⁴⁸ Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për Harmonizimin e Statistikave për Veprat Penale Karakteristike- Raporti vjetor-2016 (Shih linkun: <http://kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Statistika%20dhe%20Raporte/Raporte%20Vjetore/Raporti%20vjetor%202016%20i%20Mekanizmit%20p%C3%ABrcjell%C3%ABs%20nd%C3%ABrinstitucional.pdf>) (Qasur për herë të fundit më 23.04.2020)

së parave, pesë (5) për nxitje të urrejtjes, (dy) për kontrabandim me migrant, një (1) për krime ekonomike dhe asnjë rast për trafikim me njerëz.

Përveç rasteve për të cilat kanë pushuar procedurat, PSRK-ja ka hudhur kallëzimet penale ndaj 10 personave. Janë hedhur aktakuzat ndaj katër (4) personave të dyshuar për korrupsion, tre (3) personave për shpërlarje të parave, dy (2) personave për krim të organizuar dhe një (1) personi për kontrabandim me migrantë.

Sipas këtij raporti, gjykatat kanë hedhur poshtë aktakuzat para shqyrtimit gjyqësor ndaj 11 personave, të akuzuar për krim të organizuar, ndërsa kanë refuzuar aktakuzat ndaj dy (2) personave të akuzuar për shpërlarje të parave. Po ashtu gjykatat kanë shpallur fajtor tre (3) persona për korrupsion, katër (4) persona të akuzuar për narkotikë dhe tre (3) të tjerë për kontrabandë me migrantë. Ajo se çfarë është e pakuptimtë është se sipas të dhënave të këtij mekanizmi, PSRK gjatë vitit 2016, nuk ka bërë asnjë ankesë ndaj vendimeve gjyqësore edhe pse një numër i konsiderueshëm i këtyre vendimeve kanë rrëzuar aktakuzat e PSRK-së.

6.2.Vendimet e PSRK-së sipas veprave karakteristike për persona, sipas Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për vitin 2017

Sikurse të analiza e punës së prokurorëve të PSRK-së për të gjitha veprat penale, regresi i rezultateve në vitin 2017 vërehet edhe për statistikën e raportit të MPN-së për vitin 2017⁴⁹.

Përderisa në vitin 2016 ishin akuzuar 122 persona për krim të organizuar dhe 97 të tjerë për korrupsion, gjatë gjithë vitit 2017 janë akuzuar vetëm 80 persona, për veprat penale karakteristike. 58 prej tyre janë akuzuar për krim të organizuar, 18 për vepra korruptive, tre (3) për shpërlarje të parave dhe një (1) për vepra lidhur me armët.

PSRK po ashtu ka pushuar procedurën ndaj 115 personave, 68 nga të cilët dyshoheshin për krim të organizuar, 35 për vepra të korrupsionit, kurse nga katër (4) persona për veprat penale të narkotikëve, kontrabandimit me migrantë dhe shpërlarje të parasë. Ndërsa gjatë këtij viti, kishin pushuar hetimet vetëm ndaj nëntë (9) personave, që dyshoheshin për shpërlarje të parave.

Sipas raportit të MPN-së për vitin 2017, gjykatat lidhur me veprat penale karakteristike kanë marrë aktgjykim refuzues ndaj tre (3) personave të cilët ishin të akuzuar për korrupsion, ndërsa kanë dënuar një (1) person për shpërlarje të parave. PSRK gjatë vitit 2017, lidhur me këto katër (4) vendime gjyqësore, ka bërë një ankesë për rastin e shpërlarjës së parave, ndërsa vendimi për këtë ankesë nuk është bërë i ditur.

⁴⁹ Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për Harmonizimin e Statistikave për Veprat Penale Karakteristike- Raporti vjetor-2017 (Shih linkun: <http://kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/publikimet/7%20RAPORTI%20VJETOR%20%20I%20MEKANIZMIT%20PËRCJELLES%20NDERINSTITUCIONAL%202017.pdf>) (Qasur për herë të fundit më 23.04.2020)

6.3.Vendimet e PSRK-së sipas veprave karakteristike për persona, sipas Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për vitin 2018

Edhe pse me pesë (5) prokurorë më shumë se në vitin 2016, prokurorët e PSRK-së edhe gjatë vitit 2018, nuk kanë arritur të kenë rezultatet e punës së vitit 2016, për veprat penale karakteristike, e aq më pak të realizojnë rezultate më të mira⁵⁰.

Gjatë këtij viti, kjo prokurori ka akuzuar pesë (5) persona më pak se në vitin 2017, në këtë vit pra për veprat penale karakteristike janë akuzuar vetëm 75 persona. 35 persona janë akuzuar për vepra penale të kapitullit të korrupsionit, 24 të tjerë janë akuzuar për krim të organizuar, 11 për shpërlarje të parave, katër (4) për vepra penale të narkotikëve dhe një (1) për vepra lidhur me armët.

PSRK-ja rezultate edhe më të ulëta sesa vitet paraprake, ka pasur edhe për veprime të tjera procedurale. Kjo prokurori gjatë vitit 2018 ka pushuar procedurën ndaj 59 personave, 13 nga të cilët dyshoheshin vepra të korrupsionit, 22 për krim të organizuar, 10 për vepra penale lidhur me narkotikët, 11 për shpërlarje të parave dhe tre (3) për vepra penale të nxitjes së urrejtjes. Ndërsa gjatë këtij viti, kishin pushuar hetimet ndaj 26 personave, nëntë (9) persona dyshoheshin për krim të organizuar, shtatë (7) për korrupsion, gjashtë (6) për shpërlarje të parave dhe katër (4) për krime ekonomike.

Sipas raportit të MPN-së për vitin 2018, gjykatat kanë shpallur fajtor 13 persona për vepra të korrupsionit, gjashtë (6) për kontrabandim me migrantë, katër (4) për shpërlarje të parave, dy (2) për vepra të narkotikëve, dhe nga një (1) për krim të organizuar, trafikim me qenje njerëzore dhe vepra lidhur me armët. Përpos aktgjykimeve dënuese, gjykatat kanë liruar nga akuzat pesë (5) të akuzuar për korrupsion, një (1) për krim të organizuar dhe një (1) tjetër për narkotikë.

Ndërsa janë marrë edhe katër (4) aktgjykime refuzuese për korrupsion dhe një (1) për kontrabandim me migrantë. Aktakuza është hedhur poshtë ndaj një (1) personi të akuzuar për krim të organizuar. PSRK gjatë vitit 2018, ka bërë 16 ankesa ndaj vendimeve gjyqësore.

6.4.Vendimet e PSRK-së sipas veprave karakteristike për persona, sipas Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për vitin 2019

Gjatë vitit 2019, ashtu siç edhe është vërejtur një efikasitet më i lartë i punës së PSRK-së për të gjitha veprat penale, kjo shihet edhe në veprimet e saj edhe lidhur me procedimin e veprave penale karakteristike⁵¹.

⁵⁰ Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për Harmonizimin e Statistikave për Veprat Penale Karakteristike- Raporti vjetor-2018 (Shih linkun: <http://kpk-rks.org/assets/cms/uploads/files/Statistika%20dhe%20Raporte/Raporte%20Vjetore/RAPORTI%20VJETOR%202018%20I%20MEKANIZMIT%20P%C3%8BRCJELL%C3%8BS%20ND%C3%8BRINSTITUCIONAL.pdf>) (Qasur për herë të fundit më 23.04.2020)

⁵¹ Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional për Veprat Penale Karakteristike- Raporti vjetor-2019 (Shih linkun: <https://prokuroria->


Gjatë këtij viti, kjo prokurori për veprat penale karakteristike ka akuzuar 98 persona, 74 nga të cilët janë akuzuar për krim të organizuar, 10 persona janë akuzuar për vepra penale të kapitullit të korrupsionit, nëntë (9) për shpërlarje të parave, tre (3) për krime ekonomike dhe dy (2) për nxitje të urrejtës.

PSRK-ja, gjatë vitit 2019 ka pushuar procedurën ndaj 64 personave, 35 nga të cilët dyshoheshin për vepra të korrupsionit, 26 për krim të organizuar, dy (2) për shpërlarje të parave dhe një (1) për vepra penale lidhur me narkotikët.

Ndërsa edhe 11 raste tjera janë zgjidhur në mënyrë tjetër, duke bashkuar procedurat, gjashtë (6) për vepra penale të narkotikëve, tri (3) për krim të organizuar dhe dy (2) për vepra korruptive.

Në bazë të raportit të vitit 2019, lidhur me procedimin e aktakuzave të PSRK-së për këto vepra penale në gjykatë, pasqyrohen vetëm një (1) aktgjykim dënues dhe një (1) refuzues lidhur me veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore, ndërsa për vepra penale të tjera nuk ka pasur vendime gjyqësore

Po ashtu PSRK-ja, gjatë vitit 2019, për veprat penale karakteristike ka bërë dy (2) ankesa ndaj vendimeve gjyqësore, një (1) për veprën penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe një (1) tjetër për vepra penale të narkotikëve.



Grafiku 5. Vendimet e PSRK-së sipas veprave karakteristike të MPN-së për persona, në vitet 2016- 2019 (total) ⁵².

rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/KPK/RAPORTI%20VJETOR%202019%2C%20I%20MEKANIZMIT%20P%C3%8BRNJELL%C3%8BS%20ND%C3%8BRINSTITUCIONAL.pdf) (Qasur për herë të fundit më 11.06.2020)

⁵² Nga analizimi i katër (4) raporteve të mekanizmit përcjellës për veprat penale karakteristike, nuk është evidentuar asnjë vendim i prokurorëve të PSRK-së, për veprën penale të trafikimit me njerëz.

7. Dështimi i PSRK-së përballë korrupsionit të profilit të lartë dhe rasteve të shënjestruara në periudhën 2016-2019

Raportet e institucioneve ndërkombëtare si të Departamentit Amerikan të Shtetit dhe Raporti i Progresit për Kosovën i Bashkimit Evropian, ashtu edhe në ato të organizatave jo qeveritare në vend, pasqyrojnë se Kosova është ende larg luftës efektive kundër korrupsionit, e veçanërisht të korrupsionit të profilit të lartë. E përpos tyre, kanë munguar edhe rezultatet për rastet e shënjestruara për të cilat është synuar që të vlerësohet Kosova në procesin për liberalizmin e vizave.

Raporti i Departamentit Amerikan të shtetit, ka pasqyruar qartë gjetjet e organizatave të shoqërisë civile se organet e drejtësisë kanë dështuar në ndjekjen dhe ndëshkimin e zyrtarëve të profilit të lartë. *“OJQ-të dhe organizatat ndërkombëtare identifikuan dështime të shumta të supozuara nga sistemi i drejtësisë në ndjekjen penale të korrupsionit, duke vënë në pah se vetëm disa raste të ngritura kundër zyrtarëve të lartë rezultuan në aktakuza. Dënimi i zyrtarëve të nivelit të lartë të shpallur fajtorë për korrupsion shpesh ishte i butë”*⁵³.

Kurse, Raporti i Progresit për vitin 2019 konstaton gjendjen se *“Kosova është në një fazë të hershme/ka një nivel të përgatitjes në luftën kundër korrupsionit.”* Edhe në këtë raport përmendet se *“progresi i Kosovës është i drejtuar vetëm në drejtim të reformave të rëndësishme legislative në fushën e sundimit të ligjit dhe në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të nivelit të lartë. Korrupsioni është i përhapur dhe mbetet një çështje shqetësuese.”*

Sipas këtij raporti edhe *“sa i përket luftimit të krimit të organizuar, Kosova është në një fazë të hershme dhe progresi i vetëm i arritur është përmes reformave të rëndësishme legislative në fushën e sundimit të ligjit, në hetimin dhe ndjekjen penale të rasteve të nivelit të lartë dhe në ngrirjen paraprake të pasurisë. Megjithatë, pak progres është arritur në konfiskimin përfundimtar të pasurive dhe ende ka shumë pak hetime financiare dhe dënime përfundimtare. Masat nevojiten për të siguruar në mënyrë rigoroze se nuk ka ndërhyrje politike në aktivitetet operative të organeve të zbatimit të ligjit dhe prokurorisë.”*⁵⁴

IKD që nga viti 2016 ka bërë monitorim sistematik të rasteve të korrupsionit, ku në raportin e saj për monitorimin e rasteve të korrupsionit për vitet 2016, 2017 dhe 2018 *“Pandëshkueshmeria e Korrupsionit, Rrezik për Shoqërinë dhe Shtetin”* ka theksuar se *“Nga analiza e tri viteve të fundit të trajtimit të korrupsionit të profilit të lartë, rezulton se ende nuk ekziston një zyrtarë i profilit të lartë, i cili është dënuar për korrupsion me aktgjykim të formës së prerë me burgim efektiv”*⁵⁵

⁵³ “Raporti i Departamentit të Shtetit Amerikan për Kosovën”. 11.03.2020. (Shih linkun: <https://www.state.gov/wp-content/uploads/2020/02/KOSOVO-2019-HUMAN-RIGHTS-REPORT.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 22 prill 2020).

⁵⁴ Shënim: “Raporti i Progresit për Kosovën”. 29.09.2019. (Shih linkun (http://mei-ks.net/repository/docs/alb_-_20190529-kosovo-report.docx)). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

⁵⁵ Musliu B. dhe Miftaraj E. “Pandëshkueshmeria e Korrupsionit, Rrezik për Shoqërinë dhe Shtetin” IKD. 11 mars 2019. (shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/03/1.-Tri-vjet-kunder-korrupsionit-IKD-versioni-SHQIP.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 4 shkurt 2020).

Ndërsa, në dy raporte periodike të IKD-së për trajtimin e sistemit të drejtësisë për rastet e shënjestruara⁵⁶, ka gjetur se Prokurori i Shtetit me rastin e shënjestërimit të rasteve ka shkelur kriteret e përcaktuara me Procedurat Standarde të Veprimit, që vetë i ka përcaktuar, duke shënjestruar raste që nuk trajtohen si krime të rënda, ku të dyshuar janë kryesisht persona të profilit të ulët dhe në të cilat raste mundësia e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme është shumë e vogël, ndërsa nuk ka shënjestruar raste për të cilat mundësia për të konfiskuar pasuri të fituar me vepër penale është më e madhe.

Nga 19 rastet e përfunduara me aktgjykim të formës së prerë, edhe në ato raste kur ka konfiskim të pasurisë, kryesisht është konfiskuar pasuri që i nënshtrohet automatikisht konfiskimit pavarësisht fajësisë apo pa-fajësisë së të pandehurit siç përcaktohet me nenin 282 të Kodit të Procedurës Penale, që ndërlidhet me vepra penale kundër drogave dhe trafikimit me armë.

Kryeprokurori i PSRK-së Blerim Isufaj, që njëherësh është edhe koordinator i shënjestërimit të rasteve, ka thënë se një rast shënjestrohet në momentin që i plotëson kriteret për shënjestrim, ndërsa ai nuk i ka komentuar vendimet gjyqësore lidhur me këto raste⁵⁷.

8. Vendimet gjyqësore të aktakuzave të PSRK-së për profilin e lartë

Edhe pse në raportet vjetore, PSRK-ja numrin më të madh të aktakuzave i ka ngritur për vepra penale të korrupsionit, në bazë të analizës së IKD-së, rezulton se të gjitha aktakuzat e PSRK-së ndaj të akuzuarve të profilit të lartë⁵⁸, kanë dështuar.

Nga 11 aktakuzat e profilit të lartë në këtë periudhë raportuese, rezulton se nuk është shqiptuar asnjë aktgjykim dënues, ndërsa janë shqiptuar dy (2) aktgjykime liruese, tri (3) aktgjykime refuzuese, ndërsa numrin më të madh të tyre, e përbëjnë hedhjet e aktakuzës (6), me të cilat vendime, aktakuzat janë rrëzuar akoma pa filluar shqyrtimi gjyqësor.

Në mesin e të akuzuarve për korrupsion e që i takojnë profilit të lartë, janë pesë (5) kryetarë komunash, katër (4) ministra, një (1) kryetar gjykate dhe një (1) kryetar i Organit Shqyrtues të Prokurimit.

Një statistikë e tillë është shqetësuese për IKD-në pasi e njëjta tregon qartë se prokuroria që supozohet të jetë më efektivja dhe profesionalja në luftën kundër korrupsionit të profilit të lartë, nuk ka arritur asnjë rezultat pozitiv, duke bërë kështu që asnjë person i profilit të lartë të merr një vendim dënues të formës së prerë.

PSRK, më 1 mars 2016 kishte ngritur aktakuzë ndaj Kryetarit të Mitrovicës Agim Bahtiri dhe një zyrtari tjetër të kësaj komune, duke pretenduar se me veprimet e tyre të një procesi të

⁵⁶ Gashi L., Kadriu M. “Dështimet në rastet e shënjestruara”. IKD. Qershor 2019. f.12-16. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/ë-content/uploads/2019/07/5.-Deshtimet-ne-rastet-e-shenjestruara-25.06.2019.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 22 prill 2020).; Gashi L., Kadriu M.. “Shënjestruarimet e dështuara”. IKD. Mars 2020. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2020/03/Shenjestrimet-e-deshtuara-14-Mars-2020-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 22 prill 2020).

⁵⁷ Përgjigja për IKD-në e Kryeprokurorit të PSRK-së, Blerim Isufaj. 12.05.2020,

⁵⁸ *Shënim*: Profili i lartë është përcaktuar sipas udhëzuesit të KPK-së, të miratuar më 3 nëntor 2013.

tenderimit i kishin shkaktuar dëm Komunës në vlerë prej 767.940.00 euro. Kjo aktakuzë ishte vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, ndërsa në shkurt të vitit 2017, ishte hudhur nga Gjykata e Apelit, të cilin vendim e kishte vërtetuar edhe Gjykata Supreme.

Fatin e njëjtë me aktakuzën e Bahtirit e ka pasur edhe aktakuza ndaj Kryetarit të Gjilanit, Lutfi Haziri. Haziri më 30 gusht 2016 u akuzua nga PSRK se kishte shkelur të drejtat e pjesëmarrësve tjerë në një ankand publik, duke i shkaktuar dëm buxhetit të Komunës së Gjilanit në vlerë prej 168,000.00 euro. Aktakuza e tij u hodh poshtë, pa filluar gjykimi, të cilin vendim e aprovoi edhe shkalla e dytë.

Aktakuza e PSRK-së për korrupsion kishte dështuar pa filluar gjykimin edhe në rastin ndaj Kryetarit të Gjakovës Pal Lekaj. Ai më 10 shkurt 2017, së bashku me dy (2) të akuzuar të tjerë pretendohet se me qëllim të përfitimit për vete ose personin tjetër i kanë shkaktuar dëm Komunës së Gjakovës. Këtë vendim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.

Me hudhje të aktakuzës për keqpërdorim të pozitës zyrtare kaloi edhe Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ku sipas aktakuzës së ngritur më 27 dhjetor 2017, ai akuzohet se ka keqpërdorur detyrën zyrtare rreth angazhimit pa nevojë të stafit të zyrës së prokurimit. Këtë aktakuzë, Gjykata e Prizrenit e ka hudhur në prill të vitit 2018, të cilin vendim e ka vërtetuar edhe Apeli.

Për dallim prej katër kryetarëve komunal tjerë, aktakuza për keqpërdorim të detyrës ndaj Kryetarit të Komunës së Klinës Sokol Bashota, ishte refuzuar. Ai më 4 gusht 2016 ishte akuzuar se ishte përfshirë në dhënien e objekteve banesore disa subjekteve politike, duke anashkaluar aplikantët me gjendje të rëndë ekonomike. Prokuroria në përfundim të shqyrtimit gjyqësorë kishte hequr dorë nga aktakuza ndaj tij, ndërsa akuzat për mashtrim në detyrë ishte hedhur poshtë para fillimit të shqyrtimit gjyqësor.

Ende pa hyrë në shqyrtimin gjyqësor ishte hedhur edhe aktakuza ndaj ish-ministrit të MASHT-it Ramë Buja, që më 7 nëntor 2017 u akuzua për keqpërdorim të pozitës zyrtare në lidhje me një proces të prokurimit. Vendimin e GjTh-së në Prishtinë e vërtetoi pastaj edhe shkalla e dytë.

GTh në Prishtinë, kishte hedhur poshtë edhe aktakuzën e 13 marsit 2017, ndaj ish-ministrit për Komunitete dhe Kthim, Dalibor Jevtiq. Ai akuzohet se veturën e qeverisë, me vendim ia kishte dhënë në shfrytëzim një kompanie private. Këtë vendim të themelores e vërtetoi edhe Gjykata e Apelit, mirëpo Gjykata Supreme kishte gjetur se vendimi për lirim ishte marrë me shkelje të procedurave penale, në favor të të pandehurit.

Nga aktakuzat për keqpërdorim të pozitës zyrtare pa ndëshkim kaluan edhe ish-ministrat e MKRS-së, Astrit Haraqija dhe Valton Beqiri.

Ata bënë pjesë në një aktakuzë, e cila pretendonte se gjatë mandatit të tyre në këtë ministri, përmes kontratave për projekte filmike i kanë shkaktuar dëm ministrisë 570,000 euro. Ata ishin dënuar nga shkalla e parë më një (1) burgim me kusht por Apeli, Beqirin e kishte liruar, kurse akuzat ndaj Haraqisë ishte parashkuar.

Përpos tyre, aktakuzat për korrupsion të ngritura nga PSRK-ja, dështuan edhe ndaj ish-kryetarit të Gjykatës së Apelit Sali Mekaj, ish-kryetarit të OSHP-së Hysni Hoxha, që bënte pjesë në dy aktakuza dhe ndaj zyrtarit tjetër të OSHP-së, Hysni Muhadri.

I akuzuari	Prokurori/ja	Vendimi i formës së prerë
Agim Bahtiri	Agron Bajrami	Hudhje
Lutfi Haziri	Ali Rexha	Hudhje
Pal Lekaj	Sylë Hoxha	Hudhje
Ragip Begaj	Abdurrahim Islami	Hudhje
Sokol Bashota	Valaria Bolici	Refuzim
Dalibor Jevtiq	Sylë Hoxha	Hudhje
Ramë Buja	Ali Rexha	Hudhje
Astrit Haraqija	Drita Hajdari	Refuzim
Valton Beqiri	Drita Hajdari	Lirim
Sali Mekaj	Drita Hajdari	Lirim
Hysni Hoxha	Tomas Meskauskas	Refuzim

Tabela 2. Vendimet e gjykatave për aktakuzat e PSRK-së për profilin e lartë, të viteve 2016-2018.

9. Trajtimi i krimeve të luftës nga ana e PSRK-së

Gjatë vitit 2016, në kuadër të PSRK-së ishte formuar një departament i veçantë, qëllimi i së cilës është hetimi i krimeve të luftës dhe krimeve të tjera ndërkombëtare.

Deri në atë kohë, këto vepra penale ishin në kompetencë të misionit të EULEX-it, derisa ishte vendosur që nga viti 2016, këtë detyrë ta merr PSRK.

9.1. Ngarkesa me lëndë të krimeve të luftës në PSRK

Bazuar në raportet vjetore të PSH-së, gjatë viteve 2016, 2017, 2018 dhe 2019, ky departament ka zgjidhur 196 lëndë, ndërsa numri i lëndëve të cilat kanë mbetur të pazgjidhura ka qenë 2,940.

Mirëpo nga gjithsej 196 lëndë të zgjidhura për këto katër vitet raportuese, vetëm ndaj 11 personave ka pasur ngritje të aktakuzës, dy (2) në vitin 2016, katër (4) gjatë vitit 2017, dy (2) në vitin 2018 dhe tri (3) në vitin 2019⁵⁹.

Gjatë vitit 2016, PSRK-ja ka pasur në punë 359 raste me 1,531 persona, prej të cilave, 33 raste me 73 persona janë zgjidhur, ndërsa 326 lëndë me 1,458 persona kanë mbetur të pazgjidhura.

Nga gjithsej 73 persona për të cilët janë zgjidhur lëndët, PSRK-ja kishte pushuar hetimet për 47 prej tyre, për 17 persona kishte hedhur kallëzimin penal, për katër (4) persona kishte cedim në kompetencë, ndërsa vetëm ndaj pesë (5) personave ishte ngritur aktakuzë.

Gjatë vitit 2017 PSRK-ja ka pasur në punë 799 lëndë, ku 25 lëndë janë zgjidhur, ndërsa 774 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura, ndërsa lidhur me mënyrën e zgjidhjes së tyre, PSH-ja nuk ka paraqitur të dhëna për këtë vit.

Gjatë vitit 2018, në punë kanë qenë 720 lëndë, prej të cilave, 16 lëndë me 62 persona janë zgjidhur, ndërsa 704 kanë ngelur të pazgjidhura. Nga gjithsej 62 persona, PSRK kishte ngritur aktakuzë për dy (2) prej tyre, ndaj një (1) personi kishte bërë bashkimin e procedurës, për 41 persona kishte deleguar kompetencën, ndërsa ndaj 18 personave kishte pushuar hetimet.


Kurse, gjatë vitit 2019, në punë kanë qenë 1,288 lëndë dhe në këtë vit, krahas zgjidhjes më të madhe të lëndëve për të gjitha kallëzimet penale, ka pasur ngritje të lëndëve të zgjidhura edhe për rastet e krimeve të luftës. Në këtë vit, sipas raportit të punës së PSH-së⁶⁰, janë zgjidhur 122 raste ndërsa 1,166 lëndë kanë mbetur të pazgjidhura. Edhe pse në bazë të këtij raporti, është thënë se PSH-ja ka zgjidhur 122 raste, në pjesën e mënyrës së zgjidhjes së tyre, ka pasqyruar vetëm zgjidhjen e 14 rasteve, në të cilat janë përfshirë 27 persona, ndërsa nuk është sqaruar edhe mënyrën e zgjidhjes së 108 rasteve të tjera. Një qasje e tillë sipas IKD-së, paraqet një mos

⁵⁹ Përgjigja për IKD-në e zëdhënësit të PSRK-së, Ekrem Lutfiu. 27.04.2020.

⁶⁰ “Raporti i Punës i Prokurorit të Shtetit 2019”. (shih linkun: <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Raporte/Raporti%20i%20pun%C3%ABs%20s%C3%AB%20Prokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit%2C%20p%C3%ABr%20vitin%202019.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 10.06.2020).

transparencë në mënyrën e zgjidhjes së rasteve nga ana e PSH-së, për një kategori shumë të rëndësishme të veprave penale⁶¹.

Nga lëndët e zgjidhura në të cilat janë përfshirë 27 persona, PSRK-ja ka ngritur aktakuzë ndaj katër (4) prej tyre, ndaj dy (2) personave kishte bërë bashkimin e procedurës, për 18 persona i kishte deleguar kompetencën, ndërsa ndaj tre (3) personave kishin pushuar hetimet.



Grafiku 6. Ngarkesa me lëndë të krimeve të luftës në PSRK gjatë viteve 2016-2019.


⁶¹ Po aty. Faqe 20 dhe 21.

10. Transparenca e PSRK-së gjatë vitit 2019

Në këtë raport hulumtues IKD ka analizuar edhe transparencën dhe llogaridhënien e PSRK-së.

Edhe pse në të gjitha raportet e punës së Prokurorit të Shtetit, theksohet se puna e PSH-së është transparente për publikun, nga të dhënat lidhur me kërkesat për qasje në dokumente zyrtare dhe informata që IKD duke u bazuar në Ligjin për Qasje në Dokumentet Publike ka parashtruar në PSRK, rezulton se kjo prokurori ka një qasje jo-transparente përballë publikut, e cila qasje manifestohet nëpërmjet mos zbatimit të dispozitave ligjore të përcaktuara në Ligjin nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.

Gjatë vitit 2019, nga 200 kërkesa për qasje në dokumente zyrtare dhe informata që IKD ia kishte drejtuar sistemit prokurorial, 19 prej tyre i janë drejtuar PSRK-së. Nga ky total i kërkesave, vetëm 31.58 % apo gjashtë (6) prej tyre kanë qenë përgjigje pozitive nga ana e PSRK-së, derisa në dy (2) kërkesa të IKD-së, apo 10.53%, PSRK ka refuzuar të jap përgjigje përkatësisht ka dhënë përgjigje negative, ndërsa mbi gjysma e kërkesave, 11 prej tyre, apo 57.89% PSRK nuk ka kthyer fare përgjigje.



Grafiku 7: Transparenca e PSRK-së gjatë vitit 2019.

11. Krijimi dhe mandati ligjor i Departamentit Special (DS) të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit

Më 2 janar 2020 ka hyrë në fuqi Ligji nr.06/L-054 për Gjykatat, sipas të cilit ligj është përcaktuar themelimi i Departamentit Special për Lëndët në Kompetencë të PSRK-së në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit.

Deri në miratimin e këtij ligji, të gjitha lëndët e PSRK-së janë trajtuar nga Departamentet për Krime të Rënda në kuadër të Gjykatave Themelore, derisa pas miratimit të këtij ligji, kjo kompetencë ka kaluar në këtë departament special.

11.1. Rruga deri te krijimi i DS-së

Në më pak se një muaj pasi Kuvendi i Republikës së Kosovës kishte shpallur pavarësinë e saj, më 13 mars 2008, kishte miratuar Ligjin nr. 03/l-052 për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, me të cilin ligj kishte themeluar Prokurorinë Speciale e cila do të vepronte si organ i specializuar i Prokurorit të Shtetit.

Mirëpo, fatkeqësisht, është dashur që të kalojnë më shumë se 10 vite derisa kësaj prokurorie i është krijuar një adresë gjyqësore ekuivalente. Kjo pasi që deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, aktakuzat e PSRK-së ishin trajtuar nga Departamentet për Krime të Rënda në kuadër të Gjykatave Themelore.

Me anë të Ligjit nr. 06/L-054 për Gjykatat, i cili ka hyrë në fuqi më 2 janar 2019, është themeluar Departamenti Special për Lëndët në Kompetencë të PSRK-së, që do të veprojë në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, por që në bazë të këtij ligji, është funksionalizuar nga KGJK më 1 korrik 2019.

Derisa në raportet vjetore të publikuara nga KGJK-ja, shihej se çdo vit rritej numri i lëndëve në raftet e gjykatave, proceset e filluara gjyqësore në bazë të monitorimit të IKD-së tregonin se në 90% të rasteve nuk respektohej neni 314 të Kodit të Procedurës Penale [*Koha për përfundimin e shqyrtimit gjyqësor*]⁶² e as neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut [*E drejta për një proces të rregullt*].

Me qellim të adresimit konkret të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, IKD në gushtin e vitit 2017 kishte propozuar që Kosova përmes amandamenteve kushtetuese të krijonte një Gjykatë dhe Prokurori Speciale. Në këtë drejtim, IKD rithekson se në këtë situatë të krijuar, e cila shpesh shihet e pashpresë, nevojitet krijimi i një Prokurorie dhe Gjykate Speciale, si institucione tërësisht të pavarura, me mandat të kufizuar, me staf të rekrutuar nga bashkësia ndërkombëtare, përkatësisht SHBA dhe Britania e Madhe.⁶³

⁶² *Shënim*: Sipas paragrafit 1 të nenit 314 të KPP-së, shqyrtimi gjyqësor para gjyqtarit të vetëm gjykues duhet të përfundohet brenda 90 ditësh, ndërsa para trupit gjykues brenda 120 ditësh.

⁶³ Musliu B. dhe Miftaraj E. “*Prokuroria dhe Gjykata Speciale e Republikës së Kosovës*”. IKD. qershor 2017. (shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2017/08/1.-PSRK-IKD-EMBM-Final-29.08.2017-1.pdf>). (Qasur për herë të fundit 16.04.2020).

Në raportin e IKD-së përkitazi me themelimin e Prokurorisë dhe Gjykatës Speciale rekomandohej që procesi i rekrutimit dhe emërimit për prokuror dhe gjykatës të udhëhiqet ekskluzivisht nga faktori ndërkombëtar, respektivisht nga SHBA dhe Britania e Madhe. “Prokuroria dhe Gjykata për punën dhe rastet e tyre nuk do të kenë asnjë obligim për të raportuar para KPK, KGJK apo Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit; Juridiksioni kohor i prokurorisë të kufizohet brenda 5 viteve nga themelimi i saj të finalizoj dhe paraqes aktakuzat në gjykatë, me mundësi vazhdimi varësisht prej rezultateve” thuhej në raportin e IKD-së.⁶⁴

Një vit e disa muaj pas këtij raporti, Kuvendi i Kosovës kishte miratuar Ligjin nr. 06/L – 054 për Gjykatat, me të cilin ishte paraparë që në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit të krijohet Departamenti Special për Lëndën në Kompetencë të PSRK-së.⁶⁵

Funksionalizimin e këtyre departamenteve, akteret e sistemit të drejtësisë, e kishin vlerësuar si hap pozitiv në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit⁶⁶.

Kur kanë kaluar më shumë gjashtë (6) pas funksionalizimit të departamenteve speciale në shkallë të parë dhe atë të dytë, kryesuesi i KGJK-së punën e deritashme të këtyre departamenteve e sheh shumë të mirë dhe sipas tij me krijimin e tyre do të ndikohet në ngritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor, ndërsa sipas tij, deri më tani nuk ka pasur ndonjë sfidë të veçantë, në punën e këtyre departamenteve⁶⁷.



“Konsideroj se ky Departament do të ndikoj në rritjen e efikasitetit në sistemin gjyqësor.”

Skender Çoçaj,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK)

Ndërsa përpos sistemit gjyqësor, themelimin e këtij departamenti, si hap të rëndësishëm për funksionimin e drejtësisë e konsideron edhe kryeprokurori i PSRK-së Blerim Isufaj. “Konsideroj se themelimi i Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ka pasur ndikim mjaftë pozitiv në punën e PSRK, deri më tani mund të konstatojmë

⁶⁴ Po aty.

⁶⁵ Ligji nr. 06/L – 054 për Gjykatat. Neni 13.1.1 “1.1. “Në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë, vepron departamenti Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, me kompetencë për tërë territorin e Republikës së Kosovës”.

⁶⁶ “Funksionalizohet Departamenti Special në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Themelore në Prishtinë”. KGJK. 8 korrik 2019. (Shih linkun: <https://www.gjyqesori-rks.org/2019/07/08/funksionalizohet-departamenti-special-ne-gjykatën-e-apelit-dhe-ne-gjykatën-themelore-ne-prishtinë/>).

⁶⁷ Përgjigja për IKD-në, e kryesuesit të KGJK-së, Skender Çoçaj. 29.04.2020.

në së paku këto drejtime: Do të rritet efikasiteti i punës së PSRK-së, pasi që prokurorët nuk do të humbin kohë në udhëtime në regjione tjera për të përfaqësuar aktakuzat në gjykata, do të unifikohet praktika gjyqësore, pasi që deri më tani numri i gjyqtarëve që kanë trajtuar këto raste ka qenë shumë më i madh (në të gjitha gjykatat e Kosovës), do të unifikohet politika e dënimeve, etj”.

11.2. Mandati ligjor i DS-së

Sipas këtij ligji, Departamenti Special, do të trajtoj vetëm lëndët të cilat janë kompetencë të PSRK-së, në të cilin departament do të gjykojnë trupi gjykues prej tre (3) gjyqtarëve⁶⁸.

Neni 32 i këtij ligji [Kushtet e veçanta për gjyqtarë] ka përcaktuar që për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në këtë departament, duhet të plotësohen kushtet për të punuar si gjyqtar i Departamentit të Krimeve të Rënda⁶⁹ dhe të ketë vlerësim të mirë të përfomancës.

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, lëndët e PSRK-së, për të cilat nuk është mbajtur shqyrtimi fillestar, do të trajtohen nga DS-ja, ndërsa lëndët për të cilat është mbajtur ky shqyrtim, do të vazhdojnë të trajtohen nga ato departamente të gjykatave. Ndërsa, ngjashëm do të veprohet edhe me lëndët që pranohen në Gjykatën e Apelit, ato që do të pranohen pas hyrjes në fuqi të ligjit do të trajtohen nga DS-ja e Apelit, ndërsa ato që janë pranuar në këtë gjykatë para hyrjes në fuqi të ligjit, do të vazhdojnë të trajtohen nga kolegjet tjera të GjA-së⁷⁰.

Ndërsa, është përcaktuar që gjyqtarët të cilët do të gjykojnë në DS, mund të angazhohen edhe në trupe gjyqësore në DKR-në e Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe atë të Apelit.

11.3. Parregullsitë në funksionalizimin e DS-ve

Ligji nr. 06/L – 054 për Gjykatat, kishte hyrë në fuqi më 5 janar të vitit 2019 dhe sipas paragrafit 1 të nenit 42 të këtij ligji është përcaktuar që “*Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më së largu gjashtë muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, do të përzgjedh gjyqtarët të cilët do të shërbejnë në Departamentin Special për lëndët në kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, përkatësisht në Departamentin për lëndët në kompetencë të PSRK-së, në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës dhe Gjykatës së Apelit, në pajtim me dispozitat e ligjit në fuqi*”. Ndërsa sipas paragrafit 2 të këtij neni ishte përcaktuar që “*Këshilli Gjyqësor i Kosovës, duhet gjithashtu të ndërmarrë të gjitha masat për të funksionalizuar Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe asaj të Apelit, duke përfshirë rekrutimin e stafit mbështetës si dhe bashkëpunëtorëve profesionalë*”.⁷¹

KGJK-ja, veprimet e para për funksionalizimin e këtij obligimi ligjor i kishte ndërmarrë menjëherë pasi kishte hyrë në fuqi Ligji nr.06/L-054 për Gjykatat, derisa në takimin e mbajtur

⁶⁸ Po aty. Neni 18.

⁶⁹ *Shënim*: Sipas paragrafit 1, pika 1.1 të Ligjit nr. 06/L – 054 për Gjykatat, për të ushtruar funksionin e gjyqtarit në Departamentin për Krime të Rënda apo për të Mitur në Gjykatën Themelore, kandidati duhet të ketë së paku tre (3) vite përvojë si gjyqtar në lëmin penal.

⁷⁰ Po aty. Neni 42.3,4 dhe 5.

⁷¹ Po aty. Neni 42.1 dhe 2.

më 23 prill 2019, kishte miratuar Rregulloren nr.03/2019 për Organizimin dhe Funkcionalizimin e Departamentit Special në Kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit.⁷²

Me anë të kësaj rregulloreje, KGJK, kishte përcaktuar kriteret dhe procedurat për rekrutimin e gjyqtarëve dhe stafit mbështetës që do të veprojnë në këtë departament. Në të njëjtën ditë, KGJK po ashtu kishte shpallur konkurs për gjyqtarë në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe atë të Gjykatës së Apelit.⁷³

Pas konkursit të shpallur, KGJK, në mbledhjen e 28 qershorit të vitit 2019, kishte emëruar nëntë (9) gjyqtarë në këto departamente, gjashtë (6) prej tyre në shkallën e parë dhe tre (3) të tjerë në Gjykatën e Apelit⁷⁴, ndërsa puna e tyre do të fillonte më 1 korrik 2019, duke shtyrë në maksimum kërkesën ligjore me të cilën maksimumi i funksionalizimit të departamenteve speciale në të të dy shkallët e gjykatëve ishte gjashtë (6) muaj nga hyrja në fuqi.

Për Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, KGJK kishte emëruar gjyqtarët: Valbona Musliu – Selimaj, Valon Kurtaj, Arben Hoti, Albina Shabani – Rama, Musa Konxheli, dhe Shadije Gërguri, derisa në Departamentin Special të Gjykatës së Apelit, KGJK kishte emëruar gjyqtarët Kreshnik Radoniqi, Vatton Durguti dhe Burim Ademi.

Gjyqtarët e lartcekur nga data 1 Korrik 2019, kanë filluar punën në Departamentin Special të Gjykatave përkatëse⁷⁵

Mirëpo procesi i rekrutimit nuk ka zbatuar rregullat që vet ishin përcaktuar me konkursin e shpallur për gjyqtarë nga vet KGJK-ja.

Në takimin e mbajtur me 23 prill 2019, KGJK ka nxjerrë vendimin KGJK.nr.87/2019 për shpalljen e konkursit për pozita të lira për gjyqtarë. Neni 1 i këtij vendimi përcakton që “Të shpallet konkurs i brendshëm për pesëmbëdhjetë (15) pozita të lira për gjyqtar, të cilët do të ushtrojnë funksionin e tyre në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit”. Por, numri i pozitave të lira për gjyqtarë nuk ishte cekur fare në takimin e 23 prillit 2019, të cilin e kishte monitoruar IKD. Gjatë këtij takimi, KGJK vetëm ka shpallur konkurs për gjyqtarë në këtë departament, por nuk ka përcaktuar fare numrin e

⁷² “Rregullorja nr.03/2019 për Organizimin dhe Funkcionalizimin e Departamentit Special në Kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit”. (Shih linkun: https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/lgs/57641_Rregullore_Nr.03_2019_per_Organizimin_Funksionalizimin_Departamentit_Special_Kuader_Gjykates_Themelore_Prishtine_Gjykates_Apelit.pdf). (Qasur për herë të fundit 17.04.2020).

⁷³ “Funkcionalizohet Departamenti Special, KGJK-ja shpall konkurs për gjyqtarë”. Betimi për Drejtësi. 23 prill 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/funksionalizohet-departamenti-special-kgjk-ja-shpall-konkurs-per-gjykates/>). (qasur së fundi më 17 mars 2020).

⁷⁴ “KGJK-ja, emëroi Gjyqtarët në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit”. 28 qershor 2019. KGJK. (<https://www.gjyqesori-rks.org/2019/06/28/kgjk-ja-emeroi-gjyqtaret-ne-departamentin-special-ne-kuader-te-gjykates-themelore-ne-prishtine-dhe-gjykates-se-apelit/>). (Qasur së fundi më 17 mars 2020).

⁷⁵ “KGJK-ja, emëroi Gjyqtarët në Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe Gjykatës së Apelit” KGJK. 28 qershor 2019. (Shih linkun: <https://www.gjyqesori-rks.org/2019/06/28/kgjk-ja-emeroi-gjyqtaret-ne-departamentin-special-ne-kuader-te-gjykates-themelore-ne-prishtine-dhe-gjykates-se-apelite/>). (Qasur së fundi më 17 mars 2020).

pozitive të lira për gjyqtarë. Të paktën, kjo nuk është përmendur gjatë këtij takimi të KGJK-së. Po ashtu, vetë ky vendim kishte përcaktuar numrin total të pozitive të lira për gjyqtarë në Departamentin Special, duke mos specifikuar fare se sa pozita të lira për gjyqtarë janë për Departamentin Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë e sa për Departamentin Special në kuadër të Gjykatës së Apelit.⁷⁶

Më 23 prill 2019, KGJK kishte shpallur konkurs për nëntë (9) pozita të lira për gjyqtarë të Departamentit Special pranë Gjykatës themelore në Prishtinë dhe tre (3) gjyqtarë në Departamentin Special pranë Gjykatës së Apelit, që në total i bie 12 gjyqtarë. Pra, përkundër faktit se në vendimin e KGJK-së ishte përcaktuar se konkursi shpallet për 15 pozita të lira, KGJK e kishte shpallur konkursin për vetëm 12 gjyqtarë. Për më tepër, vetë konkursi nuk votohet fare në KGJK, por votohet vendimi për shpalljen e konkursit, ndërsa konkursi i publikuar duhet të jetë në përputhje totale me vendimin e miratuar në takim të KGJK-së.

KGJK nuk ka dhënë asnjëherë asnjë arsytim se pse nuk e kishte përcaktuar në vendimin e miratuar numrin e gjyqtarëve të Departamentit Special pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe këtij departamenti pranë Gjykatës së Apelit, përkundër faktit se vendimi i miratuar përcaktonte 15 pozita të lira ndërsa konkursi ishte shpallur për 12 pozita të lira. Ndërsa, përkundër faktit se konkursi ishte shpallur për nëntë (9) pozita të lira për Gjyqtarë të Departamentit Special pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, KGJK më 28 qershor 2019 kishte emëruar vetëm gjashtë (6) Gjyqtarë në këtë departament. As këtë fakt KGJK nuk e ka sqaruar asnjëherë⁷⁷.

Në përgjigjen e Kryesuesit të KGJK-së Skender Çoçaj të dhënë për qëllim të këtij hulumtimi ka theksuar se rekrutimi i vetëm nëntë (9) gjyqtarëve është bërë, pasi ka qenë hera e parë që është themeluar një departament i tillë dhe me kohen do të rritet numri i gjyqtarëve⁷⁸.

Ndërsa në përgjigjet e tyre në intervistat që ka realizuar IKD-ja, me udhëheqësin e DS-së në Gjykatën e Apelit Vaton Durguti⁷⁹ dhe udhëheqësin e DS-së në Gjykatën Themelore në Prishtinë Valon Kurtaj⁸⁰, të njëjtit si sfida të punës së këtyre departamenteve e kanë theksuar edhe numrin e vogël të gjykatësve.

⁷⁶ Shala.G. “Progresi dhe Regresi i Këshillave”. Nëntor 2019. (Shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/12/IKD-Progresi-dhe-regresi-i-Keshillave-1-prill-30-qershor-2019.pdf>). (Qasur së fundi më 17 mars 2020).

⁷⁷ Po aty.

⁷⁸ Përgjigja për IKD-në, e kryesuesit të KGJK-së, Skender Çoçaj. 29.04.2020. “Ka qenë hera e parë që krijohet një departament i tillë, prandaj kemi startuar e këtë numër të gjyqtarëve në mënyrë që varësisht prej zhvillimeve të rritet numri i gjyqtarëve. Numri i gjyqtarëve në Departamenti Special pritet të rritet, menjëherë pas kalimit të situatës me Pandemi, KGJK planifikon të shpallë konkurs për Departamentin Special”.

⁷⁹ Përgjigja për IKD-në, e udhëheqësit të DS-së të Gjykatës së Apelit, Vaton Durguti. 24.04.2020.

⁸⁰ Përgjigja për IKD-në, e udhëheqësit të DS-së të Gjykatës Themelore në Prishtinë. 13.05.2020.

11.4. Mos pajtimet e gjyqtarëve të Departamentit të Krimeve të Rënda të Gjykatës Themelore në Prishtinë me Ligjin për Gjykatat

Edhe pse bartësit e sistemit të drejtësisë kishin theksuar se me krijimin e këtyre departamenteve do të rritej efikasiteti i punës së Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe asaj të Apelit, për mënyrën e themelimit dhe veprimtarisë së tyre, brenda sistemit të drejtësisë kishte edhe të pakënaqur.

Më 4 nëntor të gjithë gjykatësit e Departamentit të Krimeve të Rënda, të Gjykatës Themelore në Prishtinë, i ishin drejtuar Gjykatës Kushtetuese⁸¹, duke pretenduar se paragrafi 4 i nenit 42⁸² të Ligji nr. 06/L – 054 për Gjykatat, është në kundërshtim me kushtetutën.

Gjykatësit e DKR-së në Prishtinë, pretendonin se ky nen i Ligjit për Gjykatat, nuk është në harmoni me nenin 31 të Kushtetutës së Kosovës [[E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe nenin 6 të KEDNJ-së [E drejta për një proces të rregullt].

Thelbi i kërkesës së parashtruesve të kërkesës konsiston në pretendimin se neni 42, paragrafi 4 i Ligjit për Gjykatat, duke përcaktuar që lëndët që bien në kompetencë të Departamentit Special, por për të cilat është mbajtur shqyrtimi fillestar do të vazhdojnë të procedohen në gjykatat përkatëse, rrjedhimisht në kuadër të Departamentit për Krime të Rënda, cenon nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së .

Parashtruesit e kërkesës argumentet e tyre lidhur me kushtetutshmërinë e Ligjit për Gjykatat i ndërtojnë duke u bazuar në parimin e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm kohor në çështje penale ku theksojnë se gjykimi i lëndëve që referohen nga Prokuroria Speciale Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: PSRK) nga Departamenti i Krimeve të Rënda e jo nga Departamenti Special do ta vështirësonte gjykimin e këtyre çështjeve penale brenda afatit të arsyeshëm kohor. Në lidhje me këtë, parashtruesit e kërkesës përmendin disa raste duke potencuar se “[...] është rasti “Medicus”, i cili është në gjykim më tepër se 10 vite, dhe gjykimi ende vazhdon, pastaj rastet “Toka 1 dhe 2”, “Syri i Popullit”, “Veteranët”, “Vizat” si dhe shumë lëndë të tjera të kësaj natyre.”⁸³

Gjyqtarët e DKR-së përmes kërkesës së tyre që ia kishin drejtuar Gjykatës Kushtetuese, kishin vlerësuar se nëse ata do të vazhdonin të gjykonin lëndët e PSRK-së, do të shkelet parimi për

⁸¹ *Shënim*: Kërkesa është parashtruar nga gjyqtarët Suzana Qerkini, Shpresa Hasaj Hyseni, Isuf Makolli, Shasivar Hoti, Violeta Namani, Naser Foniqi, Nushe Kukaj Meka, Beqir Kalludra, Vesel Ismajli, Lutfi Shala, Naime Jashanica.

⁸² Ligji nr. 06/l – 054 për Gjykatat. Neni 42.4. “Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, lëndët e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, për të cilat ende nuk është mbajtur shqyrtimi fillestar, do të transferohen për shqyrtim në Departamentin Special për Lëndët në Kompetencë të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Lëndët për të cilat është mbajtur shqyrtimi fillestar, do të vazhdojnë të shqyrtohen në gjykatat përkatëse, deri në përfundimin e tyre”.

⁸³ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës. Aktvendim për papranueshmëri. Rasti nr.KO197/19. 18 shkurt 2020. Paragrafi 14. (Shih linkun https://gjk-ks.org/wp-content/uploads/2020/02/ko_197_19_av_shq.pdf). (Qasur për herë të fundit më 12 qershor 2020).

gjykim të drejtë pasi të akuzuarit do të gjykoheshin nga një nivel jo i përgatitur mirë pasi për trajtimin e këtyre lëndëve, ngase sipas tyre ishte zhvilluar një proces i rekrutimit.

Parashtruesit e kërkesës po ashtu theksojnë se *“Departamenti special është themeluar për të shqyrtuar lëndët të cilët janë në kompetencë të PSRK-se, e që janë raste që kanë të bëjnë me vepra penale të një natyre veçanërisht të rëndë, dhe në funksion të natyrës së këtyre rasteve edhe është zhvilluar një procedurë e veçantë e përzgjedhjes së gjyqtarëve, i cili proces është strukturuar mbi disa kushte, të cilat është dashur t’i plotësoj gjithsecili që ka pretenduar të përzgjidhet si gjyqtar në kuadër të këtij departamenti, andaj gjyqtarët të cilët janë përzgjedhur është vlerësuar se janë të vetmit që mund të gjykojnë lëndë të kësaj natyre”*⁸⁴.

Mirëpo me arsyetimin se sipas nenit 113, paragrafit 8 të Kushtetutës së Kosovës [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara], palë e autorizuar për ta kontestuar një ligj, duke u bazuar edhe në praktikën e mëhershme të kësaj gjykate, është vetëm kryetari i gjykatës ose një gjyqtar apo një kolegji që ka në trajtim një çështje e jo 11 gjyqtarë të një departamenti, Gjykata Kushtetuese, kërkesën e tyre e kishte konsideruar si të papranueshme.

*“Gjykata vëren se rasti i parashtruesve të kërkesës, dallon nga rastet e lartcekura. Gjykata rikujton se në rastin konkret, kërkesa nuk është dorëzuar as nga një kolegji gjyqësor që ka rastin në shqyrtim e as nga Kryetari i Gjykatës Themelore në kuadër të autorizimeve që lidhen me funksionin e tij saj, por është dorëzuar dhe nënshkruar nga njëmbëdhjetë (11) gjyqtarë të Gjykatës Themelore në Prishtinë, respektivisht gjyqtarë të Departamentit për Krime të Rënda, të cilët e kontestojnë në mënyrë abstrakte përputhshmërinë e paragrafit 4, të nenit 42 të Ligjit për Gjykatat me nenin 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së”*⁸⁵.

⁸⁴ Po aty. Paragrafi 16.


⁸⁵ Po aty. Paragrafi 31.

12. Ngarkesa me lëndë e Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë gjatë vitit 2019 dhe efikasiteti i saj

Edhe pse Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë, është funksionalizuar në fillim të muajit korrik, në bazë të raportin statistikor të të dhënave të kësaj gjykate⁸⁶, gjatë periudhës gjashtë (6) mujore, korrik-dhjetor 2019, ky departament ka pranuar gjithsej 79 lëndë.

Mirëpo gjatë kësaj periudhe, gjashtë (6) gjyqtarët e këtij departamenti kanë arritur të zgjidhin vetëm tetë (8) lëndë.

Nga tetë (8) lëndët e zgjidhura, gjashtë (6) prej tyre hynë në kapitullin e veprave penale kundër rendit kushtetues të Kosovës, një (1) lëndë i takon veprave penale kundër ekonomisë dhe një (1) tjetër ka të bëjë me veprën penale të narkotikëve], 62 kanë mbetur të pa zgjidhura dhe janë bartur për vitin 2020, si dhe nëntë (9) lëndë janë dërguar në kompetencë brenda gjykatës [një (1) kundër rendit kushtetues, një (1) kundër të drejtës ndërkombëtare, pesë (5) kundër jetës dhe trupit, një (1) kundër ekonomisë, si dhe një (1) lëndë e veprës penale të armëve].



Grafiku 8. Ngarkesa me lëndë e DS-së së Gjykatës Themelore në Prishtinë, në vitin 2019.

Nga 79 lëndë të pranuar gjatë vitit 2019, 27 prej tyre u takojnë veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës, 15 lëndë u takojnë veprave penale kundër ekonomisë, tetë (8) lëndë u takojnë veprave penale të narkotikëve, shtatë (7) lëndë janë korrupsion, aq sa janë edhe krim i organizuar, gjashtë (6) lëndë u takojnë veprave penale kundër jetës dhe trupit, pesë (5) lëndë u takojnë veprave kundër njerëzimit dhe vlerave të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare, si dhe nga dy (2) lëndë u takojnë veprave kundër pasurisë dhe veprave penale lidhur me armët.

Nga 27 lëndë kundër rendit kushtetues dhe sigurisë, 19 prej tyre janë vepra penale “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”, katër (4) prej tyre janë “përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë”, dy (2) janë nga vepra penale “shtytja

⁸⁶ Përgjigja për IKD-në e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë. 15 maj 2020.

për kryerjen e veprave terroriste”, një (1) nga vepra “ndihma në kryerjen e terrorizmit” dhe një (1) nga vepra penale “nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik”.

Nga 15 vepra kundër ekonomisë, shtatë (7) u takojnë veprës penale “shpëlarja e parave”, pesë (5) “shmangie nga tatimi”, dy (2) “keqpërdorim i autorizimeve ekonomike”, dhe një (1) “organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm”.


Nga tetë (8) veprat të narkotikëve, 7 (shtatë) kanë të bëjnë me veprën penale “blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, ndërsa një (1) veprës penale “prodhimi dhe përpunimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope, analoge apo veglave, pajisjeve apo materialeve narkotike”.

Nga shtatë (7) lëndë të korrupsionit, të gjitha kanë të bëjnë me veprën penale “keqpërdorimi i pozitës apo i autoritetit zyrtar”, ndërsa po ashtu shtatë (7) lëndë të tjera kanë të bëjnë me veprën penale “pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar”.

Nga gjashtë (6) lëndë kundër jetës dhe trupit, nga një (1) lëndë është këto vepra penale “vrasja”, “vrasje e rëndë”, “vrasje e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore”, “kanosja”, “sulmi”, “lëndim i rëndë trupor”.


Nga dy (2) vepra penale kundër pasurisë, një (1) lëndë i takon veprës penale “detyrimi” dhe një (1) tjetër “mashtrimi”.

Si dhe dy (2) lëndë të tjera, kanë të bëjnë me veprën penale “importi, eksporti, furnizimi, transportimi, prodhimi, këmbimi, ndërmjetësimi ose shitja e paautorizuar e armëve apo materieve plasëse”.



Grafiku 9. Lëndët e pranuar në DS-në e Gjykatës Themelore në Prishtinë, në vitin 2019 sipas kapitullit të veprave penale.

Nga tetë (8) lëndët e përfunduara në vitin 2019 nga ky departament, Gjykata Themelore e Prishtinës ka shqiptuar 4 dënime me burgim efektiv, 3 dënime me kusht, si dhe një dënim me gjobë.




Grafiku 10. Format e aktgjyqimeve e lëndëve të kryera nga DS i Gjykatës Themelore në Prishtinë, në vitin 2019.

Dënimet me burgim janë shqiptuar ndaj kryerve të veprave penale “kryerja e veprës terroriste”, “shtytja për kryerjen e veprave terroriste”, “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”, dhe “blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”.

Dënimet me kusht janë shqiptuar për kryerjen e veprës penale “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”.

Ndërsa një dënim me gjobë është shqiptuar për kryerjen e veprës penale “shmangia nga tatimi”.



Grafiku 11. Politika ndëshkimore e DS të Gjykatës Themelore në Prishtinë, në vitin 2019 sipas kapitullit të veprave penale.

Lidhur me funksionimin e DS-së në Prishtinë, IKD ka zhvilluar një intervistë me udhëheqësin e këtij departamenti, gjyqtarin Valon Kurtaj⁸⁷.

⁸⁷ Përgjigja për IKD-në, e udhëheqësit të DS-së të Gjykatës Themelore në Prishtinë. 13.05.2020.

Sipas tij, nga koha e fillimit të punës së këtij departamenti, ata kanë pasur vështirësi në punën e tyre, mirëpo punën e këtij departamenti ai e ka vlerësuar si të suksesshëm dhe që do të ndikoj edhe në ngritjen e efikasitetit të punës së gjyqësorit.

Kurtaj, ka thënë se sfidë për punën e këtij departamenti ka qenë mungesa e stafit administrativ dhe profesional, hapësirat jo të përshtatshme për shkak të numrit të madh të lëndëve dhe mungesa e ngritjes së kapaciteteve përmes trajnimeve, praktikave të ndryshme e tryeza profesionale. Ai po ashtu si sfidë e ka përmendur edhe dallimin në mes pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve të PSRK-së.



“Përpos sfidave të dala gjatë funksionalizimit të këtij departamenti, ne vlerësojmë se departamenti ka bërë një punë të kënaqshme në kuadër të kompetencave të tij. Sa i përket efikasitetit në procedurë penale të çështjeve të cilat i janë caktuar këtij departamenti, mendojmë se me krijimin e këtij departamenti do të arrihet ky qëllim shumë i rëndësishëm. Departamenti Special, sikurse edhe i gjithë sistemi gjyqësor afektohet me sfidat e njëjta, por nga sfidat të cilat duhet të veçohen për këtë departament janë: rritja e numrit të gjyqtarëve në raport me numrin e prokurorëve special; rekrutimi i stafit administrativ dhe profesional (zyrtar ligjor, bashkëpunëtor profesional, referentë etj.); hapësirat më të mëdha të zyrave për shkak të lëndëve voluminoze; mbështetja në ngritjen e mëtejme të kapaciteteve profesionale (përmes trajnimeve, tryezave profesionale, trajnime online, intership të ndryshëm etj.) dhe nivelimi i pagës së gjyqtarëve me pagat e prokurorëve special”


Valon Kurtaj, Udhëheqës i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishinë

13. Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rasteve dhe punën e Departamentit Special

IKD ka hyrë në vitin e shtatë të monitorimit të punës së sistemit të drejtësisë, duke përfshirë këtu punën e KGJK-së dhe KPK-së, Gjykatave, degëve të Gjykatave dhe Prokurorive.


IKD krahas monitorimit sistematik të punës së sistemit gjyqësor në të gjitha gjykatat themelore dhe degët e tyre, sidomos trajtimin të rasteve të korrupsionit, e veçmas atij të profilit të lartë, ka monitoruar edhe rastet që bien në kompetencë të Departamentit Special.

Pra, që nga funksionalizimi i këtij departamenti më 1 korrik të vitit 2019 e deri më 31 dhjetor 2020, IKD ka monitoruar 64 seanca, në të cilat janë përfshirë 33 raste me 112 persona të akuzuar.



Grafiku 12. Statistikat nga monitorimi i IKD-së në Departamentin Special nga 1 korriku e deri më 31 dhjetor 2019.


Prej këtyre 64 seancave gjyqësore të monitoruara gjatë kësaj periudhe raportuese në Departamentin Special, janë mbajtur 45 apo 70% të seancave, ndërsa kanë dështuar të mbahen gjithsej 19 apo 30% e tyre, të cilat janë shtyrë për arsye të ndryshme.



■ Të mbajtura ■ Të shtyera


Grafiku 13. Seancat gjyqësore të mbajtura dhe të shtyra në Departamentin Special nga 1 korriku-31 dhjetor 2019, sipas monitorimit të IKD-së.

Sa i përket veprave penale të monitoruara në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjatë periudhës 1 korrik - 31 dhjetor 2019, rezulton se numri i madh i tyre i përkasin kategorisë së veprave penale të terrorizmit, me gjithsej 11 raste apo 33.33 %, gjashtë (6) apo 18.18 % të rasteve i përkasin veprave penale “krim i organizuar” të ndërlidhur me vepra tjera penale, gjashtë (6) apo 18.18 të rasteve të shpëlarjes së parave, katër (4) apo 12.12 % të rasteve i përkasin shitblerjes me narkotikë, dy (2) raste apo 6.06% i përkasin krimeve të luftës, dy (2) apo 6.06% raste i përkasin veprave penale “shmangie nga tatimi”, dhe 2 raste të tjera apo 6.06% i përkasin veprave penale nxitja e urrejtjes dhe keqpërdorim të autorizimeve në ekonomi).



Grafiku 14. Kategoritë e veprave penale të gjykuara në Departamentin Special nga 1 korriku-31 dhjetor 2019.

Bazuar në monitorimin sistematik të IKD-së në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjatë kësaj periudhe raportuese rezulton se në 11 raste me 13 persona, janë shpallur 13 aktgjykime dënuese, ndërsa nuk ka pasur asnjë aktgjykim lirues apo refuzues.



Grafiku 15. Vendimet e shpallura nga Departamenti Special nga 1 korriku e deri më 31 dhjetor 2019.

Nga këto 13 aktgjykime dënuese të shpallura nga gjyqtarët e Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjatë kësaj periudhe raportuese, rezulton se shtatë (7) dënime janë me burgim efektiv, gjashtë (6) dënime me burgim me kusht dhe tre (3) dënime me gjobë.

Nga shtatë (7) personat e dënuar me burgim efektiv, Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë, njërin prej tyre e ka dënuar me pesë (5) vite e gjashtë muaj burgim, një me katër (4) vite burgim, një me tri (3) vjet e gjashtë muaj burgim, një me tri (3) vjet, një me dy (2) vite, një me 20 muaj burgim dhe një person me gjashtë (6) muaj burgim.

Nga gjashtë (6) personat që janë dënuar me kusht, kjo gjykatë katër persona i ka dënuar secilin veç e veç me nga dy vite burgim me kusht, një person e ka dënuar me një (1) vit e gjashtë muaj burgim me kusht dhe një e ka dënuar me vetëm gjashtë (6) muaj burgim me kusht.

Mirëpo, duhet theksuar se kjo gjykatë ka shqiptuar edhe dënimin me gjobë në tri (3) raste, por jo si dënim kryesor, por si dënim kumulativ, pra së bashku me dënimin me burg (1 person), dhe atë me kusht (2 persona). Në një rast, ku të akuzuar kanë qenë dy persona për shmangie nga tatimi, gjykata krahas dënimit me kusht ka shqiptuar edhe gjobë, ku njërin e ka dënuar me gjobë në lartësi prej 3,500 euro, ndërsa personit tjetër ajo ka shqiptuar gjobë prej 1000 euro, dhe ndaj një personi të përfshirë në një rast të terrorizmit dhe keqtrajtimit apo braktisjes së fëmijës, ajo ka shqiptuar gjobë në lartësi prej 500 euro.

Krimet Speciale – Ligji vs Praktika

I akuzuari	Vepra Penale	Dënim me burg	Dënim me gjobë
Ivan Teodosijeviq	Nxitje e urrejtjes	2 vite burgim	
Bledart Elshani	Terrorizëm	20 muaj burgim	
Berat Qamili	Terrorizëm	6 muaj burgim	
Merita Aliu	Terrorizëm	2 vite burgim me kusht	
Nagjie Hasani	Terrorizëm	2 vite burgim me kusht	
Bunjamir Jaha	Shitblerje me narkotikë	3 vjet burgim	
Pajtim Hamiti	Shitblerje me narkotikë	3 vjet e gjashtë muaj burg	
Agon Misini	Terrorizëm	4 vjet burgim	
Florinda Zymeri	Terrorizëm	2 vite burgim me kusht	
Fidan Sokoli	shmangie nga tatimi	1 vit e gjashtë muaj burgim me kusht	3.500 euro gjobë
Liridon Sokoli	shmangie nga tatimi	6 muaj burg me kusht	1.000 euro gjobë
Visar Qukovci	Terrorizëm	5 vite e gjashtë muaj burg	500 euro gjobë

Agnesë Zuzaku	Terrorizëm	2 vite burgim me kusht	
---------------	------------	------------------------	--

Tabela 3. Dënimet me burg dhe me gjobë të shqiptuara nga gjykatësit e Departamentit Special nga 1 korriku-31 dhjetor 2019.

Sa i përket dënimeve të shqiptuara, Bunjamir Jaha dhe Pajtim Hamiti ishin shpallur fajtorë nga Gjykata Themelore në Prishtinë për veprën penale “blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”, nga neni 273 par.2 lidhur me nenin 281 par.1, nën par. 1,1 dhe nën par. 1,2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. I akuzuari Jaha për këtë veprë penale ishte dënuar me **tri vite burgim**, ndërsa i akuzuari Hamiti ishte dënuar me **tre vite e gjashtë muaj burgim**. Për këtë veprë penale, Kodi Penal ka paraparë se kryesi dënohet me gjobë dhe me burgim prej tre (3) deri në 15 vjet burgim. Ashpërsimin e dënimit ndaj Hamiti, gjykata e ka arsyetuar me faktin se ai ka qenë edhe më parë i dënuar për veprë penale. Përkundër asaj se Kodi Penal, për këtë veprë penale parasheh dënim kumulativ me gjobë dhe me burgim, gjykatësi ka shqiptuar vetëm dënim me burgim. Kjo paraqet shkelje esenciale të ligjit penal, e përcaktuar me nenin 385 [SHKELJA E LIGJIT PENAL], par.1 nën par. 1,5 të KPPK-së, për shkak se gjykatësi ka tejkalar kompetencat ligjore me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin.⁸⁸ Rrjedhimisht, një shkelje e tillë paraqet bazë të mjaftueshme për ushtrimin e ankesës ndaj këtij vendimi, dhe doemos edhe ndryshimin e atij vendimi sa i përket vendimit mbi dënimin. Ndaj këtij vendimi të nxjerrë nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë, brenda afatit ligjor kishte ushtruar ankesë mbrojtja e të akuzuarit Pajtim Hamiti, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal. Gjykata e Apelit, me aktgjykimin e nxjerrë më 18 shkurt 2020 kishte ndryshuar vendimin e gjykatës themelore vetëm për sa i përket cilësimit juridik, ashtu që ne veprimet e të akuzuarve ekzistojnë elementet e veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge, nga neni 273 paragrafi 2 lidhur me nenin 281 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 e 1.2.

Sa i përket pretendimeve të prezantuara nga IKD se në këtë rast gjykata nuk kishte zbatuar drejt dispozitat e KPRK-së, duke mos shqiptuar dënim kumulativ, duhet përmendur se edhe Apeli, kishte nxjerrë një konstatim identik, pra se gjykata themelore nuk kishte aplikuar drejt dispozitat e Kodit Penal edhe ne raport me dënimin me gjobë për veprën penale që janë shpallur fajtor. Mirëpo, Apeli në vendimin e saj, ka theksuar se përderisa ndaj këtij vendimi nuk kishte ushtruar ankesë Prokuroria Speciale, ndërsa kishte ankesë vetëm në dobi të të akuzuarit, dhe në mbështetje të nenit 395 të KPP-ës - Reformatio in Peius, kjo dispozite ligjore nuk lejon ndryshimin e aktgjykimit në dëm të të akuzuarit edhe sa i përket sanksionit penal pra dënimit me gjobë që nuk ishte shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë.

⁸⁸ Kodi NR. 04/L-123 i procedurës penale. Neni 385.1.1.5. “në marrjen e vendimit për dënim, dënim alternativ, vërejtje gjyqësore ose në marrjen e vendimit për masën e trajtimit të detyrueshëm për rehabilitim apo për konfiskim të dobisë pasurore të fituar me veprë penale gjykata ka tejkalar kompetencat ligjore”.

Në këtë mënyrë, mos ushtrimi i ankesës në Gjykatën e Apelit nga ana e Prokurorit të Shtetit në këtë rast paraqet dështim të këtij institucioni për të mbrojtur rastet gjyqësore nga gabimet që bëjnë gjykatat e shkallës së parë.


Në rastin konkret, për faktin se të pandehurit nuk i është shqiptuar një dënim obligativ sipas Kodit Penal, përgjegjësi mbajë si gjykata e shkallës së parë, ashtu edhe Prokurori i Shtetit, për mos ushtrim të ankesës në Gjykatën e Apelit.

Në anën tjetër, sa i përket afateve ligjore, Departamenti Special ka arritur që në masë të madhe të procedojë me kohë me lëndët që kanë qenë objekt shqyrtimi, duke marrë parasysh faktin se gjyqtarët e këtij departamenti kanë pasur një numër jo aq të madh të lëndëve në punë gjatë kësaj periudhe raportuese.

14. Departamenti Special i Gjykatës së Apelit

Krahas themelimit të Departamentit Special në nivel të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Ligji për Gjykatat, i miratuar në nëntor të vitit 2018, kishte paraparë themelimin e një departamenti të tillë edhe në shkallë të dytë, në Gjykatën e Apelit.

Departamenti i Gjykatës së Apelit, që nga funksionalizimi i tij e deri më 31 dhjetor 2019, kishte pranuar në punë 17 lëndë, prej të cilave shtatë (7) i kishte zgjidhur, ndërsa kishin mbetur të pazgjidhura 10.⁸⁹ Sa i përket këtij departamenti, IKD po ashtu ka kërkuar nga Gjykata e Apelit qasje në të dhënat mbi mënyrën e kryerjes së lëndëve, por se nuk ka marrë përgjigje.



Grafiku 16. Efikasiteti i Departamentit Special të Gjykatës së Apelit.

⁸⁹ Përgjigja për IKD-në e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit, Arbër Jashari. 22.04.2019.

Lidhur me punën e këtij departamenti, IKD ka zhvilluar një intervistë me udhëheqësin e këtij departamenti, Gjyqtarin Vaton Durguti. Ai ka thënë se gjyqtarët e këtij departamenti punën me lëndë e kanë filluar me lëndë të departamentit të krimeve të rënda, ndërsa pas gjysmës së shtatorit me lëndët për të cilat ata kanë kompetencë.”⁹⁰Durguti po ashtu ka thënë se ai i ka propozuar KGJK-së që të shtohet edhe numri i gjyqtarëve e po ashtu edhe i stafit mbështetës pasi për këta të fundit KGJK-ja nuk ka përmbushur akoma kërkesat e Rregullores nr.03/2019, për funksionalizimin e Departamentit Special.



“Mund të them se puna e këtij Departamenti që nga fillimi i funksionalizimit të tij e deri më sot, sa i përket lëndëve të pranuar deri më tani ishte e menaxhueshme dhe mund të vlerësohet me rezultat të mirë të punës. mendoj se me krijimin e këtij Departamenti do të duhej të arrihet që të zbatohet parimi i efikasitetit në procedurën penale dhe të mos kemi shumë lëndë të pazgjidhura dhe të trashiguara apo të bartura nëpër vitet vijuese kalendarike, kuptohet nëse gjatë punës në vijim do të paraqiten më shumë raste për shqyrtim e krahas kësaj të shtohet edhe numëri i gjyqtarve atëherë edhe suksesi nuk do të mungoj. Sa i përket sfidave kryesore të punës së gjyqtarëve kuptohet se ishte fillimi i funksionalizimit, për herë të parë të këtij Departamenti në sistemin tonë gjyqësor, po ashtu duhet të kemi parasysh se ky Departament , sipas Rregullores 03/2019 të datës 23 Prill 2019, në kuadër të strukturës-përbërjes së vet duhet të ketë edhe staf mbështetës të paraparë sipas nenit 15 të Rregullores në fjalë, dhe duke marrë parasysh se ende nuk është plotësuar me këtë staf,

Vaton Durguti, Udhëheqës i Departamentit Special të Gjykatës së Apelit

⁹⁰ Përgjigja për IKD-në, e udhëheqësit të Departamentit Special të Gjykatës së Apelit, Vaton Durguti. 24.04.2020.

15. Anex 1. Analizë e rasteve karakteristike të trajtuara nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë

1. Ish-ministri i MAPL-së dënohet me dy vjet burg për deklaratat e tij fyese për masakrën e Reçakut

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.20/19,

Vepra penale: “*Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik*”,

Gjykatësi: Musa Konxheli

Prokurori: Atdhe Dema

I pandehuri: Ivan Teodosijeviq

Gjykata Themelore në Prishtinë më 5 dhjetor 2019 e kishte dënuar me dy vjet burgim efektiv ish ish-ministrin e Administratës dhe Pushtetit Lokal (MAPL), Ivan Teodosijeviq, pasi ai ishte shpallur fajtor për deklaratat që i kishte bërë në lidhje me shqiptarët dhe masakrën e Reçakut.⁹¹

Ivan Teodosijeviq akuzohej nga PSRK-ja se më 24 mars 2019, në cilësinë e Ministrit të Administratës dhe Pushtetit Lokal, duke keqpërdorur pozitën apo autorizimin e tij, me dashje, ka nxituar dhe përhapur publikisht urrejtje, përçarja dhe mos durim midis grupeve kombëtare, racore dhe etnike që jetojnë në Republikës e Kosovës.

Në aktgjykimin e saj, gjykata e shkallës së parë kishte vlerësuar se deklaratimet e ish ministrit e tejkalonin lirinë e shprehjes që parashihet në nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe akteve të tjera të brendshme, ato si të tilla mund të nxisin urrejtje përçarje, mos tolerancë ndërmjet grupeve etnike në Kosovë, dhe kjo mbështetur edhe në praktikën gjyqësore ndërkombëtare dhe atë një prej rasteve të ngjashme A.S., kundër Bosnjës dhe Hercegovinës.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PSRK-ja më 23 maj 2019 kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve ndaj të pandehurit Ivan Teodosijeviq për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ka kryer veprën penale që i vihet në barrë.

Më 28 qershor 2019, PSRK-ja ka ngritur aktakuzë ndaj të akuzuarit Teodosijeviq, pas 37 ditëve nga fillimi i hetimeve në këtë rast, duke respektuar me përpikëri afatin e përcaktuar me ligj për kohëzgjatjen e hetimeve.

Gjykata Themelore në Prishtinë më 19 korrik 2019 ka mbajtur seancën fillestare ndaj të akuzuarit Teodosijeviq, apo 22 ditë pas dorëzimit të aktakuzës në gjykatë, duke vepruar konform nenit 262 paragrafi 4.

⁹¹ “*Ish-ministri i MAPL-së dënohet me dy vjet burg për deklaratat e tij fyese për masakrën e Reçakut*”. Betimi për Drejtësi. 5 Dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-ministri-i-mapl-se-denohet-me-dy-vjet-burg-per-deklaratat-e-tij-fyese-per-masakren-e-recakut/>). (Qasur së fundmi më 18 prill 2020).

Më 3 shtator 2019, gjykata kishte refuzuar si të pabazuara kërkesat e mbrojtjes për hedhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave.

Shqyrtimi kryesorë ndaj të akuzuarit Teodosijeviq kishte filluar më 2 dhjetor 2019, dhe po të njëjtën ditë kishte përfunduar edhe shqyrtimi gjyqësor ndaj tij.

Kohëzgjatja e shqyrtimit gjyqësor është në përputhje me nenin 314 të KPPK-së, i cili në paragrafin 1 pika 1.1 të tij ka përcaktuar afatin prej 120 ditëve brenda të cilit duhet të përfundojë shqyrtimi gjyqësor në rastet kur ai udhëhiqet nga trupi gjykues.⁹²

Nëse analizojmë kohëzgjatjen e këtij gjykimi që nga momenti i ngritjes së aktakuzës më 28 qershor 2019 e deri në shpalljen e aktgjykimit më 5 dhjetor 2019, del se gjykatës i janë nevojitur 161 ditë për t'i dhënë epilogun në shkallë të parë kësaj çështje penale.

⁹² Kodi nr. 04/L-123 i Procedurës Penale. Neni 314.1.1.1. “Nëse shqyrtimi gjyqësor mbahet para trupit gjykues, shqyrtimi gjyqësor duhet të përfundohet brenda njëqindnjëzet (120) ditësh, përveç nëse trupi gjykues nxjerr aktvendim të arsyetuar për vazhdimin e kohës për shqyrtim gjyqësor për shkak të ndonjëres prej arsyeve nga paragrafi 2. i këtij neni”.

2. Tre vjet burg për policin që pranoi se kishte transportuar drogë nga Shqipëria në Kosovë

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.43/19

Vepra penale: “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge”,

Gjykatësi: Arben Hoti

Prokurori: Atdhe Dema

Të pandehur: Bunjamir Jaha, Pajtim Hamiti

Gjykata Themelore në Prishtinë më 11 nëntor 2019 kishte shpallur fajtorë dy të akuzuarit për shitblerje me narkotikë, Bunjamir Jaha dhe Pajtim Hamiti. Ndaj, të akuzuarit Jaha kjo gjykatë kishte shqiptuar burg në kohëzgjatje prej tre viteve, ndërsa ndaj Hamitit burgim në kohëzgjatje prej tre vite e gjashtë muaj.⁹³ Në këtë rast përveç Jahës, akuzohen edhe Shpejtim, Flamur dhe Pajtim Hamiti, Bashkim Braha, Shkëlqim Ilazi, Shkumbin Berisha, Ardonit Mustafa dhe Arburim Ahmeti, për të cilët, edhe po vazhdon gjykimi për veprat që u ngarkohen, ndërsa për Jahën ishte veçuar procedura.

Ky vendim i nxjerrë në shkallë të parë, ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, më 18 shkurt 2020, por atë e ka ndryshuar vetëm sa i përket cilësimit juridik.

Sipas aktakuzës së ngritur nga PSRK-ja të akuzuarit Bunjamir Jaha, Shpejtim Hamiti, dhe të tjerët, se nga 16 maji e deri me 7 tetor 2018, në Ferizaj, Kaçanik dhe fshatrat të këtyre komunave kishin transportuar dhe shitur substanca narkotike të llojit kokainë dhe kanabis.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PSRK-ja më 16 maj 2018 kishte nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve ndaj Bunjamir Jaha, Pajtim Hamiti dhe të tjerëve, për shkak të veprave penale që ndërlidhen me narkotikë.

Më 30 maj 2019, kjo prokurori kishte ngritur aktakuzë ndaj Jahës dhe Hamitit për shkak të veprës penale që ndërlidhej me shitblerje me narkotikë.

Seanca fillestare ishte mbajtur më 6 nëntor 2019, apo kur kishin kaluar 161 ditë nga ngritja e aktit akuzues, duke shkelur obligimin ligjor që kjo seancë të mbahet brenda 30 dite nga dorëzimi i aktakuzës në gjykatë. Shpallja e aktgjykimit ndaj këtyre dy të akuzuarve është bërë më 11 nëntor 2019.

Ky gjykim për narkotikë ndaj tyre ka zgjatur plot 166 ditë, ndërsa procesi gjyqësor po vazhdon akoma ndaj Shpejtim Hamiti, Flamur dhe Pajtim Hamiti, si dhe Bashkim Braha dhe Shkëlqim Ilazi, për trafikim me narkotikë, shpëlarje parash dhe armëmbajtje pa leje.

⁹³ “Tre vjet burg për policin që pranoi se kishte transportuar drogë nga Shqipëria në Kosovë”. Betimi për Drejtësi. 11 nëntor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/tre-vjet-burg-per-policin-qe-pranoi-se-kishte-transportuar-droge-nga-shqiperia-ne-kosove/>). (Qasur së fundmi më 22 prill 2020).

3. Dënohen dy vëllezërit që pranuan se i ikën tatimit për mbi 500 mijë eurot e fituara përmes lojërave online në Arabinë Saudite

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.31/19

Vepra penale: “Shmangie nga tatimi”.

Gjykatësja: Valbona Selimaj

Prokurori: Atdhe Dema

Të pandehur: Fidan Sokoli, Liridon Sokoli

Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur fajtorë dy të akuzuarit për shmangie nga tatimi, Fidan dhe Liridon Sokoli.⁹⁴

Fidan Sokoli është dënuar me 3.500 euro gjobë, si dhe me 1 vit e 6 muaj burgim me kusht, me kusht që brenda dy vitesh të mos kryejë veprë tjetër. Ndërsa, i akuzuari Liridon Sokoli është dënuar me 1.000 euro dhe dënim me gjashtë muaj burgim me kusht, me kusht që brenda 1 viti të mos kryejë veprë tjetër penale.

Sipas aktakuzës së ngritur nga PSRK-ja, Fidan Sokoli akuzohet se nuk e kishte deklaruar shumën prej 531,735.99 euro e fituar përmes lojërave online në Arabinë Saudite dhe të ardhurat nga biznesi, duke bërë shmangie nga tatimi në vlerë 51,380.97 euro, ndërsa i akuzuari Liridon Sokoli, nuk e kishte deklaruar qarkullimin në shumën prej 29,660.51 euro, duke shmangur tatimin në vlerë 2,585.64 euro

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Drejtoria për hetimin e krimeve ekonomike dhe korrupsion më 28 gusht 2014 kishte dorëzuar kallëzim penal në PSRK, ndaj dy të pandehurve Sokoli, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se kishin kryer veprën penale shmangie nga tatimi.

Pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore, PSRK-ja më 2 shtator 2016 ka ngritur aktin akuzues ndaj dy të akuzuarve Sokoli, për shmangie tatimore.

Në shqyrtimin kryesor të mbajtur më 10 dhjetor 2019, dy të akuzuarit ishin deklaruar fajtor për veprën penale që u ngarkohej. Shpallja e aktgjykimit ndaj dy të akuzuarve Sokoli ishte bërë më 13 dhjetor 2019. Ky proces gjyqësor që nga ngritja e aktit akuzues e deri me shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë ka zgjatur 1198 ditë, apo më shumë se tre vjet e tre muaj.

⁹⁴ "Dënohen dy vëllezërit që pranuan se i ikën tatimit për mbi 500 mijë eurot e fituara përmes lojërave online në Arabinë Saudite". Betimi për Drejtësi. 13 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-dy-vellezerit-qe-pranuan-se-i-iken-tatimit-per-mbi-500-mije-eurot-e-fituara-permes-lojerave-online-ne-arabine-saudite/>). (Qasur së fundmi më 23 prill 2020).

4. Gjykimi për krime lufte në Pejë gjatë vitit 1999

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.15/19

Vepra penale: “Krime lufte”

Gjykatësi: Arben Hoti

Prokurore: Habibe Salih

I pandehuri: Zoran Djokic

Në Gjykatën Themelore në Prishtinë është duke vazhduar procesi gjyqësor ndaj të akuzuarit për krime lufte, Zoran Djokic.

Në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 11 korrik 2019, i akuzuari Djokic, ishte deklaruar i pafajshëm për veprën penale të krimeve të luftës.⁹⁵

Sipas aktakuzës së ngritur nga PSRK-ja, Zoran Djokic akuzohet se gjatë muajit mars – prill të vitit 1999, në lagjen “Kristal” të Pejës, ka shkaktuar vuajtje të mëdha apo cenim i integritetit trupor ose i shëndetit, aplikim i masave të frikësimit, ndaj popullatës së pambrojtur civile, vrasje, plaçkitja e një qyteti ose vendi, urdhërimi për zhvendosjen e popullsisë civile ose ndaj individëve të veçantë civilë që nuk marrin pjesë drejtpërdrejt në konflikt.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PSRK-ja më 8 tetor 2018 kishte nxjerrë aktvendim për fillimin e hetimeve ndaj të pandehurit Zoran Djokic për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ai kishte kryer veprën penale krimet e luftës.

Kjo prokurori, më 31 maj 2019, pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore kishte ngritur aktin akuzues ndaj Zoran Djokic, në drejtim të veprave penale të lartcekura.

Seanca fillestare ndaj të akuzuarit për krime lufte Djokic ishte mbajtur më 11 korrik 2019, ndërsa shqyrtimi i dytë ishte mbajtur më 14 gusht të vitit të kaluar.⁹⁶

Më 16 shtator 2019, gjykata kishte refuzuar kërkesat e ushtruara nga mbrojtja për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave.

Shqyrtimi gjyqësor ndaj Djokic kishte filluar më 4 dhjetor 2019 dhe aktualisht ky gjykim po vazhdon me administrimin e dëshmive të dëshmitarëve.

⁹⁵ “Deklarohet i pafajshëm i akuzuari për krime lufte gjatë vitit 1999 në Pejë”. Betimi për Drejtësi. 11 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-krime-lufte-gjate-vitit-1999-ne-peje/>). (Qasur së fundmi më 23 prill 2020).

⁹⁶ “Mbrojtja e të akuzuarit për krime lufte kërkon hudhjen e aktakuzës, PSRK thotë se ka prova”. Betimi për Drejtësi. 14 gusht 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mbrojtja-e-te-akuzuarit-per-krime-lufte-kerkon-hudhjen-e-aktakuzes-psrk-thote-se-ka-prova/>). (Qasur së fundmi më 23 prill 2020).

5. Gjykimi për krime lufte në Prishtinë

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.55/19

Vepra penale: “Krime lufte”

Gjykatësja: Albina Shabani-Rama

Prokurore: Drita Hajdari

I pandehuri: Nenad Arsiq

Në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë ka filluar gjykimi ndaj të akuzuarit për krime lufte ndaj popullatës civile shqiptare në vitin 1999, Nenad Arsiq.

Në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 24 dhjetor 2019, i akuzuari Arsiq kishte mohuar akuzat për krime lufte që i vihen atij në barrë.⁹⁷

Kjo aktakuzë për krime lufte ndaj të akuzuarit Arsiq është vërtetuar tashmë, pasi gjykata themelore kishte refuzuar kërkesat për hudsonje të aktakuzës, dhe edhe Apeli kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e të akuzuarit Arsiq ndaj këtij vendimi të themelores.⁹⁸

PSRK-ja e akuzon Nenad Arsiq, se më 21 maj 1999, në bashkëkryerje me personat e tjerë të forcave policore serbe, të pidentifikuar deri më tani, kishte marrë pjesë në aksionin kundër popullatës civile shqiptare, ku në familjen Shala në Prishtinë, anëtarët e saj i kishte rrahur dhe trajtuar në mënyrë çnjerëzore, si dhe kishte marrë pjesë në shkatërrimin masiv të pasurisë, e ku kishin përvetësuar naftë, vetura dhe 200 mijë marka gjermane të fshehura nga kjo familje.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Policia e Kosovës, Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës më 5 shtator 2019 ka dorëzuar në PSRK kallëzimin penal kundër të pandehurit Nenad Arsiq për veprën penale krime lufte.

PSRK-ja, pas shqyrtimit të kallëzimit penal, më 22 tetor 2019 ka nxjerr vendim për fillimin e hetimeve kundër të pandehurit Arsiq.

Aktakuza për krime lufte ndaj Nenad Arsiq është ngritur më 6 dhjetor 2019.

Seanca fillestare ndaj tij ishte mbajtur më 24 dhjetor të vitit 2019.

Në këtë çështje penale, gjykata nuk ka caktuar shqyrtimin e dytë, por palët vetëm janë njoftuar që brenda 30 dite të bëjnë kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhje të aktit akuzues.

⁹⁷ “Deklarohet i pafajshëm i akuzuari për krime lufte në Prishtinë gjatë vitit 1999”. Betimi për Drejtësi. 24 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-krime-lufte-ne-prishtine-gjate-vitit-1999/>). (Qasur së fundmi më 23 prill 2019).

⁹⁸ “Konfirmohet aktakuza ndaj të akuzuarit për krime lufte në Prishtinë gjatë vitit 1999”. Betimi për Drejtësi. 18 maj 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-aktakuza-ndaj-te-akuzuarit-per-krime-lufte-ne-prishtine-gjate-vitit-1999/>). (Qasur së fundmi më 10 qershor 2020).

6. Gjykimi ku babë e bir akuzohen për shpëlarje parash

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.13/19

Vepra penale: “Shpëlarja e parave”

Gjykatësja: Albina Shabani-Rama

Prokurore: Habibe Salih/Naim Abazi

Të pandehur: Shahadin dhe Sefer Hasani

Në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, që nga gushti i vitit të kaluar është duke u proceduar rasti për shpëlarje të parave ndaj të akuzuarve Shahadin dhe Sefer Hasani.

Dy të akuzuarit Hasani, në seancë fillestare ishin deklaruar të pafajshëm për këtë veprë penale.⁹⁹

Sipas aktakuzës së ngritur nga PSRK, ata po akuzohen se me paratë që i kishin fituar me aktivitet kriminal, i cili ishte ndërlidhur me vepra penale të narkotikut, kishin blerë dy banesa, një në Prizren, në vlerë 59,600.00 euro dhe tjetrën në Prishtinë, në vlerë 44,070.00 euro.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Policia e Kosovës, Drejtoria për Hetimin e Krimin të Organizuar në PSRK kishte dorëzuar përmbledhje të hetimeve financiare ndaj të pandehurve Hasani, në drejtim të veprës penale shpëlarja e parave.

PSRK-ja, më 18 dhjetor 2017 kishte filluar ndërmarrjen e veprimeve hetimore ndaj dy të pandehurve për veprën penale të lartcekur.

Pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore, kjo prokurori më 3 maj 2019 kishte ngritur aktakuzë ndaj Shahadin dhe Sefer Hasani, për shpëlarje të parave.

Seanca fillestare ndaj tyre ishte mbajtur më 29 gusht 2019, apo 119 ditë pas dorëzimit të aktakuzës në gjykatë, duke vepruar në kundërshtim me nenin 242.4 të KPPK-së.

Shqyrtimi i dytë në këtë rast nuk ishte caktuar, por palët ishin njoftuar për mundësinë që në afatin prej 30 ditësh të paraqesin kërkesat për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave.

Shqyrtimi gjyqësor ndaj të akuzuarve për shpëlarje parash ka filluar më 26 nëntor 2019, dhe po vazhdohet me administrimin e provave.

⁹⁹ “Babë e bir s’e pranojnë fajësinë se me paratë e shitjes së narkotikëve kishin blerë banesa”. Betimi për Drejtësi. 29 gusht 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/babe-e-bir-se-pranojne-fajesine-se-me-parate-e-shitjes-se-narkotikeve-kishin-blere-banesa/>). (Qasur së fundmi më 23 prill 2020).

7. Gjykimi për fajde e krim të organizuar ndaj kryetarit të “Dardanëve” dhe të tjerëve

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.14/19

Vepra penale: “Krim i organizuar”, “fajde”, “detyrim”, “organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm”.

Gjykatësja: Albina Shabani-Rama

Prokurori: Naim Abazi

Të pandehur: Dalip Brahimi, Ismet Salihu, Bujar Gërbeshi, Rrahim Brahimi, Lulzim Berisha, Alban Geci

Në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë që nga qershori i vitit 2019 ka filluar të shqyrtohet akuza ndaj kryetarit të grupit të tifozëve “Dardanët”, Lulzim Berisha, Dalip Brahim, Ismet Salihut, Bujar Gërbeshit, Rrahim Brahim dhe Alban Geci.

Sipas aktakuzës së ngritur nga PSRK-ja, Lulzim Berisha akuzohet për fajde, Geci, akuzohet për organizim të skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm, të akuzuarit Dalip Brahimi, Ismet Salihu, Bujar Gërbeshi dhe Rrahim Brahimi ngarkohen për veprat penale “krim i organizuar”, “fajde”, “detyrim”, “organizimi i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar më 22 qershor 2017 ka dorëzuar në PSRK kallëzimin penal kundër të pandehurve të lartcekur.

Pas analizimit të kallëzimit penal, më 23 qershor 2017 kjo prokurori ka nxjerrë aktvendim për fillim të hetimit ndaj këtyre të pandehurve. Më 21 gusht 2017, kjo prokurori ka zgjeruar hetimet edhe kundër dy të pandehurve, Bujar Gërbeshi dhe Alban Geci.

Pas veprimeve hetimore, PSRK-ja më 8 maj 2019 ka ngritur aktakuzë ndaj të akuzuarve si më lartë për krim të organizuar, fajde, detyrim e bixhoz të paligjshëm.

Seanca fillestare në këtë rast ishte mbajtur më 12 korrik 2019, duke mos respektuar afatin prej 30 ditësh të përcaktuar me nenin 242.4 të KPPK-së, dhe në atë shqyrtim të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm. Paraprakisht, kjo gjykatë kishte refuzuar marrëveshjen për pranimit fajesie që të akuzuarit Lulzim Berisha dhe Alban Geci kishin lidhur me PSRK-në.¹⁰⁰

Shqyrtimi i dytë në këtë rast nuk ishte mbajtur, por palët ishin njoftuar për mundësinë që brenda një afati prej 30 ditësh të paraqisnin kërkesat për hedhje të aktakuzës.

¹⁰⁰ “Kryetarit të “Dardanëve” dhe të akuzuarit tjetër u refuzohet marrëveshja për pranimit fajesie, të tjerët deklarohen të pafajshëm”. Betimi për Drejtësi. 12 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryetarit-te-dardaneve-dhe-te-akuzuarit-tjeter-u-refuzohet-marreveshja-per-pranim-fajesie-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem/>). (Qasur së fundmi më 23 prill 2020).

Më 23 dhjetor 2019, gjykata kishte filluar me shqyrtimin gjyqësor ndaj këtyre të akuzuarve, duke refuzuar kërkesat e ushtruara nga mbrojtja për hedhje të aktakuzës.

Ndërsa, në seancën dëgjimore të 9 marsit 2020, gjykata kishte aprovuar marrëveshjen për pranim fajësie të lidhur mes PSRK-së dhe të akuzuarve Alban Geci e Ismet Salihu.¹⁰¹

Si rrjedhojë e kësaj marrëveshje, dy të akuzuarit Geci e Salihu ishin dënuar me nga gjashtë muaj burgim.¹⁰²

Si rrjedhojë, për të akuzuarin Geci ka përfunduar gjykimi, ndërsa Salihu dhe të akuzuarit e tjerë, vazhdojnë gjykimin për veprat që u ngarkohen.

¹⁰¹ “Aprovohet marrëveshja për pranim fajësie në rastin e dy të akuzuarve për organizim të bixhozit të paligjshëm”. Betimi për Drejtësi. 9 mars 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aprovohet-marreveshja-per-pranim-fajesie-ne-rastin-e-dy-te-akuzuarve-per-organizim-te-bixhozit-te-paligjshem/>). (Qasur së fundmi më 23 prill 2020).

¹⁰² “Njëri i akuzuar për bixhoz të paligjshëm dënohet me burg, e tjetrit burgu i zëvendësohet me gjobë”. Betimi për Drejtësi. 11 mars 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/njери-i-akuzuar-per-bixhoz-te-paligjshem-denohet-me-burg-e-tjetrit-burgu-i-zevendesohet-me-gjobe/>). (Qasur së fundmi më 23 prill 2020).

16. Trajtimi i rasteve të terrorizmit nga Republika e Kosovës

Që nga funksionalizimi i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë të gjitha rastet e terrorizmit po trajtohen vetëm në kuadër të këtij departamenti, për dallim nga praktika gjyqësore e kaluar, ku para themelimit të këtij departamenti, rastet e terrorizmit janë gjykuar në Departamentin për Krime të Rënda.

Shprehjet e tilla si “terrorizëm, veprim terrorist apo vepër terroriste”, sipas KRPRK-së nënkuptojnë “*kryerjen e një ose më shumë veprave penale të mëposhtme me qëllim të frikësimit serioz të popullsisë, të detyrimit të padrejtë të një organi publik, qeverisë apo organizatës ndërkombëtare për të kryer ose për të mos kryer ndonjë veprim, apo që seriozisht të destabilizojë ose të shkatërrojë strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike apo shoqërore të Republikës së Kosovës, të një shteti tjetër apo të një organizate ndërkombëtare*”.¹⁰³

Terrorizmi, si veprim kriminal, përbën një ndër dukuritë më aktuale në shoqërinë bashkëkohore përmes të cilës atakohen vlerat më jetike të shoqërisë sonë, siç janë jeta e njeriut, shëndeti, pasuria siguria e njeriut etj. Pra, autorët e akteve terroriste synojnë që nëpërmjet një veprimi të caktuar të mbjellin frikë apo terror tek popullata e pafajshme, duke mbjellë ndjenjën e pasigurisë, në mënyrë që në opinionin e gjerë të transmetohet një mesazh apo kauzë e caktuar, qoftë ajo politike, fetare apo ekonomike. Pra, nëpërmjet frikës dhe panikut, terroristët dëshirojnë dobësimin dhe diskreditimin e qeverive, duke i paraqitur ato si të paafta në mbrojtjen e jetës së qytetarëve të tyre, dhe që të shkaktohet destabilizimi i një shteti të caktuar. Pra terrorizmi ndërthet në vete idenë që dhuna të përdoret si mjet për të ndikuar tek politika.

Pamjet nga sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001 në SHBA, të pasqyruara nga mediat anembanë globit, tronditën thellë të gjithë botën dhe shpërfaqën mizorinë, rrezikun dhe kërcënimin ekzistencial që paraqet në vete terrorizmi për sigurinë e çdo shteti, duke tejkaluar përmasat kombëtare, për t’u shndërruar në një rrezik global, për të konkluduar se asnjë shtet në botë nuk është imun ndaj këtij kërcënimi real.

Siguria globale, viteve të fundit është rrezikuar seriozisht nga organizata terroriste e ashtuquajtur “ISIS”, e cila paraqet shembullin më të sofistikuar të një organizate kriminale e cila ka tentuar të ndërtojë mekanizma të funksionimit si etnitet shtetëror, duke shpallur edhe themelimin e shtetit të tyre islamik. Kjo organizatë terroriste, duke plasuar në media filmime të veprimeve të tyre ç’njerëzore, dhe duke përdorur kapitalin financiar që ajo e dispononte nga aktivitetet kriminale dhe eksportimit të naftës nga zonat e kontrollit në Siri e Irak, arriti të mbledh pas vetes mbështetës të shumtë, nga vende të ndryshme të botës.

Fatkeqësisht, këtij tundimi për tu bërë pjesë e organizatës terroriste “ISIS” nuk i shpëtuan as qindra kosovarë, të cilët u rekrutuan duke keqpërdorur doktrinën fetare, kinse shkuarja në Siri ishte një obligim moral për çdo mysliman “të ndërgjegjshëm”, pra që edhe kosovarët të kontribuonin në kauzën e luftës së shenjtë apo “xihadit”, siç propagandohej nga qarqet e lidhur

¹⁰³ Kodi Nr. 06/L-074 Penal i Republikës së Kosovës. Neni 128.1.

me ISIS. Studime të publikuara e kanë renditur Kosovën në mesin e shteteve që ka dhënë numrin më të madh të luftëtarëve të huaj për organizatën ISIS për kokë banori në Evropë.

Departamenti Amerikan i Shtetit në nëntor të vitit 2019 ka publikuar raportin vjetor për terrorizmin në botë për vitin 2018, dhe një pjesë e veçantë e këtij raporti i është kushtuar edhe Kosovës. Ky raport thekson se Kosova ka vazhduar të luftojë kërcënimin që vjen nga terrorizmi, nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë vitit 2018. Ky raport nënvizon se më shumë se 400 burra, gra dhe fëmijë kosovarë kanë udhëtuar në Siri dhe Irak për t’iu bashkuar grupeve terroriste, prej të cilëve, afro 70 tani janë të vdekur. Rreth 130 persona janë kthyer në Kosovë, ndërsa rreth 200 të tjerë janë në zonën e konfliktit.¹⁰⁴

Numri i kosovarëve që kishin udhëtuar në Siri dhe Irak	Numri i personave që kishin mbetur në zonat e konfliktit	Numri i personave që ishin kthyer	Numri i personave të vdekur
Mbi 400 persona	Rreth 200	Rreth 130	Rreth 70

Tabela 4. Statistikat e kosovarëve në zonat e konfliktit sipas Departamentit Amerikan të Shtetit.

Ky raport përmend faktin se në Kosovë, në vitin 2018, gjykimet dhe hetimet kanë vazhduar për 29 të dyshuar dhe nëntë (9) raste. Aty theksohet edhe se imamët e Kosovës, të arrestuar më parë nën akuza të lidhura me terrorizëm, u liruan.

Sipas raportit të DASH, autoritetet e Kosovës gjatë vitit 2018 kanë arrestuar gjashtë (6) individë të tjerë nën akuza të lidhura me terrorizmin dhe gjykatat lëshuan 20 aktgjykime dënuese për vepra penale të lidhura me terrorizmin.

Në raport përmendet se më 17 korrik, Gjykata Themelore e Prishtinës dënoi shtatë (7) të pandehur dhe liroi një (1) person nën akuzat për terrorizëm dhe armë në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në konfliktin sirian si anëtarë të ISIS-it dhe liroi një person. Të dënuarit morën dënime me burg prej 28 muaj deri në katër (4) vjet.

Po ashtu, sipas raportit të DASH, më 18 maj Gjykata Themelore e Prishtinës kishte dënuar tetë (8) të pandehur për planifikim të një sulmi në Shqipëri kundër ekipit kombëtar të futbollit të Izraelit dhe caqeve të ndryshme në Kosovë në nëntor të vitit 2016. Dënimet silleshin prej 18 muaj deri në 10 vjet.

Në raport theksohen si pozitive aktivitetet e ndërmarra nga Ministria e Drejtësisë e Kosovës, e cila ka vazhduar të zbatojë një program korrigjues me synimin që të forcojë menaxhimin e të

¹⁰⁴ Departamenti Amerikan i Shtetit. “Raportet e Shtetit mbi terrorizmin për vitin 2018- KOSOVË”. 1 nëntor 2019. (Shih linkun https://xk.usembassy.gov/wp-content/uploads/sites/133/CRT_2018_Alb.pdf). (Qasur së fundmi më 25 prill 2020).

dënuarve për terrorizëm e të cilët vuajnë dënimin në burgje, në krijimin e kornizave për rehabilitim dhe ri integrim eventual të terroristëve të dënuar.

Sipas këtij raporti, më 23 maj, Ministria e Punëve të Brendshme kishte njoftuar për krijimin e një Sektori për Parandalim dhe Riintegrim, i cili kishte për qëllim re integrimin e personave që kishin qenë të dënuar për vepra terroriste dhe që kishin vuajtur dënimin për këto vepra, pastaj të kthyerit FTF (luftëtarë terroristë të huaj) dhe anëtarët e familjeve.

Në një raport të publikuar nga Këshilli për Bashkëpunim Rajonal që merret me bashkëpunimin e vendeve të Evropës Lindore që synojnë të anëtarësohet në Bashkimin Evropian, rezulton se për periudhën 2015-2017, totali i vuajtjes së dënimit për kosovarët që kanë marrë pjesë në këto luftëra është 187 vjet, pastaj renditet Shqipëria me gjithsej 126 vjet burgim të shqiptuara, Bosnja dhe Hercegovina me 40 vjet burgim dhe Maqedonia 33 vjet burgim.¹⁰⁵

Nga gjetjet e këtij raporti thuhet se nga viti 2012 deri në vitin 2017, nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, drejtë Sirisë e Irakut, kanë udhëtuar mbi 1000 persona. Ndërsa, viti 2015 ka shënuar ngadalësimin e numrit të qytetarëve që kanë shkuar në zonat e konfliktit në Siri dhe Irak, nga rajoni i Ballkanit Perëndimor.

Kosova, duke parë rrezikun në rritje nga trendët e ekstremizmit të dhunshëm dhe për të parandaluar rekrutimet e mundshme për luftëtarë të ISIS, viteve të fundit ka ndërmarrë angazhime shtesë në luftën kundër terrorizmit, siç ishte vendimi i nxjerrë nga Ministria e Punëve të Brendshme për të ndaluar përfundimisht aktivitetin e disa organizatave joqeveritare, të cilat ishin të veshura me petkun e organizatave humanitare, por që kishin burime të financimit të dyshimtë dhe propagandonin në mbështetje të grupeve terroriste.

Republika e Kosovës, për të dëshmuar angazhimin e saj karshi aleatëve në aleancën botërore kundër terrorizmit dhe për të mbrojtur sigurinë e saj nacionale nga veprimet e tilla, ndërmori një sërë nismash legjislative. Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 12 mars 2015, ka miratuar Ligji nr.05/L-002 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit, ku qëllimi i këtij ligji është mbrojtja e interesit shtetëror dhe sigurisë kombëtare. Në nenin 3 të këtij ligji është inkrimuar si vepër penale “Bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme parashtarake ose para policore, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës”, si dhe është sanksionuar përgjegjësia penale e çdo personi i cili merr pjesë apo organizon, rekruton, financon, nxit, udhëheqë apo trajnon personat ose grupe të personave me qëllim të bashkimit apo pjesëmarrjes në ushtrinë ose policinë e huaj. Ky ligj ka përcaktuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj deri në deri në 15 vite, ndaj atyre që marrin pjesë, nxisin, ndihmojnë përfshirjen në konflikte të armatosura jashtë vendit.

¹⁰⁵ “Kosova, kampion në Ballkan për dënimin e luftëtarëve të ISIS-it”. 10 janar 2018. (Shih linkun <https://www.koha.net/kronike/68360/kosova-kampion-ne-ballkan-per-denimin-e-luftetareve-te-isis-it/>). (Qasur së fundmi më 25 prill 2020).

Republika e Kosovës, krahas miratimit të ligjit që ndalonte pjesëmarrjen në konflikte të armatosura jashtë vendit, në legjislacionin e saj penale ka përcaktuar një sërë veprash me natyrë terroriste. Veprat penale që ndërlidhen me terrorizmin janë përfshirë në Kapitullin XIV të Kodit Penal të Republikës së Kosovës dhe përfshijnë: “kryerja e veprave terroriste”, ku kryesit e kësaj vepre penale dënohet me jo më pak se pesë (5) vjet burgim e deri me burgim të përjetshëm, “ndihma në kryerjen e terrorizmit”, e cila dënohet prej 6 muaj e deri në 10 vite burgim, “lehtësimi në kryerjen e terrorizmit”, kryesi i kësaj vepre penale dënohet nga 5 e deri me 15 vite burgim, “rekrutimi për terrorizëm”, 5 deri në 15 vite, “trajnimi për terrorizëm”, 5 deri në 15 vite burgim, “shtytja për kryerjen e veprave terroriste”, kryesi i kësaj vepre penale dënohet prej 1 e deri me 5 vite burgim, “fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste”, vepër e dënueshme prej 3 e deri ne 10 vite, “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”, vepër e dënueshme me gjobë deri në 500.000 euro dhe me burgim prej 10 deri në 20 vjet, “përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”, vepër e dënueshme prej 1 e deri në 20 vite, “nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik”, kryesi i kësaj vepre dënohet me gjobë ose me burgim prej 1 deri në 10 vite.

Në vitin 2016, Kosova e zgjeroi kornizën e saj legjislative për të luftuar aktivitetet terroriste. Kështu, në maj të vitit 2016, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit, duke zëvendësuar ligjin përkatës të vitit 2013. Në nëntor 2016, Banka Qendrore e Kosovës miratoi Rregulloren e saj për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit

Republika e Kosovës, me qëllim të parandalimit dhe luftimit me sukses të kësaj dukurie, ka miratuar një sërë dokumentesh strategjike, duke përcaktuar mekanizmat, metodat dhe mënyrën me qëllim të implementimit të një politikë efektive kundër terrorizmit.

Në funksion të realizimit të një qëllimi të tilla ka qenë edhe miratimi i Strategjisë Shtetërore kundër Terrorizmit dhe Plani i Veprimit 2018-2022, i cili është dokumenti i tretë strategjik i hartuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të parandalimit dhe luftimit të veprave terroriste.

Si objektiva strategjike të cilat janë synuar të arrihen përmes miratimit të këtij dokumenti janë cilësuar kundërshtimi dhe luftimi i ideologjive ekstremiste apo radikale, të çfarëdo natyre qofshin ato, të cilat mund të shpijnë në përdorimin e dhunës dhe që bien ndesh me normat dhe parimet demokratike të shoqërisë kosovare.

Kjo strategji ka synuar edhe që të parandalojë aktivitetet terroriste, të zvogëlojë rrezikun nga kërcënimet terroriste, si dhe uljen e cenueshmërisë përmes qasjes gjithëpërfshirëse, jo vetëm ndër institucionale, por gjithë shoqërore, e cila do të krijoj një bazë fleksibile për reagim më efikas ndaj kërcënimeve ekzistuese dhe dinamikave tjera gjithnjë në rritje dhe shumë dimensionale.

Prilli i vitit 2019 ka shënuar një hap pozitiv drejt rikthimit të kosovarëve nga zonat e luftës në Siri e Irak. Policia e Kosovës kishte njoftuar se në mesin e të kthyerve ishin katër luftëtarë, 32

gra dhe 74 fëmijë, përfshirë 9 fëmijë që kanë humbur prindërit në luftë. Kthimi i tyre ka qenë i mundur në sajë të një operacioni të suksesshëm të kryer nga shteti i Kosovës në bashkëpunim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe Forcat Demokratike Siriane.

Për këtë operacion të suksesshëm, Ambasada Amerikane në Kosovë kishte lëshuar një komunikatë, ku thuhet se “SHBA e përgëzoi Kosovën për kthimin e 110 shtetasve të saj nga Siria. Sipas kësaj komunikate, me këtë riadhesim, Kosova po vendoste një standard të rëndësishëm për të gjithë anëtarët e Koalicionit Global për të mposhtur ISIS-in dhe bashkësinë ndërkombëtare në ndjekjen e së njëjtës rrugë. I duartrokasim bashkë ndjenjës së treguar për të pranuar kthimin të këtij numri të madh të civilëve”.¹⁰⁶

Në prill 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, 32 të dyshuarave ua kishte caktuar masën e arrestit shtëpiak për shkak të dyshimit se të njëjtat kanë kryer veprën penale “Bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para policore, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës”, dhe veprën penale “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”. Sipas PSRK-së ekziston dyshimi se 18 të pandehurat që nga viti 2014 e deri me 20 prill 2019, kishin qenë në zonën e konfliktit Siri-Irak.

Ndërsa, në korrik 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte vendosur që ndaj 24 grave të kthyera nga Siria të vazhdohet masa e arrestit shtëpiak edhe për dy muaj të tjerë, ndaj katër (4) prej tyre u është zëvendësuar kjo masë, me paraqitje në stacion policor, ndërsa katër (4) gra të tjera janë liruar nga masa e arrestit shtëpiak, pasi ndaj tyre nuk kishte pasur kërkesë për vazhdimin e masës nga PSRK. Ndryshe, sipas të dhënave zyrtare nga Policia e Kosovës, edhe më tej në zonat e konfliktit, janë 30 luftëtarë, 49 gra dhe tetë fëmijë.

Në raportin vjetor të Prokurorit të Shtetit për vitin 2019, theksohet se Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2019 i ka kushtuar rëndësi mjaft të madhe zgjidhjes së rasteve që kanë të bëjnë me disa vepra penale specifike, në të cilat bën pjesë edhe terrorizmi.

Sipas këtij raporti, Prokurori i Shtetit gjatë vitit 2019, nga regjistri i lëndëve PPS ka pranuar 16 raste me 25 persona, si dhe 8 raste në regjistrin PPN. Në raport thuhet se gjatë kësaj periudhe nga PPS janë zgjidhur 26 raste me 37 persona.

Sipas raportit, Prokurori i Shtetit ka ngritur aktakuzë pas hetimeve në 22 raste ndaj 26 personave, në dy raste ndaj dy personave ka hedhur kallëzimin penal, dhe në 6 raste ndaj 9 personave ka PSH ka pushuar hetimet.¹⁰⁷

¹⁰⁶ "Deklaratë nga Ambasada e SHBA-ve në Prishtinë". Ambasada e SHBA-së në Kosovë. (Shih linkun <https://xk.usembassy.gov/sq/deklarate-nga-ambasada-e-shba-ve-ne-prishtine-7/>). (Qasur për herë të fundit më 25 prill 2020).

¹⁰⁷ "Raporti vjetor i punës së Prokurorit të Shtetit për vitin 2019". Prokurori i Shtetit. fq.20. (Shih linkun <file:///C:/Users/hp/Downloads/Raporti%20i%20pun%C3%ABs%20p%C3%ABr%20vitin%202019%20-%20Final%20-%20SHQIP.pdf>). (Qasur së fundi më 25 prill 2020).

Aktakuzë pas hetimeve		Hedhje e kallëzimit penal		Pushim i hetimeve	
Raste	Persona	Raste	Persona	Raste	Persona
22	26	2	2	6	9

Tabela 5. Hetimi dhe ndjekja e kryesve të veprave të terrorizmit nga prokuroria gjatë vitit 2019.

16.1. Gjetjet kryesore të IKD-së në trajtimin e rasteve të terrorizmit në Departamentin Special


IKD, që nga themelimi i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë e deri në mars të vitit 2020, ka monitoruar gjithsej 25 raste të terrorizmit, prej të cilave 28 persona janë të akuzuar, nga të cilët gjashtë (6) persona i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 22 persona të tjerë i takojnë gjinisë femërore.

Numri i rasteve	Numri i personave	Meshkuj të akuzuar	Gra të akuzuara
25	28	6	22

Tabela 6. Rastet e terrorizmit të monitoruara nga 1 korriku 2019 – 1 mars 2020 në Departamentin Special.

Nga këto 25 raste të monitoruara, procedura penale në shkallë të parë ka përfunduar ndaj 25 personave, ndërsa ndaj tre (3) personave të tjerë, të akuzuar për vepra të terrorizmit, procesi gjyqësor është në vazhdim e sipër.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë ka shqiptuar aktgjykime dënuese ndaj 25 personave, ndaj të cilëve janë shqiptuar gjithsej 26 dënime. Ndërsa DS i GjTh në Prishtinë nuk ka shqiptuar asnjë aktgjykim lirues apo refuzues. Prej këtyre 25 aktgjykimeve dënuese, pesë (5) persona janë dënuar me burgim efektiv, 20 persona janë dënuar me kusht dhe ndaj një (1) personi krahas dënimit me burg, është shqiptuar edhe dënimi me gjobë.



Grafiku 13. Dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve për terrorizëm në DS nga 1 korriku 2019-1 mars 2020.

Nga pesë (5) personat e dënuar me burgim, Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë njërin e ka dënuar me pesë (5) vite e gjashtë muaj burgim, njërin e ka dënuar me katër (4) vite burgim, një me tre (3) vite e tetë muaj burgim, një tjetër me 20 muaj burg dhe një person e ka dënuar me gjashtë (6) muaj burgim.

Nga 20 personat ndaj të cilëve gjykata ka shqiptuar dënim me kusht, 19 prej tyre janë dënuar me burgim në kohëzgjatje prej dy vitesh, ndërsa një person është dënuar me tri vite burg me kusht.

Ndërsa, njëri i akuzuar është dënuar si i përfshirë në një rast të terrorizmit, dhe ndaj tij është shqiptuar edhe dënimi me gjobë në lartësi prej 500 euro, por ky dënim nuk është shqiptuar si dënim kryesor, por si dënim kumulativ, krahas atij me burgim. Pra, gjoba i është shqiptuar për veprën penale “keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës”.

Personat të cilat janë akuzuar nga Prokuroria Speciale për vepra që ndërlidhen me terrorizmin i takojnë grupit të kosovarëve, të cilët në prill të vitit 2019, ishin kthyer në Kosovë nga vatrat e luftës në Siri dhe Irak.

Bledart Elshani ishte dënuar me 20 muaj burgim për shtytje në kryerjen e veprave terroriste dhe për armëmbajtje pa leje. Për shtytje në kryerjen e veprave terroriste, ai është dënuar me 18 muaj burg, derisa për armëmbajtje pa leje është dënuar me katër muaj burg, kurse më pas ndaj tij është shqiptuar dënimi unik në kohëzgjatje prej 20 muajsh burgim. I akuzuari Elshani, fillimisht kishte mohuar fajësinë në seancë fillestare për këto dy vepra, por që më vonë, në seancën e shqyrtimit kryesor, ai ishte deklaruar fajtor. Gjykata e Apelit ia ka vërtetuar dënimin me burg të akuzuarit Bledar Elshani, për veprën penale “shtytje në kryerjen e veprave terroriste”, ndërsa për “armëmbajtje pa leje” e ka ndryshuar vendimin e nxjerrë në shkallë të parë, duke i shqiptuar atij gjobë në lartësi prej 400 euro.

Gjykata Themelore në Prishtinë kishte dënuar Berat Qamilin me gjashtë (6) muaj burgim efektiv për veprën penale “bashkimi ose pjesëmarrja në ushtrinë apo policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake apo para policore, në organizimet grupore ose individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës”. Ky dënim ishte vërtetuar edhe në shkallë të dytë nga Gjykata e Apelit. I akuzuari Qamili në seancë fillestare ishte deklaruar fajtor për veprimet që i ngarkohen sipas akuzës.

Agon Misini ishte dënuar me katër (4) vite burgim efektiv nga Gjykata Themelore në Prishtinë, për pjesëmarrje në grupe terroriste. Një dënim i tillë i ishte shqiptuar të akuzuarit Misini pasi që ai paraprakisht kishte pranuar fajësinë në seancë fillestare. Ky vendim i shpallur nga gjykata themelore ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, por kjo gjykatë vendimin e shkallës së parë e ka ndryshuar vetëm sa i përket cilësimit juridik, bazuar në Kodin Penal që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.

Fitim Lladrovci ishte deklaruar i pafajshëm për veprën penale “shtytja për kryerjen e veprave terroriste”. Një deklaram të tillë ai e kishte bërë në shqyrtim fillestar.

Visar Qukovci ishte dënuar me 5 vite e gjashtë muaj burgim dhe 500 euro gjobë, për veprat penale “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist” dhe keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës. Mirëpo, Gjykata e Apelit, i’ a ka rritur dënimin me burg të akuzuarit Qukovci, ashtu që për veprat penale “organizim dhe pjesëmarrja në grup terrorist”, dhe “keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës”, t’i shqiptohet dënimi unik prej shtatë vite e gjashtë muaj burgim.

Gjykata Themelore në Prishtinë e kishte dënuar me tre (3) vjet e tetë muaj burgim, të akuzuarin për organizim dhe pjesëmarrje në grup terrorist, Arijan Krujezi. Ky dënim i ishte shqiptuar të akuzuarit Krujezi, pasi që ai kishte pranuar fajësinë për këtë vepër penale. Pasi lënda kishte shkuar në Gjykatën e Apelit, kjo gjykatë kishte marrë vendim që të ndryshonte vendimin e nxjerrë në shkallë të parë, ashtu që të akuzuarit Arijan Krujezi ia rriti dënimin në gjithsej katër vite e gjashtë muaj burg.

	I akuzuari	Vepra Penale	Dënimi/ Procesi
1.	Bledart Elshani	“shtytja për kryerjen e veprave terroriste”, “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”	20 muaj burgim
2.	Berat Qamili	“bashkimi ose pjesëmarrja në ushtrinë apo policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake apo para policore, në organizimet grupore ose individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës”	6 muaj burgim efektiv
3.	Agon Misini	“organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”	4 vite burgim
4.	Fitim Lladrovci	“shtytja për kryerjen e veprave terroriste”	Në proces
5.	Visar Qukovci	“organizim dhe pjesëmarrja në grup terrorist”, “keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës”	5 vite e gjashtë muaj burgim dhe 500 euro gjobë
6	Arijan Krujezi	“Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”	3 vite e tetë muaj burgim

Tabela 7. Personat e gjinisë mashkullore të gjykuar për vepra terroriste nga 1 korriku 2019 – 1 mars 2020 në Departamentin Special.

IKD vlerëson se krahas dënimit me burgim, këta persona të dënuar duhet t’i nënshtrohen një programi të veçantë të rehabilitimit brenda institucioneve korrektuese, ku do të vuajnë dënimin me heqje lirie, me qëllim që pas vuajtjes së dënimit, të arrihet rehabilitimi i tyre i plotë, dhe re-integrimi në shoqëri si pjesëtarë të dobishëm.

Në anën tjetër, në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjatë pjesës së dytë të vitit 2019 dhe deri në muajin mars të vitit 2020, janë trajtuar edhe rastet e 22 grave të akuzuara, që me apo pa vullnetin e tyre, ishin bërë pjesë e konfliktit që po zhvillohej në zonat e armatosura të Sirisë dhe Irakut.

Nga gjithsej 22 gra të akuzuara për vepra terroriste në Departamentin Special, vetëm dy (2) prej tyre ishin deklaruar të pafajshme, ndërsa 20 të tjera kishin pranuar fajësinë për vepra që lidhen me terrorizmin.

Prej këtyre 20 grave që ishin deklaruar fajtoresh për vepra terroriste, 19 prej tyre akuzoheshin nga PSRK-ja për veprën penale “organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste”, dhe vetëm një prej tyre akuzohej për veprën penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e

huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para policore, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës”.

Në raste të caktuara, të akuzuarat kanë deklaruar se ato nuk kanë qenë të vetëdijshme se veprimet e tyre kualifikoheshin si vepër penale sipas legjislacionit tonë penal. Vlen të përmendët se shumica nga to kanë pasur gjendje të renduar ekonomike, duke u përfshirë në skemën e ndihmave sociale, se kanë qenë nëna vetushqyese, duke bartur mbi supet e tyre barrën e familjes pas kthimit në vendlindje. Me qëllim të realizimit të një mbrojtje sa më efektive, gjykata atyre u ka caktuar mbrojtës sipas detyrës zyrtare.

Këto të akuzuara, kanë pasur një qëndrim korrekt në sallën e gjykimit. Pothuajse të gjitha të akuzuarat tyre janë shprehur të penduara për veprimet e tyre, disa prej tyre kanë deklaruar se ishin mashtruar, disa të tjera kanë thënë se kishin shoqëruar bashkëshortët e tyre pa pasur qëllim përfshirjen në konfliktin e armatosur, dhe në fund, ato edhe kanë shprehur falënderimin e tyre që shteti i Kosovës kishte arritur ti riatdhesonte.

Ndaj 19 grave të akuzuara për pjesëmarrje në grupe terroriste, gjyqtarët e DS kanë shqiptuar dënim me kusht në kohëzgjatje prej dy vitesh. Ky dënim me kusht i shqiptuar ndaj tyre nuk do të ekzekutohet nëse ato nuk kryenin vepra tjera penale brenda afatit prej tre viteve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimeve të shpallura ndaj secilës prej tyre

Gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit me kusht ndaj grave të akuzuara për terrorizëm ka marrë për bazë disa rrethana, të tilla si pranimin e fajit, pendimin e tyre të thellë për shkuarjen në Siri-Irak, pjesëmarrja dhe rolin e tyre, ku gjykata ka vlerësuar se roli i tyre nuk ka qenë kyç, por se në shumicën e rasteve kanë qenë shoqëruese të bashkëshortëve të tyre, si dhe gjendjen e rënduar financiare, duke marrë parasysh se shumica prej tyre kanë qenë përfituese të ndihmave sociale dhe nëna vetushqyese.

Krahas dënimit me kusht, të akuzuarave u është shqiptuar edhe dënimi plotësues, vizitë tek psikologu apo këshilluesi, kjo me qëllim të rehabilitimit dhe re-integrimit të plotë, që është një hap pozitiv drejt arritjes së qëllimit të dënimit.

IKD konsideron se institucioni i Prokurorit të Shtetit, gjatë procedimit me raste të terrorizmit të cilat janë trajtuar në Departamentin Special, ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të siguruar respektimin e plotë të afateve ligjore që rregullojnë kohëzgjatjen e hetimit. Në këtë drejtim duhet përmendur se vendimet mbi pezullimin e hetimeve të ndërmarra nga prokurorët, dhe kërkesat e prokurorisë drejtuar gjykatës për lëshimin e letër rrështimit vendorë dhe ndërkombëtarë, kanë kontribuar suksesshëm në këtë drejtim.

17. Anex 2. Analiza e rasteve të terrorizmit

1. Burg efektiv ndaj të akuzuarit që përmes rrjetit social propagandoi për ISIS-in

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.9/19,

Vepra penale: “*Bashkimi ose pjesëmarrja në ushtrinë apo policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake apo parapolice, në organizimet grupore ose individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës*”,

Gjykatësja: Albina Shabani-Rama

Prokurore: Merita Bina-Rugova

I pandehuri: Berat Qamili

Gjykata Themelore në Prishtinë më 30 gusht 2019 kishte shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarit për vepra që lidhen me terrorizmin, Berat Qamili, dhe atij i kishte shqiptuar burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muajve.¹⁰⁸

Vendimi i nxjerrë në shkallë të parë ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit në janar të vitit 2020, e cila në vendimin e saj kishte vlerësuar se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar, me rastin e caktimit të dënimit ka vlerësuar të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së.¹⁰⁹

Berat Qamili akuzohej nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës se gjatë vitit 2017, përmes llogarisë së tij në rrjetin social “facebook”, kishte përkrahur haptazi veprimet terroriste të organizatës “ISIS”, siç janë sulmet e fundit terroriste nëpër botë duke bërë thirrje të gjithë myslimanëve që t’i bashkëngjiten “luftës së shenjtë për xhihad”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës më 19 dhjetor 2017 kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve ndaj të pandehurit Berat Qamili për shkak të dyshimit se ai kishte kryer vepra penale që lidhen me terrorizmin. Kjo prokurori më 17 janar 2018 kishte ngritur aktakuzë ndaj Berat Qamilit, për shkak të veprave penale që lidhen me terrorizmin, pasi kishin kaluar 30 ditë nga nisja e hetimeve ndaj Qamilit.

Ngritja e aktit akuzues nga ana e PSRK-së është bërë në përputhje të plotë më afatin për kohëzgjatjen e hetimeve të paraparë me nenin 159, i cili parasheh se një hetim i filluar duhet të

¹⁰⁸ “Dënohet me gjashtë muaj burg i akuzuari që pranoi fajësinë për propagandë terroriste në rrjete sociale”. Betimi për Drejtësi. 30 Gusht 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-gjashte-muaj-burg-i-akuzuari-qe-pranoi-fajesine-per-propagande-terroriste-ne-rrjete-sociale/>). (Qasur së fundmi më 18 prill 2020).

¹⁰⁹ “Apeli vërteton dënimin me burg efektiv ndaj të akuzuarit se propagandoi për ISIS-in”. Betimi për Drejtësi. 28 Janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimin-me-burg-efektiv-ndaj-te-akuzuarite-propagandoi-per-isis-in/>). (Qasur së fundmi më 18 prill 2020).

përfundojë brenda dy viteve, me përjashtim të rasteve kur gjyqtari i procedurës paraprahe nuk autorizon një vazhdim të këtij afati për një periudhë prej gjashtë muajve.¹¹⁰

Ndërsa, seanca fillestare ndaj Qamilit ishte mbajtur më 27 gusht 2019, apo **588** ditë pas ngritjes së aktit akuzues. Caktimi i kësaj seance pas më shumë se 19 muajve nga dorëzimi i aktakuzës në gjykatë është veprim i vonuar dhe përbën një shkelje serioze të nenit 242 të KPPK-së, i cili obligon gjyqtarin e çështjes që të caktoj shqyrtimin fillestar brenda 30 dite nga dorëzimi i aktit akuzues në gjykatë, ndërsa ky afat reduktohet në 15 ditë nëse i akuzuari gjendet në paraburgim.¹¹¹

Mirëpo, duhet theksuar se Departamenti Special është funksionalizuar më 1 Korrik 2019, andaj përgjegjësia në mos procedimin me kohë të kësaj çështje i adresohet edhe Departamentit për Krime të Rënda, ngase aktakuza fillimisht ishte ushtruar pranë DKR-së.

Kjo dëshmon se kjo dosje penale ka qëndruar në sirtarët e Departamentit për Krime të Rënda, për më shumë se 17 muaj para se ajo të transferohej në Departamentin Special, pa një arsytim se pse kjo lëndë nuk ishte proceduar brenda afateve ligjore.

Nëse analizojmë datën e ngritjes së aktit akuzues më 17 janar 2018, dhe datën 23 dhjetor 2019 kur Apeli ka vërtetuar aktgjykimin e nxjerrë nga shkalla e parë, del se ky proces gjyqësor mori epilogun e tij pas afro dy viteve, apo 23 muaj e shtatë (7) ditë nga dorëzimi i aktit akuzues.

Kjo përbën shkelje të parimit universal të gjyimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, i cili është përcaktuar me nenin 6 të KEDNJ¹¹², dhe nenin 5 të KPPK-së¹¹³. Sipas këtij parimi, çdo personi i dyshuar ose akuzuar për vepër penale ka të drejtë të kërkojë që ndaj tij të zhvillohet gjykimi paanshëm dhe në kohë të arsyeshme. Ky parim është ngritur edhe në rangun e postulateve kushtetuese, ngase është përcaktuar edhe me nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me një sërë garancish të tjera të nevojshme për garantimin e një procesi të rregullt gjyqësor.

¹¹⁰ Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale. Neni 159.1 “Kur fillohet hetimi, hetimi përfundon brenda dy (2) viteve. Nëse brenda dy (2) viteve nga fillimi i hetimit paraprahe nuk është ngritur aktakuzë, ose nuk është pezulluar hetimi sipas nenit 157 të këtij Kodi, hetimi menjëherë pushohet”.

¹¹¹ Po aty. Neni 242.4. ” Gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton menjëherë shqyrtimin fillestar, i cili duhet të mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve pas ngritjes së aktakuzës”, dhe 262.5 “Nëse i pandehuri është në mbajtje në paraburgim, shqyrtimi fillestar mbahet në mundësinë e parë, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas ngritjes së aktakuzës”.

¹¹² Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut. Neni 6.1. “Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij...”.

¹¹³ Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale. Neni 5.1. “Çdo person i dyshuar ose i akuzuar për vepër penale ka të drejtë të kërkojë procedurë të paanshme penale të zbatuar në kohë të arsyeshme”.

2. Dy vite burgim për të akuzuarin që pranoi se ishte pjesë e ISIS-it në Siri

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.44/19,

Vepra penale: “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”

Gjykatësja: Shadije Gërguri

Prokurori: Afrim Shefkiu

I pandehuri: Agon Misini

Gjykata Themelore në Prishtinë më 2 Dhjetor 2019 e ka shpallur fajtor të akuzuarin për terrorizëm Agon Misini dhe atij i kishte shqiptuar burgim efektiv në kohëzgjatje prej 4 viteve.¹¹⁴

Deri tek një vendim i tillë erdhi pas i akuzuari Misini në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 29 nëntor 2019 ishte deklaruar fajtor për akuzën që i ngarkohej.¹¹⁵

Ky vendim i nxjerrë në shkallë të parë ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, të nxjerrë më 14 shkurt 2020, por atë e ka ndryshuar vetëm sa i përket cilësimit juridik, bazuar në kodin penal që ishte në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale.¹¹⁶

PSRK-ja e akuzonte Agon Misinin se në korrik të vitit 2015 ishte larguar nga Kosova për të përfunduar në shtetin e Sirisë, dhe me dashje i ishte bashkangjitur organizatës terroriste ISIS, ku pas trajnimeve taktike dhe luftarake ka marrë pjesë aktive në luftërat e Sirisë ku edhe më 26 korrik 2017, është arrestuar nga forcat Kurde, ku ka qëndruar deri më 19 prill 2019, me ç’rast edhe është riatdhesuar në Kosovë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PSRK-ja më 4 tetor 2016 ka filluar hetimet ndaj Agron Misini për shkak të dyshimit të arsyeshëm se kishte kryer veprën penale të bashkimit apo pjesëmarrjes në ushtrinë e huaj.

Kjo prokurori, me arsyetimin se nuk mund të sigurohej prezenca e të pandehurit në procedurë kishte marrë vendim për pezullimin e hetimeve më 8 gusht 2018, ndërsa më 20 prill 2019 kishte vendosur që të rifillojë këto hetime. Me vendim të gjyqtarit të procedurës paraprake ky afat ishte zgjatuar dy herë, fillimisht më 15 maj 2019 për 3 muaj dhe më 8 gusht 2019 ishte aprovuar kërkesa për vazhdim të hetimeve edhe për tre muaj të tjerë deri më 8 nëntor 2019. Ky vendim për pezullimin e hetimit ishte ndërmarrë konform nenit 157.1 të KPPK-së, ngase prokuroria

¹¹⁴ “Katër vjet burg ndaj të akuzuarit që pranoi fajësinë se ishte pjesë e ISIS-it dhe luftës në Siri”. Betimi për Drejtësi. 2 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kater-vjet-burg-ndaj-te-akuzuarit-qe-pranoi-fajesine-se-ishte-pjese-e-isis-it-dhe-luftes-ne-siri/>). (Qasur së fundmi më 18 prill 2020).

¹¹⁵ “Pranon fajësinë i akuzuari se mori pjesë dhe luftoi përkrah organizatës terroriste ISIS në Siri”. Betimi për Drejtësi. 29 Nëntor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pranon-fajesine-i-akuzuari-se-mori-pjese-dhe-luftoi-perkrah-organizates-terroriste-isis-ne-siri/>). (Qasur së fundmi më 18 prill 2020).

¹¹⁶ “Apeli vërteton dënimin ndaj të akuzuarit që pranoi fajësinë se ishte pjesë e ISIS-it dhe luftës në Siri, e ndryshon atë vetëm sa i përket cilësimit juridik”. Betimi për Drejtësi. 27 maj 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimin-ndaj-te-akuzuarit-qe-pranoi-fajesine-se-ishte-pjese-e-isis-it-dhe-luftes-ne-siri-e-ndryshon-ate-vetem-sa-i-perket-cilesimit-juridik/>). (Qasur së fundmi më 10 qershor 2020).

konsideronte se ekzistonin rrethana që përkohësisht pengonin ndjekjen me sukses të të pandehurit.¹¹⁷ Nëse procedura penale nuk do të pezullohej kur ekzistonin shkaqe të arsyeshme, atëherë do të rrezikohej që ajo procedurë të pushohet për shkak të kalimit të afatit ligjor që përcakton kohëzgjatjen e procedurës hetimore, apo në raste tjera, do të mund të arrihej edhe parashkrimi i veprave penale, dukuri e cila është mjaft prezentë në sistemin tonë gjyqësor.

PSRK-ja kishte ngritur aktakuzë ndaj Agon Misinit më 7 nëntor 2019 në drejtim të veprës penale organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste.

Seanca e shqyrtimit fillestar ndaj të akuzuarit Misini ishte mbajtur më 29 nëntor 2019, apo 22 ditë pas ngritjes së aktakuzës në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, duke vepruar në përputhje me afatet ligjore të parapara me KPPK.

Pra, që nga ngritja e aktakuzës më 7 nëntor 2019 e deri tek shpallja e aktgjykimit më 2 dhjetor 2019 kanë kaluar vetëm 26 ditë, dhe duhet theksuar se përfundimi i gjykimit brenda këtij afati është në përputhje të plotë me parimin universal të gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, të paraparë me dokumente ndërkombëtare dhe të integruar në rendin tonë juridik.

¹¹⁷ Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale. Neni 157.1. “Prokurori i shtetit mund të pezullojë hetimin me aktvendim nëse i pandehuri pas kryerjes së veprës penale vuan nga një çrregullim ose paaftësi e përkohshme mendore ose nga ndonjë sëmundje tjetër e rëndë, nëse është arratisur ose ekzistojnë rrethana të tjera të cilat përkohësisht e pengojnë ndjekjen me sukses të të pandehurit”.

3. 20 muaj burg për të akuzuarin që postoi foto kërcënuese ndaj Ramush Haradinajt

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.23/19,

Vepra penale: “shtytja për kryerjen e veprave terroriste” dhe “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”.

Gjykatësja: Shadije Gërguri

Prokurori: Afrim Shefkiu

I pandehuri: Bledart Elshani

Gjykata Themelore në Prishtinë më 13 shtator 2019 e kishte gjykuar me dënim unik prej 20 muajve burgim të akuzuarin për shtytje në kryerjen e veprave terroriste dhe armëmbajtje pa leje, Bledart Elshani.¹¹⁸ Pra, për veprën penale të shtytjes në terrorizëm Elshani ishte dënuar me 18 muaj burg, ndërsa për armëmbajtje pa leje ishte dënuar me vetëm katër (4) muaj burgim.

Aktgjykimi dënues ndaj të akuzuarit për terrorizëm dhe armëmbajtje pa leje, Bledart Elshani ishte shpallur pasi që ai në shqyrtimin gjyqësorë të mbajtur më 12 shtator 2019 kishte pranuar fajësinë për veprat që e ngarkonin atë.¹¹⁹

Ky vendim i nxjerrë nga gjykata themelore ishte vërtetuar pjesërisht nga Gjykata e Apelit, e cila ka vërtetuar dënimin e shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë në kohëzgjatje prej 18 muajsh për shtytje në vepra terroriste, ndërsa për armëmbajtje pa leje i ka shqiptuar Elshanit gjobë në lartësi prej 400 euro.¹²⁰

PSRK-ja e akuzonte Bledart Elshanin se ai që nga muaji gusht i vitit 2018 e deri në muajin janar të vitit 2019, si administrator i një kanali në rrjetet sociale, me anë të fotografive dhe video – incizimeve ka bërë propagandim në lidhje me organizatën terroriste “ISIS”, duke përkrahur haptazi veprimet e tyre terroriste siç janë sulmet e fundit në botë në krijimin e “Shtetit Islamik”

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PSRK-ja më 12 janar 2019 kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve ndaj të pandehurit Bledart Elshani për shkak të dyshimit të arsyeshëm se ai kishte kryer veprat penale shtytje në terrorizëm dhe armëmbajtje pa leje.

¹¹⁸ “20 muaj burg për të akuzuarin që pranoi se përkrahu ISIS-in dhe postoi foto kërcënuese ndaj Ramush Haradinajt”. Betimi për Drejtësi. 13 shtator 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/20-muaj-burg-per-te-akuzuarin-qe-pranoi-se-perkrahu-isis-in-dhe-postoi-foto-kercenuese-ndaj-ramush-haradinajt/>). (Qasur së fundmi 19 prill 2020).

¹¹⁹ “I akuzuari pranon fajin, thotë se pendohet se përkrahu ISIS-in dhe postoi foto kërcënuese ndaj Ramush Haradinajt”. Betimi për Drejtësi. 12 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-pranon-fajin-thote-se-pendohet-se-perkrahu-isis-in-dhe-postoi-foto-kercenuese-ndaj-ramush-haradinajt/>). (Qasur së fundmi më 19 prill 2020).

¹²⁰ “Apeli vërteton pjesërisht dënimin me burg ndaj të akuzuarit që përkrahu ISIS-in dhe postoi foto kërcënuese ndaj Ramush Haradinajt”. Betimi për Drejtësi. 22 maj 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-pjeserisht-denimin-me-burg-ndaj-te-akuzuarit-qe-perkrahu-isis-in-dhe-postoi-foto-kercenuese-ndaj-ramush-haradinajt/>). (Qasur së fundmi më 10 qershor 2020).

Ndërsa, më 3 prill 2019, PSRK-ja kishte ngritur aktakuzë ndaj Bledart Elshanit, me arsyetimin se ajo posedonte prova të mjaftueshme për të mbështetur dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari Elshani kishte kryer veprat penale që i ngarkoheshin.

Shqyrtimi fillestar në këtë çështje penale ishte mbajtur më 10 korrik 2019, me ç’rast i akuzuari Elshani ishte deklaruar i pafajshëm për akuzat që i viheshin në barrë.

Caktimi i kësaj seance pas më shumë se 99 ditëve që nga dorëzimi i aktakuzës në gjykatë bie në kundërshtim me afatin ligjor të përcaktuar me nenin 242.4 të KPPK, i cili obligon gjykatën që të caktoj seancën fillestare brenda 30 dite nga ngritja e aktit akuzues.

Seanca e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale ishte mbajtur 12 shtator 2019, pasi gjykata kishte refuzuar kërkesat për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave. Në këtë seancë, pas hapjes së shqyrtimit kryesor dhe pas leximit të aktakuzës, i akuzuari Elshani kishte pranuar fajin për shtytje në terrorizëm dhe armëmbajtje pa leje.

Nëse analizojmë kohëzgjatjen e këtij procesi gjyqësor që nga ngritja e aktakuzës më 3 prill 2019 e deri në shpalljen e aktgjykimit më 13 shtator 2019, mund të konsiderojmë se gjykatës i janë nevojitur 164 ditë për përfundimin e këtij gjykimi në shkallë të parë.

4. Mbi 5 vjet burg ndaj të akuzuarit që pranoi se ishte në “ISIS” dhe se përfshiu fëmijën e tij në aktivitete të rrezikshme

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.59/19,

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”, “Keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës”.

Gjykatësja: Valbona Musliu-Selimaj

Prokurori: Afrim Shefkiu

I pandehuri: Visar Qukovci

Gjykata Themelore në Prishtinë më 27 dhjetor 2019 e kishte shpallur fajtor të akuzuarin për terrorizëm dhe keqtrajtimit apo braktisje të fëmijës, Visar Qukovci dhe atij i kishte shqiptuar një dënim unik prej pesë vite e gjashtë muaj burgim dhe 500 euro gjobë.¹²¹ Për veprën penale “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”, gjykata i ka shqiptuar atij burgim në kohëzgjatje prej katër vjetësh, ndërsa për veprën penale “keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës”, është dënuar me dy vjet burgim dhe 500 euro gjobë.

Ky dënim i është shqiptuar të akuzuarit Qukovci, pasi ai në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 24 dhjetor 2019 kishte pranuar fajësinë për këto dy vepra penale.¹²²

Mirëpo, Gjykata e Apelit, me vendimin e nxjerrë më 6 mars 2020, ia ka rritur dënimin me burg të akuzuarit Visar Qukovci për këto dy vepra penale, ashtu që të akuzuarit Qukovci, për veprat penale “organizim dhe pjesëmarrja në grup terrorist”, dhe “keqtrajtimi apo braktisja e fëmijës”, t’i shqiptohet dënimi unik prej shtatë vite e gjashtë muaj burgim.¹²³

Visar Qukovci akuzohet nga PSRK-ja se më 28 qershor 2014 kishte lëshuar Kosovën me qëllim që ti bashkangjitej organizatës terroriste “ISIS” në Siri, duke qenë i pajisur me uniformë ushtarake, pushkë automatike, si dhe me jelek me eksploziv, e po ashtu, si pjesëtar i kësaj organizate ai ka detyruar fëmijën e tij U.Q, i moshës tre vjeçar që të përfshihet në aktivitete të rrezikshme ku rrezikohet apo dëmtohet zhvillimi i fëmijës.

¹²¹ “Mbi 5 vjet burg ndaj të akuzuarit që pranoi se ishte në “ISIS” dhe se përfshiu fëmijën e tij në aktivitete të rrezikshme”. Betimi për Drejtësi. 27 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mbi-5-vjet-burg-ndaj-te-akuzuarit-qe-pranoi-se-ishte-ne-isis-dhe-se-perfshiu-femijen-e-tij-ne-aktivitete-te-rrezikshme/>). (Qasur së fundmi më 19 prill 2020).

¹²² “I akuzuari pranon se ishte pjesë e “ISIS”-it dhe se përfshiu fëmijën e tij në aktivitete të rrezikshme”. Betimi për Drejtësi. 24 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-pranon-se-ishte-pjese-e-isis-it-dhe-se-perfshiu-femijen-e-tij-ne-aktivitete-te-rrezikshme/>). (Qasur së fundmi më 19 prill 2020).

¹²³ “Apeli ia rrit dënimin me burg të akuzuarit që pranoi se ishte në “ISIS” dhe përfshiu edhe fëmijën e tij në aktivitete të rrezikshme”. Betimi për Drejtësi. 20 maj 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-ia-rrit-denimin-me-burg-te-akuzuarit-qe-pranoi-se-ishte-ne-isis-dhe-perfshiu-edhe-femijen-e-tij-ne-aktivitete-te-rrezikshme/>). (Qasur së fundmi më 10 qershor 2020).

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Më 18 maj 2015, Drejtoria Kundër Terrorizëm e Policisë së Kosovës në Prishtinë kishte ushtruar kallëzimin penal Visar Qukovcit për shkak të veprës penale “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”.

Ndërsa, PSRK-ja më 22 korrik 2015 kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve ndaj të pandehurit Visar Qukovci, kur kishin kaluar 66 ditë që nga paraqitja e kallëzimit penal.

Më 26 gusht 2015, me arsyetimin se i pandehuri gjendej në arrati dhe nuk ishte siguruar prezenca e të akuzuarit, kjo prokurori ka nxjerrë aktvendim për pezullimin e hetimeve, dhe pastaj më 20 prill 2019 kishte marrë aktvendim për rifillim të hetimeve.

Aktakuza ndaj Qukovcit ishte ngritur më 10 dhjetor 2019, afro tetë muaj pas rifillimit të hetimeve ndaj tij, duke respektuar afatin ligjor që rregullon kohëzgjatjen e hetimeve.

Shqyrtimi fillestar ndaj Qukovcit ishte mbajtur më 24 dhjetor 2019, apo 14 ditë pas ushtrimit të kësaj aktakuze, konform nenit 242.4 të KPPK-së, ku përcaktohet afati prej 30 ditësh brenda të cilit gjykata duhet të procedojë me aktakuzën,

Kohëzgjatja e këtij procesi gjyqësor që nga ngritja e aktakuzës më 10 dhjetor 2019 e deri tek shpallja e aktgjykimit më 27 dhjetor të vitit të kaluar, është 17 ditë.

IKD vlerëson se procedimi i kësaj çështje penale është bërë në përputhshmëri të plotë me nenin 6 të KEDNJ, e cila ka zbatim të drejtpërdrejtë në legjislacionin tonë dhe me nenin 5.1 të KPPK, ku rregullohet e drejta për një proces gjyqësor të drejtë, të paanshëm dhe të zbatuar brenda një afati të arsyeshëm.

5. Dënohet me 3 vjet e 8 muaj burg i akuzuari që pranoi se përkrah ISIS-it luftoi në Siri

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.65/19

Vepra penale: “organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”,

Gjykatësi: Valon Kurtaj

Prokurori: Afrim Shefkiu

I pandehuri: Arijan Krujezi

Gjykata Themelore në Prishtinë më 10 janar 2020 e kishte dënuar me tre vjet e tetë muaj burg të akuzuarin për terrorizëm, Arijan Krujezi.¹²⁴

Ky aktgjykim dënues ishte shpallur ndaj të akuzuarit Krujezi pasi që ai më 8 janar të këtij viti ishte deklaruar fajtor për organizim dhe pjesëmarrje në grupe terroriste.¹²⁵

Ky vendim i gjykatës themelore ishte ndryshuar nga Gjykata e Apelit, e cila me vendimin e nxjerrë më 6 mars 2020, të akuzuarit Arijan Krujezi ia rriti dënimin në gjithsej katër vite e gjashtë muaj burgim.¹²⁶ PSRK-ja e akuzon Krujeziun se në muajin korrik të vitit 2014 largohet nga Kosova me paramendim dhe me dashje që t'i bashkëngjitet organizatës terroriste “ISIS” në Siri, ku ishte regjistruar dhe kishte vijuar trajnimet taktike dhe luftarake me armë të zjarrit, duke marrë pjesë aktive në luftërat e Sirisë, si anëtar i batalionit “Abu Musab Zarkaëi” dhe pastaj në “Umar Hattab” në Damask të Sirisë.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PSRK-ja kishte nxjerr aktvendim për fillimin e hetimeve ndaj Arijan Krujezi më 21 gusht 2016, ndërsa më 14 dhjetor 2017, kjo prokurori me arsyetimin se nuk ishte siguruar prezenca e të akuzuarit, nxori vendim për pezullimin e hetimeve, derisa këto pengesa të eliminoheshin.

Më 20 prill 2019, PSRK-ja mori vendim për rifillimin e hetimeve, ndërsa aktakuza ndaj Arijan Krujezi është ngritur më 16 dhjetor 2019.

Seanca fillestare në këtë rast ishte mbajtur më 8 janar 2020, ndërsa shpallja e aktgjykimit ishte bërë më 10 janar të këtij viti, duke vepruar konform dispozitave ligjore.

Pra, ky gjykim që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit ka zgjatuar 24 ditë.

¹²⁴ “Dënohet me 3 vjet e 8 muaj burg i akuzuari që pranoi se përkrah ISIS-it luftoi në Siri”. Betimi për Drejtësi, 10 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-3-vjet-e-8-muaj-burg-i-akuzuari-qe-pranoi-se-perkrah-isis-it-luftoi-ne-siri/>). (Qasur së fundmi më 20 prill 2020).

¹²⁵ “I akuzuari pranon fajësinë se përkrah ISIS-it mori pjesë në luftën e Sirisë”. Betimi për Drejtësi, 8 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-akuzuari-pranon-fajesine-se-perkrah-isis-it-mori-pjese-ne-luften-e-sirise/>). (Qasur së fundmi më 20 prill 2020).

¹²⁶ “Apeli ia rrit dënimin me burg të akuzuarit që ka pranuar se luftoi në Siri përkrah ISIS-it”. Betimi për Drejtësi, 14 maj 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-ia-rrit-denimin-me-burg-te-akuzuarit-qe-kan-pranuar-se-luftoi-ne-siri-perkrah-isis-it/>). (Qasur së fundmi më 10 qershor 2020).

6. Dënohet me burgim me kusht e akuzuara që deklaroi se është penduar për shkuarjen në Siri

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.22/19

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”,

Gjykatësi: Valon Kurtaj

Prokurori: Naim Abazi,

E pandehura: Merita Aliu.

Gjykata Themelore në Prishtinë më 3 shtator 2019 e ka dënuar me dy vite burgim me kusht të akuzuarën për pjesëmarrje në grupe terroriste, Merita Aliu.¹²⁷

Ky dënim me kusht i shqiptuar ndaj saj nuk do të ekzekutohet nëse ajo nuk kryen vepër tjetër brenda afatit prej tre viteve.

PSRK-ja e akuzon Aliu se më 1 korrik 2015, me vetëdije dhe dëshirë ishte larguar nga Kosova që tu bashkohej grupeve terroriste, ashtu që thuhet se ajo kishte përfunduar në territor të kontrolluar nga ISIS, e që më pas edhe i ishte bashkuar kësaj organizate dhe organizatës “Al Nusra”, duke vepruar në to deri më 10 dhjetor 2017.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Më 3 tetor 2017, DKT e Policisë së Kosovës kishte dorëzuar në PSRK, kallëzimin penal të ushtruar ndaj të pandehurës Merita Aliu.

Më 12 shkurt 2018, PSRK-ja kishte nxjerr vendimin për fillimin e hetimeve ndaj Aliu, ndërsa më 5 nëntor 2018 ajo pezullon hetimet, ngase e pandehura ishte e paarritshme për organet e ndjekjes. Më 23 prill 2019, kjo prokurori ka rifilluar hetimet ndaj Aliu.

PSRK-ja më 19 gusht 2019 kishte ngritur aktakuzë për terrorizëm ndaj të akuzuarës Merita Aliu.

Seanca fillestare ndaj Aliut ishte mbajtur më 3 shtator 2019, brenda afatit ligjor të përcaktuar me nenin 242.4 të KPPK-së, me ç ‘rast e akuzuara kishte pranuar fajësinë për këtë vepër penale.

Shpallja e aktgjykimit ndaj të akuzuarës Aliu ishte bërë po më 3 shtator të vitit 2019.

Ky proces gjyqësor, që nga ngritja e aktit akuzues e deri me shpalljen e aktgjykimit ka zgjatur 16 ditë.

¹²⁷ “Dënohet me burgim me kusht e akuzuara që deklaroi se është penduar për shkuarjen në Siri”. Betimi për Drejtësi. 3 shtator 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-burgim-me-kusht-e-akuzuara-qe-deklaroi-se-eshte-penduar-per-shkuarjen-ne-siri/>). (Qasur së fundmi më 20 prill 2020).

7. Dënohet me kusht e akuzuara që pranoi fajësinë për pjesëmarrje në grupe terroriste

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.38/19

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”,

Gjykatësi: Valbona Selimaj

Prokurori: Sylë Hoxha

E pandehura: Nagjie Hasani

Gjykata Themelore në Prishtinë më 9 tetor 2019 e kishte shpallur fajtores për terrorizëm të akuzuarën Nagjie Hasani dhe atë e kishte dënuar me dy vjet burgim me kusht. Ky dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara nuk kryen veprën të re penale brenda periudhës tri vjeçare të verifikimit.¹²⁸

Deri tek një vendim i tillë erdhi pasi e akuzuara Hasani, në seancën fillestare të 9 tetorit e pranoi fajësinë për këtë veprën penale.

PSRK-ja e akuzonte Hasanin se në shtator 2014, së bashku me burrin dhe tre fëmijët e saj, ishte larguar nga Kosova me destinacion Sirinë, me qëllim të bashkëngjitjes së grupeve terroriste të njohura si “ISIS”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Më 29 shtator 2017, DKT e Policisë së Kosovës kishte dorëzuar kallëzimin penal në PSRK, kundër Nagjia Hasanit për shkak të dyshimit se ajo kishte kryer veprën penale Bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj.

Më 1 nëntor 2017 PSRK-ja kishte nxjerr vendimin mbi fillimin e hetimeve, mirëpo për shkak të vështirësive në sigurimin e prezencës së të akuzuarës, kjo prokurori më 30 janar 2018 kishte pezulluar këto hetime.

Më 23 prill 2019, PSRK-ja kishte rifilluar hetimet, dhe pas më shumë se 5 muajve, më 30 shtator 2019, kjo prokurori ngriti aktakuzë ndaj Nagjie Hasanit.

Seanca fillestare ishte mbajtur më 9 tetor 2019, dhe po të njëjtën seancë është bërë shpallja e aktgjykimit, pasi u deklarua fajtores për akuzën që e ngarkonte.

Ky gjykim, që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e aktgjykimit kishte zgjatur vetëm 10 ditë.

¹²⁸ “Dënohet me kusht e akuzuara që pranoi fajësinë për pjesëmarrje në grupe terroriste, falënderon Kosovën që e ktheu nga Siria”. Betimi për Drejtësi. 9 tetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-kusht-e-akuzuara-qe-pranoi-fajesine-per-pjesemarrje-ne-grupe-terroriste-falenderon-kosoven-qe-e-ktheu-nga-siria/>). (Qasur së fundmi më 20 prill 2020).

8. Pas kthimit nga Siria, e akuzuara e pranon fajësinë dhe dënohet me kusht

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.46/19

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”,

Gjykatësi: Valbona Selimaj

Prokurore: Habibe Salih

E pandehura: Florinda Zymeri

Gjykata Themelore në Prishtinë më 15 janar 2020 ka shqiptuar burgim me kusht në kohëzgjatje prej dy viteve ndaj të akuzuarës për terrorizëm, Florinda Zymeri. Ky dënim nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara nuk kryen vepër tjetër penale brenda tre viteve.¹²⁹

Fillimisht, e akuzuara Zymeri, në seancën fillestare të 6 dhjetorit 2019 ishte deklaruar e pafajshme për këtë vepër penale, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 14 janar të këtij viti ajo u deklarua fajtores për pjesëmarrje në grupe terroriste.

PSRK-ja e akuzonte Florinda Zymerin se në gusht të vitit 2014, me dëshirë dhe vetëdije të plotë ishte larguar nga Kosova me qëllim që t’i bashkëngjitej organizatës terroriste “ISIS”, në Siri dhe Irak.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Kallëzimi penal ndaj të pandehurës Florinda Zymeri është dorëzuar më 23 prill 2019, nga DKT e Policisë së Kosovës në PSRK.

Kjo prokurori më 23 prill 2019 kishte nxjerrë vendim për fillim të hetimeve ndaj të akuzuarës Zymeri, për shkak të dyshimit të bazuar se ajo ka kryer veprën penale të terrorizmit.

PSRK-ja më 19 nëntor 2019 kishte ngritur aktakuzë për terrorizëm ndaj Florinda Zymerit.

Seanca fillestare ndaj Zymerit ishte mbajtur më 6 dhjetor 2019¹³⁰, ndërsa shqyrtimi i dytë në këtë çështje penale nuk ishte mbajtur, por që palët janë njoftuar se brenda 30 ditëve ata mund të paraqesin kërkesat për hedhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave. Ky veprim është ndërmarrë konform nenit 245.5 të KPPK-së, sipas të cilit në rast se shqyrtimi i dytë nuk mbahet, gjyqtarja mund që brenda 30 ditë të kërkojë nga palët paraqitjen e këtyre propozimeve.¹³¹

¹²⁹ “Pas kthimit nga Siria, e akuzuara e pranon fajësinë dhe dënohet me kusht”. Betimi për Drejtësi. 15 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-kthimit-nga-siria-e-akuzuara-e-pranon-fajesine-dhe-denohet-me-kusht/>). (Qasur së fundmi më 20 prill 2020).

¹³⁰ “E akuzuara mohon fajësinë se ishte pjesë e ISIS-it, gjatë deklarimit urdhërohet ta heq mbulesën e fytyrës”. Betimi për Drejtësi. 6 dhjetor 2019. (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/e-akuzuara-mohon-fajesine-se-ishte-pjese-e-isis-it-gjate-deklarimit-urdherohet-ta-heq-mbulesen-e-fytyres/>). (Qasur së fundmi më 20 prill 2020).

¹³¹ Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale. Neni 245.5. “Gjatë shqyrtimit fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit gjykues cakton shqyrtimin e dytë jo më herët se tridhjetë (30) ditë pas shqyrtimit fillestar dhe jo më vonë se dyzet (40) ditë pas shqyrtimit fillestar. Në të kundërtën, gjyqtari i vetëm gjykues ose kryetari i trupit

Shqyrtimi kryesor ndaj Zymerit kishte filluar më 14 janar 2020, ndërsa shpallja e aktgjykimit ishte bërë një ditë pas, më 15 janar.

Ky proces gjyqësor, që nga ngritja e aktit akuzues e deri me shpalljen e aktgjykimit, ka zgjatur 58 ditë.

gjykues mund të kërkojë vetëm paraqitjen e propozimeve deri në datën e caktuar e cila nuk mund të jetë më vonë se tridhjetë (30) ditë nga shqyrtimi fillestar”.

9. Dy vite burgim me kusht ndaj të akuzuarës që pranoi fajësinë për pjesëmarrje në grupet terroriste ISIS dhe Al-Nusra

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.63/19

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”,

Gjykatësja: Shadije Gërguri

Prokurori: Sylë Hoxha/ Florije Salihu-Shamolli

E pandehura: Agnesë Zuzaku

Gjykata Themelore në Prishtinë më 27 dhjetor 2019 kishte shpallur aktgjykimi ndaj të akuzuarës Agnesë Zuzaku, dhe atë e kishte dënuar me dy vite burgim me kusht. Ky dënim nuk do të ekzekutohet nëse ajo nuk kryen vepër tjetër penale brenda tri viteve.¹³²

Ky aktgjykim dënues është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit më 20 shkurt 2020, e cila ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ushtruar nga mbrojtja.¹³³

PSRK-ja e akuzonte Zuzakun se në shtator të vitit 2014, me dashje dhe vetëdije ishte larguar nga Kosova me qëllim që t’iu bashkëngjitet grupeve terroriste “ISIS” dhe “Al Nusra”, dhe se gjatë qëndrimit në Siri-zonat e luftës ka pranuar shuma nga 50 deri në 150 dollarë për muaj.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Më 26 shtator 2017 DKT e Policisë së Kosovës ka dorëzuar në PSRK kallëzimin penal ndaj të pandehurës Agnesë Zuzaku në dyshimin se ajo ka kryer veprën penale të pjesëmarrjes në grupe terroriste.

Më 23 nëntor 2017, PSRK ka nxjerr vendim për fillim të hetimeve, ndërsa më 26 dhjetor 2018 kjo prokurori vendosi për pezullimin e hetimeve. Rifillimin e hetimeve kjo prokurori e ka bërë më 23 prill 2019, ndërsa akti akuzues për terrorizëm ndaj Zuzakut është ngritur më 16 dhjetor 2019.

Seanca fillestare ndaj Zuzakut ishte mbajtur më 24 dhjetor 2019, ndërsa shpallja e aktgjykimit ishte bërë tri ditë më pas, më 27 dhjetor të vitit të kaluar. Kohëzgjatje e këtij procesi gjyqësor që nga ngritja e aktit akuzues e deri më shpalljen e aktgjykimit ka qenë 11 ditë.

¹³² “Dy vite burgim me kusht ndaj të akuzuarës që pranoi fajësinë për pjesëmarrje në grupet terroriste ISIS dhe Al-Nusra”. Betimi për Drejtësi. 27 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dy-vite-burgim-me-kusht-ndaj-te-akuzuares-qe-pranoi-fajesine-per-pjesemarrje-ne-grupet-terroriste-isis-dhe-al-nusra/>). (Qasur së fundmi më 20 prill 2020).

¹³³ “Apeli vërteton dënimin me kusht ndaj të akuzuarës për pjesëmarrje në grupe terroriste”. Betimi për Drejtësi. 18 mars 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimin-me-kusht-ndaj-te-akuzuares-per-pjesemarrje-ne-grupe-terroriste/>). (Qasur së fundmi më 20 prill 2020).

10. Pranon fajësinë, dënohet me dy vjet burg me kusht e akuzuara për terrorizëm

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.71/19

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”,

Gjykatësja: Shadije Gërguri

Prokuror: Haki Gecaj

E pandehura: Fatbardhë Demolli

Gjykata Themelore në Prishtinë më 10 janar 2020 e ka dënuar me dy vite burgim me kushte të akuzuarën për terrorizëm, Fatbardhë Demolli. Periudha e verifikimit është caktuar në kohëzgjatje prej tre viteve.¹³⁴ Paraprakisht, e akuzuara Demolli, në seancën fillestare të 8 janarit ishte deklaruar fajtores për pjesëmarrje në grupe terroriste.¹³⁵

PSRK-ja e akuzonte Demollin se me qëllim që të marr pjesë në veprimtarinë e grupeve terroriste në ISIS në Siri, kishte udhëtuar përmes Shkupit, për në Stamboll dhe më pas i ishte bashkuar bashkëshortit të saj, Fidan Demolli, i cili vepronte në kuadër të grupit terrorist ISIS.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PSRK-ja më 27 shtator 2017 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar DKT e Policisë së Kosovës ndaj Fatbardhë Demollit. Kjo prokurori më 15 janar 2018 kishte nxjerr aktvendim për fillim të hetimeve kundër Demollit. Më datën 6 dhjetor 2018, gjykata kishte lëshuar Letër rreshtimin ndërkombëtarë sipas kërkesës së Prokurorisë Speciale të datës 30 nëntor 2018.

Këto veprime janë ndërmarrë konform nenit 535.4 të KPPK-së, ku rregullohet procedura e dhënies së letërrreshtimit ndërkombëtarë, pasi që në rastin konkret sipas PSRK-së, personi i kërkuar nuk gjendej në Kosovë.¹³⁶ PSRK-ja më 23 dhjetor 2019 ka ngritur aktakuzë ndaj Fatbardhë Demollit, për shkak të dyshimit të bazuar se ajo ka kryer veprën penale të organizimit dhe pjesëmarrjes në grupe terroriste.

Seanca fillestare ndaj Demollit ishte mbajtur më 8 janar 2020, ndërsa shpallja e aktgjykimit ishte bërë më 10 janar të këtij viti. Pra, ky gjykim që nga ngritja e aktakuzës në gjykatë e deri në shpallje të aktgjykimit ka zgjatur 19 ditë.

¹³⁴ “Pranon fajësinë, dënohet me dy vjet burg me kusht e akuzuara për terrorizëm”. Betimi për Drejtësi. 10 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pranon-fajesine-denohet-me-dy-vjet-burg-me-kusht-e-akuzuara-per-terrorizem/>). (Qasur së fundmi më 20 prill 2020).

¹³⁵ “E akuzuara pranon se ishte pjesë e ISIS-it, falënderon institucionet që e kthyen në Kosovë”. Betimi për Drejtësi. 8 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/e-akuzuara-pranon-se-ishte-pjese-e-isis-it-falenderon-institucionet-qe-e-kthyen-ne-kosove/>). (Qasur së fundmi më 20 prill 2020).

¹³⁶ Kodi Nr. 04/L-123 i Procedurës Penale. Neni 535.4. “Letërrreshtimi ndërkombëtar mund të kërkohej në cilëndo nga situatat e parapara sipas këtij neni, nga ana e autoritetit përkatës kur personi i kërkuar nuk gjendet në Kosovë ose ka prova se personi banon jashtë Kosovës”.

11. Burg me kusht ndaj të akuzuarës që pranoi fajësinë për pjesëmarrje në grup terrorist

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.69/19

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”,

Gjykatësja: Shadije Gërguri,

Prokurore: Habibe Salih,

E pandehura: Afërdita Mulolli

Gjykata Themelore në Prishtinë më 14 janar 2020 ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarës për terrorizëm, Afërdita Mulolli dhe asaj i ka shqiptuar dy vite burgim me kusht. Afati i verifikimit është caktuar në kohëzgjatje prej tre viteve.¹³⁷

Paraprakisht, e akuzuara Mulolli në shqyrtimin fillestar të 14 janarit ishte deklaruar fajtores për këtë vepër penale.¹³⁸

PSRK-ja e akuzonte Mulollin se në dhjetor 2014, me dashje dhe vetëdije të plotë ishte larguar në Kosova me qëllim që ti bashkëngjitej organizatës terroriste ISIS, nga e cila organizatë ajo ishte financuar rregullisht me një shumë të të hollave në vlerë prej 200-300 euro në muaj.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Më 27 shtator 2017, DKT e Policisë së Kosovës ka ushtruar kallëzim penal në PSRK ndaj të pandehurës Afërdita Mulolli, për shkak të dyshimit se ajo kishte kryer vepra që lidhen me terrorizëm.

PSRK-ja më 23 prill 2019 kishte nxjerrë aktvendim për fillim të hetimeve ndaj Mulollit, dhe pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore, kjo prokurori më 23 dhjetor 2019 kishte ngritur aktakuzë ndaj Mulollit, për pjesëmarrje në grupe terroriste.

Seanca fillestare ndaj Mulollit ishte mbajtur më 13 janar 2020, ndërsa shpallja e aktgjykimit ishte bërë më 14 janar të këtij viti.

Ky gjykim ka zgjatur plot 26 ditë, nga ngritja e aktakuzës e deri me shpalljen e verdiktit në shkallë të parë.

¹³⁷ “Burg me kusht ndaj të akuzuarës që pranoi fajësinë për pjesëmarrje në grup terrorist”. Betimi për Drejtësi. 14 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/burg-me-kusht-ndaj-te-akuzuaraes-qe-pranoi-fajesine-per-pjesemarrje-ne-grup-terrorist/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

¹³⁸ “E akuzuara pranon fajësinë, thotë se në Siri shkoi për t’u bashkuar me burrin e saj, e jo për qëllime tjera”. Betimi për Drejtësi. 13 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/e-akuzuara-pranon-fajesine-thote-se-ne-siri-shkoi-per-tu-bashkuar-me-burrin-e-saj-e-jo-per-qellime-tjera/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

12. Dy vjet burg me kusht ndaj të akuzuarës që pranoi fajësinë se ishte pjesë e ISIS-it

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.77/19

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”,

Gjykatësja: Valbona Selimaj

Prokurore: Florije Salihu-Shamolli

E pandehura: Edonë Berisha

Gjykata Themelore në Prishtinë më 15 janar 2020 e kishte dënuar me dy vjet burgim me kusht të akuzuarën për pjesëmarrje në grupe terroriste, Edonë Berisha. Ky dënim nuk do të ekzekutohet nëse ajo nuk kryen vepër tjetër penale brenda tre viteve.¹³⁹

Paraprakisht, në shqyrtimin fillestar të 14 janarit, e akuzuara ishte deklaruar fajtore për këtë vepër penale. PSRK-ja e akuzonte Edonë Berishën se në gusht të vitit 2014 ishte larguar nga Kosova së bashku me fëmijët e saj në drejtim të Sirisë, ku edhe është regjistruar si pjesëtare e grupi terrorist ISIS.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Më 28 shtator 2017, DKT e Policisë së Kosovës kishte ushtruar kallëzim penal në PSRK ndaj Edona Berisha, për shkak të dyshimit se ajo kishte kryer vepra penale të terrorizmit.

Më 5 shkurt 2018, PSRK-ja kishte filluar hetimet ndaj Berishës, ndërsa më 20 mars 2019, ky hetim ishte pezulluar, me arsyetimin se e akuzuara gjendej në Siri dhe ishte e paarritshme për organet e ndjekjes.

Kjo prokurori më 23 prill 2019 kishte rifilluar hetimet dhe pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore, PSRK-ja më 30 dhjetor ka ngritur aktakuzë për pjesëmarrje në grupe terroriste ndaj Edonë Berisha.

Seanca fillestare ndaj të akuzuarës Berisha është mbajtur më 14 janar 2020, ndërsa shpallja e vendimit ishte bërë më 15 janar.

Ky proces gjyqësor, marrë parasysh ngritjen e aktit akuzues e deri me shpalljen e aktgjykimit ka zgjatur 17 ditë.

¹³⁹ “Dy vjet burg me kusht ndaj të akuzuarës që pranoi fajësinë se ishte pjesë e ISIS-it”. Betimi për Drejtësi. 21 prill 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dy-vjet-burg-me-kusht-ndaj-te-akuzuares-qe-pranoi-fajesine-se-ishte-pjese-e-isis-it/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

13. Deklarohet e pafajshme e akuzuara për pjesëmarrje në grupet terroriste në Siri e Irak

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.49/19

Vepra penale: “*Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist*”,

Gjykatësi: Musa Konxheli

Prokurori: Agron Bajrami

E pandehura: Melihate Alshiqi

E akuzuara për pjesëmarrje në grupe terroriste, Melihate Alshiqi, është deklaruar e pafajshme në seancën fillestare të mbajtur më 9 dhjetor 2019.¹⁴⁰

Ajo po akuzohet se në korrik të vitit 2015, së bashku me burrin e saj, tani të ndjerë dhe fëmijën e tyre, kanë kaluar përmes pikës kufitare të Hanit të Elezit, me destinacion Sirinë, me qëllim që t’i bashkëngjiten grupeve terroriste “ISIS” dhe “Al-Nusra”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Më 2 shtator 2017 PSRK-ja kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga DKT e Policisë së Kosovës ndaj Melihate Alshiqit, për shkak të dyshimit se ajo kishte kryer veprën penale bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë e huaj.

PSRK-ja më 7 gusht 2018 kishte iniciuar procedurën hetimore me arsyetimin se në veprimet e të pandehurës Alshiqi manifestoheshin elementet e veprës penale të pjesëmarrjes në grupe terroriste. Më 17 tetor 2018, gjykata kishte lëshuar urdhër për letër rreshtim ndërkombëtar, sipas kërkesës së kësaj prokurorie.

Më 7 nëntor 2018, kjo prokurori kishte vendosur që të pezullojë hetimet ndaj të pandehurës Alshiqi, ndërsa më 23 prill PSRK-ja kishte rinisur këto hetime, pasi sipas saj, ishin eliminuar pengesat faktike.

Aktakuza ndaj Melihate Alshiqi ishte ngritur më 25 nëntor 2019, ndërsa seanca fillestare ishte mbajtur më 9 dhjetor të vitit të kaluar.

Shqyrtimi i dytë në këtë çështje penale nuk ishte caktuar, por palët ishin njoftuar për mundësinë e paraqitjes së kundërshtimeve dhe kërkesave për hedhje të aktakuzës brenda afatit prej 30 ditëve, Ky proces gjyqësor është në vazhdim e sipër dhe pritet të vazhdojë me caktimin e shqyrtimit kryesor në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

¹⁴⁰ “Deklarohet e pafajshme e akuzuara për pjesëmarrje në grupet terroriste në Siri e Irak”. Betimi për Drejtësi. 9 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-e-pafajshme-e-akuzuara-per-pjesemarrje-ne-grupet-terroriste-ne-siri-e-irak/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

14. Deklarohet e pafajshme e akuzuara se me dashje i ishte bashkuar ISIS-it në Siri

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.70/19

Vepra penale: “*Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist*”,

Gjykatësi: Musa Konxheli

Prokurore: Habibe Salih

E pandehura: Jehona Xhemshiti

Jehona Xhemshiti ishte deklaruar e pafajshme për veprën penale organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste. Një deklaram të tillë, e akuzuara për terrorizëm Xhemshiti e kishte bërë në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 8 janar 2020.¹⁴¹

PSRK-ja e akuzonte Xhemshitin se në dhjetor 2014, me dashje dhe vetëdije të plotë ishte larguar nga Kosova me destinacion Sirinë, me qëllim që ti bashkëngjitej organizatës terroriste “ISIS”, nga i cili shtet janë financuar rregullisht.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

DKT e Policisë së Kosovës më 23 prill 2019 kishte dorëzuar kallëzimin penal të ushtruar kundër të pandehurës Jehona Xhemshiti në PSRK.

Kjo prokurori, po të njëjtën ditë, më 23 prill kishte ndërmarrë veprime hetimore ndaj Xhemshitit, në drejtim të veprës penale organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste.

Aktakuza ndaj Xhemshitit ishte ngritur më 23 dhjetor 2019, ndërsa gjykata kishte proceduar me seancën fillestare në këtë rast më 8 janar 2020.

Ky proces gjyqësor është duke vazhduar në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe pritet të procedohet me seancën e shqyrtimit kryesor.

¹⁴¹ “*Deklarohet e pafajshme e akuzuara se me dashje i ishte bashkuar ISIS-it në Siri*”. Betimi për Drejtësi. 8 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-e-pafajshme-e-akuzuara-se-me-dashje-i-ishte-bashkuar-isis-it-ne-siri/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

15. Burg me kusht për nënën me dy vajzat që pranuan fajësinë për pjesëmarrje në grup terrorist

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.56/19

Vepra penale: “*Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist*”,

Gjykatësja: Albina Shabani-Rama

Prokurore: Merita Bina-Rugova

Të pandehura: Meke Tafaj, Valdete Tafaj – Daçaj, Shyhrete Tafaj

Gjykata Themelore në Prishtinë më 17 janar 2020 kishte dënuar me burgim me kusht në kohëzgjatje prej dy vite secilën nga tri të akuzuarat, Shyhrete, Meke dhe Valdete Tafaj, për pjesëmarrje në grup terrorist. Periudha e verifikimit për to është caktuar në kohëzgjatje prej tre viteve.¹⁴²

Paraprakisht, tri të akuzuarat Tafaj, në shqyrtim fillestar u deklaruan fajtores për këto akuza.¹⁴³

PSRK-ja i akuzonte Meke, Valdete dhe Shyhrete Tafajn se gjatë viteve 2014-2015 ishin larguar nga Kosova në drejtim të Sirisë, dhe se duke e përdorur shumën e rregullt mujore të të hollave nga ISIS-i, u kanë ofruar shërbime logjistike meshkujve të familjes.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PSRK-ja më 24 shkurt 2016 kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga DKT e Policisë së Kosovës ndaj tri të akuzuarave Tafaj për vepra penale që lidhen me terrorizëm. Më 10 gusht 2016, PSRK-ja kishte filluar hetimet ndaj të akuzuarave Tafaj, mirëpo ky hetim, më 6 mars 2017 ishte pezulluar, me arsyetimin se ato ishin të paarritshme për drejtësinë.

Kjo prokurori, më 9 dhjetor 2019 kishte ngritur aktakuzën ndaj tri të akuzuarave Tafaj, për shkak të veprës penale secila veç e veç “organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste”.

Seanca fillestare ndaj tyre ishte mbajtur më 15 janar 2020, ndërsa shpallja e aktgjykimit ishte bërë dy ditë më pas, më 17 janar të këtij viti.

Ky gjykim, që nga ngritja e aktit akuzues e deri me shpalljen e verdiktit në shkallë të parë, ka zgjatur 40 ditë.

¹⁴² “Burg me kusht për nënën me dy vajzat që pranuan fajësinë për pjesëmarrje në grup terrorist”. Betimi për Drejtësi. 17 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/burg-me-kusht-per-nenen-me-dy-vajzat-qe-pranuan-fajesine-per-pjesemarrje-ne-grup-terrorist/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

¹⁴³ “Nëna me dy vajzat pranojnë fajësinë, thonë se në Siri shkuan për t’u shërbyer burrave të tyre”. Betimi për Drejtësi. 15 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nena-me-dy-vajzat-pranojne-fajesine-thone-se-ne-siri-shkuan-per-tu-sherbyer-burrave-te-tyre/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

16. Dy vjet burg me kusht ndaj të akuzuarës që tha se ishte gabim i madh shkuarja në Siri

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.50/19,

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”,

Gjykatësja: Shadije Gërguri

Prokurori: Agron Bajrami

E pandehura: Liridona Lutolli

Gjykata Themelore në Prishtinë më 24 janar 2020 e kishte dënuar me dy vjet burgim me kusht të akuzuarën për terrorizëm, Liridona Lutolli. Afati i verifikimit është caktuar të jetë tre vjet.¹⁴⁴

Paraprakisht, në seancën fillestare të 22 janarit, e akuzuara Lutolli ishte deklaruar fajtores për këtë vepër penale.¹⁴⁵

PSRK e akuzon Lutollin se në dhjetor të vitit 2013 ishte larguar nga Kosova me destinacion Sirinë, me qëllim që t’iu bashkëngjitej grupeve terroriste ISIS dhe Al-Nusra, të cilat veprojnë në Siri dhe Irak.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Më 27 shtator 2017 PSRK-ja kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar nga DKT e Policisë së Kosovës ndaj Liridona Lutollit.

Më 7 gusht 2018, kjo prokurori kishte filluar veprimet hetimore ndaj Lutollit, ndërsa më 20 shtator 2018, këto hetime janë pezulluar. Këto hetime kanë rifilluar më 23 prill 2019, dhe pas ndërmarrjes së këtyre veprimeve, PSRK-ja më 25 nëntor 2019 ka ngritur aktakuzë ndaj Lutollit.

Seanca fillestare ishte mbajtur më 22 janar 2020, ndërsa shpallja e aktgjykimit ishte bërë dy ditë më pas, më 24 janar të këtij viti.

Ky gjykim ka përfunduar brenda 61 dite, kur marrim parasysh periudhën e ngritjes së aktit akuzues e deri me shpalljen e aktgjykimit.

¹⁴⁴“Dy vjet burg me kusht ndaj të akuzuarës që tha se ishte gabim i madh shkuarja në Siri”. Betimi për Drejtësi. 21 prill 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dy-vjet-burg-me-kusht-ndaj-te-akuzuares-qe-tha-se-ishte-gabim-i-madh-shkuarja-ne-siri/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

¹⁴⁵“E akuzuara pranon fajësinë, thotë se ishte gabim i madh shkuarja në Siri”. Betimi për Drejtësi. 22 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/e-akuzuara-pranon-fajesine-thote-se-ishte-gabim-i-madh-shkuarja-ne-siri/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

17. Dënohet me dy vjet burgim me kusht e akuzuara që pranoi se ishte pjesë e ISIS-it

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.73/19,

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”,

Gjykatësi: Valon Kurtaj

Prokurore: Habibe Salih

E pandehura: Remzije Qazimi

Gjykata Themelore në Prishtinë më 24 janar 2020 e ka shpallur fajtores për terrorizëm Remzije Qazimin dhe atë e ka dënuar me burgim me kusht prej dy viteve. Afati i verifikimit është caktuar të jetë tri vjet brenda të cilit e akuzuara nuk duhet të kryejë veprë tjetër penale.¹⁴⁶

Paraprakisht, në seancë fillestare, e akuzuara Qazimi kishte pranuar fajësinë për këtë veprë.¹⁴⁷

PSRK-ja e akuzonte Qazimin se në gusht të vitit 2014, me dashje dhe vetëdije të plotë ishte larguar nga Kosova në drejtim të Sirisë, për t’iu bashkangjitur organizatës terroriste “ISIS”.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

Më 23 prill 2019, PSRK-ja kishte pranuar nga DKT e Policisë së Kosovës, kallëzimin penal të ushtruar ndaj të pandehurës Qazimi.

Kjo prokurori, po të njëjtën ditë, më 23 prill 2019 kishte filluar hetimet ndaj Qazimit, ndërsa më 26 dhjetor 2019, pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore, PSRK-ja ngriti aktakuzë ndaj saj, për shkak të veprës penale të pjesëmarrjes në grupe terroriste.

Seanca fillestare ndaj Qazimit ishte mbajtur më 23 janar 2020, ndërsa shpallja e aktgjykimit ishte bërë një ditë më pas, më 24 janar të këtij viti.

Ky proces gjyqësor, që nga koha e ngritjes së aktakuzës e deri me shpalljen e aktgjykimit, ka zgjatur 61 ditë.

¹⁴⁶ “Dënohet me dy vjet burgim me kusht e akuzuara që pranoi se ishte pjesë e ISIS-it”. Betimi për Drejtësi. 24 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-dy-vjet-burgim-me-kusht-e-akuzuara-qe-pranoi-se-ishte-pjese-e-isis-it/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

¹⁴⁷ “E akuzuara: E pranoj se isha në Siri, burri më mashtror duke më thënë se po shkojmë për pushime”. Betimi për Drejtësi. 23 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/e-akuzuara-e-pranoj-se-isha-ne-siri-burri-me-mashtror-duke-me-thene-se-po-shkojme-per-pushime/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

18. Dy vjet burg me kusht për dy të akuzuarat që pranuan se ishin pjesë e ISIS-it

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.66/19,

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”,

Gjykatësi: Albina Shabani-Rama

Prokurori: Afrim Shefkiu

Të pandehura: Venera Ademi dhe Ermira Sekiraqa

Gjykata Themelore në Prishtinë ka dënuar me nga dy vjet burgim me kusht dy të akuzuarat për terrorizëm Venera Ademi dhe Ermira Sekiraqa. Ky dënim nuk do të ekzekutohet nëse ato nuk kryejnë vepër tjetër penale brenda tri viteve.¹⁴⁸ Dy të akuzuarat Ademi dhe Sekiraqa, e kanë pranuar fajësinë për këtë vepër në seancën fillestare të mbajtur më 24 janar 2020.¹⁴⁹

PSRK-ja akuzonte Venera Ademin dhe Ermira Sekiraqën se me paramendim dhe me dashje ishte larguar nga Kosova me qëllim që t’i bashkëngjitet organizatës terroriste ISIS në Siri, dhe kanë kontribuar në pikëpamje logjistike që të mbështesin luftëtarët e ISIS-it.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PSRK-ja më 21 gusht 2016 kishte filluar hetimet ndaj të pandehurave Venera Ademi dhe Ermira Sekiraqa, për shkak të dyshimit të arsyeshëm se kanë kryer veprat penale organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste.

Më 14 dhjetor 2017, kjo prokurori ka nxjerrë vendim për pezullimin e hetimeve, me arsyetimin se nuk ishte siguruar prezenca e të pandehurave në procedurë. Këto hetime janë rifilluar më 23 prill 2019, pasi ishin eliminuar këto pengesa.

Aktakuza ndaj Venera Ademi dhe Ermira Sekiraqa ishte ngritur më 20 dhjetor 2019.

Seanca fillestare ndaj tyre ishte mbajtur më 24 janar 2020, ndërsa shpallja e aktgjykimit ishte bërë më 27 janar.

Ky gjykim ka zgjatur 39 ditë, nga ngritja e aktit akuzues e deri me shpalljen e vendimit në shkallë të parë.

¹⁴⁸ “Dy vjet burg me kusht për dy të akuzuarat që pranuan se ishin pjesë e ISIS-it”. Betimi për Drejtësi. 27 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dy-vjet-burg-me-kusht-per-dy-te-akuzuarat-qe-pranuan-se-ishin-pjese-e-isis-it/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

¹⁴⁹ “Dy të akuzuarat pranojnë se ishin pjesë e ISIS-it, thonë se gabuan që shkuan në Siri”. Betimi për Drejtësi. 24 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dy-te-akuzuarat-pranojne-se-ishin-pjese-e-isis-it-thone-se-gabuan-qe-shkuan-ne-siri/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

19. Dy vjet burg me kusht ndaj të akuzuarës që tha se në Siri kishte shkuar për ta kthyer djalin në Kosovë

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.79/19

Vepra penale: “*Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist*”,

Gjykatësja: Albina Shabani-Rama

Prokurore: Fikrije Fejzullahu

E pandehura: Fikrije Lutfiu

Gjykata Themelore në Prishtinë më 13 shkurt 2020 e ka dënuar me dy vjet burgim me kusht të akuzuarën për pjesëmarrje në grupin terrorist, ISIS, Fikrije Lutfiu. Afati i verifikimit është caktuar në kohëzgjatje prej tre viteve.¹⁵⁰

Paraprakisht, e akuzuara Lutfiu, në seancë fillestare e kishte pranuar fajësinë për këtë veprë penale.¹⁵¹

PSRK-ja e akuzon Lutfiun se në shtator 2014, me dashje, me vetëdije të plotë e ka lëshuar Kosovën, me destinacion Sirinë, me qëllim që t’i bashkëngjitet organizatës terroriste ISIS, nga e cila organizatë e akuzuara është financuar rregullisht me një shumë të hollash prej 50 eurove në muaj.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PSRK-ja më 29 shtator 2017 nga DKT e Policisë së Kosovës kishte pranuar kallëzimin penal të ushtruar ndaj të pandehurës Fikrije Lutfiu.

Aktakuza ndaj Lutfiut është ngritur më 31 dhjetor 2019, për shkak të veprës penale të organizimit apo pjesëmarrjes në grupe terroriste.

Seanca fillestare ndaj të akuzuarës për terrorizëm është mbajtur më 10 shkurt 2020, ndërsa shpallja e aktgjykimit ndaj saj është bërë tre ditë më vonë, më 13 shkurt të këtij viti.

Ky proces gjyqësor, që nga ngritja e aktit akuzues e deri me nxjerrjen e vendimit në shkallë të parë ka zgjatur plot 45 ditë.

¹⁵⁰ “Dy vjet burg me kusht ndaj të akuzuarës që tha se në Siri kishte shkuar për ta kthyer djalin në Kosovë”. Betimi për Drejtësi. 13 shkurt 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dy-vjet-burg-me-kusht-ndaj-te-akuzuares-qe-tha-se-ne-siri-kishte-shkuar-per-ta-kthyer-djalin-ne-kosove/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

¹⁵¹ “E akuzuara e pranon fajësinë, por thotë se në Siri shkoi për ta rikthyer djalin në Kosovë dhe jo për qëllime tjera”. Betimi për Drejtësi. 10 shkurt 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/e-akuzuara-e-pranon-fajesine-por-thote-se-ne-siri-shkoi-per-ta-rikthyer-djalin-ne-kosove-dhe-jo-per-qellime-tjera/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

20. Dënim i kushtëzuar ndaj të akuzuarës për pjesëmarrje në grupet terroriste

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.6/20

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”,

Gjykatësja: Shadije Gërguri

Prokurori: Haki Gecaj

E pandehura: Valbona Berisha

Gjykata Themelore në Prishtinë më 13 shkurt 2020 ka shqiptuar dy vjet burgim me kusht ndaj të akuzuarës për terrorizëm, Valbona Berisha. Ky dënim me kusht nuk do të ekzekutohet nëse e akuzuara Berisha nuk kryen veprë të re penale brenda një afati trevjeçar.¹⁵²

E akuzuara Berisha, në seancën fillestare të 12 shkurtit 2020 e kishte pranuar fajësinë për këtë veprë penale.¹⁵³

PSRK-ja e akuzonte Berishën se me qëllim për t’iu bashkëngjitur grupeve terroriste ISIS dhe Al-Nusra në Siri dhe Irak, më 26 shtator 2014, është larguar nga Kosova, së bashku me dy fëmijët e saj dhe bashkëshortin.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PSRK-ja më 2 tetor 2017 ka pranuar kallëzimin penal nga DKT e Policisë së Kosovës të ushtruar ndaj Valbona Berishës.

Më datën 23 prill 2019, PSRK-ja ka nxjerrë vendim për fillimin e hetimeve kundër Berishës, për shkak të veprës penale organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste.

Kjo prokurori, pas ndërmarrjes së veprimeve hetimore, më 20 janar 2020, ka ngritur aktakuzën ndaj Berishës për veprën e lartcekur.

Shqyrtimi fillestar ndaj Berishës është mbajtur më 12 shkurt 2020, ndërsa shpallja e aktgjykimit në shkallë të parë është bërë më 13 shkurt.

Kohëzgjatja e këtij gjykimi, që nga ngritja e aktakuzës e deri në shpalljen e vendimit ka qenë 25 ditë.

¹⁵² “Dënim i kushtëzuar ndaj të akuzuarës për pjesëmarrje në grupet terroriste”. Betimi për Drejtësi. 13 shkurt 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denim-i-kushtezuar-ndaj-te-akuzuares-per-pjesemarrje-ne-grupet-terroriste/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

¹⁵³ “E akuzuara e pranon fajin, thotë në Siri shkoi me insistimin e burrit të saj”. Betimi për Drejtësi. 12 shkurt 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/e-akuzuara-e-pranon-fajin-thote-ne-siri-shkoi-me-insistimin-e-burrit-te-saj/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

Rasti 21. Dënim i kushtëzuar ndaj të akuzuarës që pranoi fajësinë për terrorizëm

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.2/20,

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”,

Gjykatësja: Shadije Gërguri

Prokurori: Atdhe Dema

E pandehura: Valmira Kelmendi

Gjykata Themelore në Prishtinë më 24 shkurt 2020 ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarës për terrorizëm Valmira Kelmendi dhe atë e ka dënuar me dy vjet burgim me kusht.¹⁵⁴

Në seancën fillestare të 19 shkurtit, e akuzuara Kelmendi ishte deklaruar fajtores për këtë veprë.¹⁵⁵

PSRK e akuzon Valmira Kelmendin se ajo më 30 mars 2015, duke vepruar me dashje dhe dijëni, së bashku me bashkëshortin e saj, Minator Brahim, kishin udhëtuar për në Siri me qëllim të pjesëmarrjes në veprimtarinë e grupit terrorist ISIS.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PSRK-ja më 27 korrik 2015 kishte pranuar kallëzimin penal të ngritur nga DKT e Policisë së Kosovës ndaj Valmira Kelmendit.

Më 3 gusht 2015, kjo prokurori kishte filluar hetimet kundër Kelmendit, ndërsa këto hetime më 25 mars 2016 ajo i ka pezulluar, ngase e pandehura nuk ishte e arritshme për organet e ndjekjes.

Rifillimin e hetimeve kjo prokurori e ka bërë më 23 prill 2019, pas eliminimit të pengesave, ndërsa më 13 janar 2020, PSRK-ja ka ngritur aktakuzë ndaj Kelmendit për pjesëmarrje në grupe terroriste.

Seanca fillestare në këtë rast ishte mbajtur më 19 shkurt 2020, ndërsa shpallja e aktgjykimit ishte bërë më 24 shkurt.

Ky gjykim ka zgjatur 43 ditë kur marrim parasysh ngritjen e aktit akuzues e deri në nxjerrjen e vendimit nga gjykata e shkallës së parë.

¹⁵⁴ “Dënim i kushtëzuar ndaj të akuzuarës që pranoi fajësinë për terrorizëm”. Betimi për Drejtësi. 24 shkurt 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denim-i-kushte-zuar-ndaj-te-akuzuares-qe-pranoi-fajesine-per-terrorizem/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

¹⁵⁵ “E akuzuara pranon fajësinë, thotë se s’ dëshiroi të ndahej nga burri për shkuarjen në Siri”. Betimi për Drejtësi. 19 shkurt 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/e-akuzuara-pranon-fajesine-thote-se-sdeshiroi-te-ndahej-nga-burri-per-shkuarjen-ne-siri/>). (Qasur së fundmi më 21 prill 2020).

Rasti 22. Dy vjet burg me kusht ndaj të akuzuarës për pjesëmarrje në grupin terrorist

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.7/20

Vepra penale: “*Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist*”,

Gjykatësja: Valbona Selimaj

Prokurore: Fikrije Fejzullahu

E pandehura: Ajnisha Abazi.

Gjykata Themelore në Prishtinë më 24 shkurt 2020, ka shqiptuar dy vjet burgim me kusht ndaj të akuzuarës për pjesëmarrje në grupin terrorist, Ajnisha Abazi. Periudha verifikuese është tri vjet.¹⁵⁶

Paraprakisht, e akuzuara Abazi, në seancë fillestare ishte deklaruar fajtores për këtë veprë.¹⁵⁷

PSRK-ja e akuzonte Abazin se në nëntor 2015, ishte larguar nga Kosova për në Siri, me qëllim që t'i bashkëngjiten organizatës terroriste ISIS, dhe nga kjo organizatë është financuar rregullisht me një shumë të hollash prej 50 euro në muaj.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

DKT e Policisë së Kosovës më 26 shtator 2017 kishte paraqitur në PSRK kallëzimin penal të ushtruar ndaj Ajnisha Abazi.

Kjo prokurori më 20 gusht 2018 kishte nxjerr vendim për fillimin e hetimeve ndaj Abazit në drejtim të veprës penale “organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste”.

PSRK-ja më 27 janar 2020 ka ngritur aktin akuzues ndaj Abazit në drejtim të veprës penale të lartëcekur.

Seanca fillestare ndaj Abazit është mbajtur më 20 shkurt 2020, ndërsa shpallja e aktgjykimit është bërë më 24 shkurt të këtij viti.

Ky gjykim, që nga ngritja e aktit akuzues e deri me shpalljen e vendimit nga gjykata e shkallës së parë, ka zgjatur 29 ditë.

¹⁵⁶ “*Dy vjet burg me kusht ndaj të akuzuarës për pjesëmarrje në grupin terrorist*”. Betimi për Drejtësi. 24 shkurt 2020. (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dy-vjet-burg-me-kusht-ndaj-te-akuzuares-per-pjesemarrje-ne-grupin-terrorist/>). (Qasur së fundmi më 22 prill 2020).

¹⁵⁷ “*E kthyer nga Siria: E ndjej veten shumë fajtores për veprën që e kam bërë*”. Betimi për Drejtësi. 20 shkurt 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/e-kthyer-nga-siria-e-ndjej-veten-shume-fajtores-per-vepren-qe-e-kam-ber/>). (Qasur së fundmi më 22 prill 2020).

Rasti 23. Dy vjet burg i kushtëzuar ndaj të akuzuarës që pranoi se ishte pjesë e ISIS-it

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.78/19,

Vepra penale: “Organizimi dhe pjesëmarrja në grup terrorist”,

Gjykatësi: Musa Konxheli

Prokurore: Florije Salihu-Shamolli

E pandehura: Qëndresa Sfishta

Gjykata Themelore në Prishtinë më 9 janar 2020 e ka dënuar me dy vjet burgim me kusht të akuzuarën për terrorizëm, Qëndresa Sfishta. Afati i verifikimit është caktuar të jetë tri vjet.¹⁵⁸

Paraprakisht, e akuzuara Sfishta, në këtë seancë fillestare kishte pranuar fajësinë për këtë veprë penale.

PSRK-ja e akuzonte Sfishtën se me dashje ka marrë pjesë në veprimtarinë e organizatës terroriste, duke shkuar nga Kosova për në Siri, ku i është bashkëngjitur organizatës terroriste, militante, ekstremiste ISIS, dhe i ka ofruar shërbime logjistike bashkëshortit të saj.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

PSRK-ja më 28 shtator 2017 kishte pranuar kallëzimin penal ndaj të pandehurës Sfishta nga DKT e Policisë së Kosovës.

Më 5 shkurt 2018, PSRK ka filluar ndërmarrjen e veprimeve hetimore ndaj të pandehurës Sfishta, për veprën penale organizimi dhe pjesëmarrja në grupe terroriste.

Më 18 dhjetor 2018, gjykata ka lëshuar urdhërarrest për të pandehurën, sipas kërkesës së prokurorisë. Me arsyetimin se e pandehura ndodhej në Siri, kjo prokurori më 5 shkurt 2018 kishte pezulluar hetimet, ndërsa rifillimin e tyre e ka bërë më 23 prill 2019.

Aktakuza për terrorizëm ndaj Qëndresa Sfishta ishte ngritur më 30 dhjetor 2019.

Seanca fillestare ishte mbajtur më 9 janar 2020, dhe po të njëjtën ditë gjykata kishte bërë shpalljen e aktgjykimit.

Ky proces gjyqësor ka zgjatur 11 ditë, që nga ngritja e aktakuzës e deri në nxjerrjen e vendimit në shkallë të parë.

¹⁵⁸ “Dy vjet burg i kushtëzuar ndaj të akuzuarës që pranoi se ishte pjesë e ISIS-it”. Betimi për Drejtësi, 9 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dy-vjet-burg-i-kushtezuar-ndaj-te-akuzuares-qe-pranoi-se-ishte-pjese-e-isis-it/>). (Qasur së fundmi më 22 prill 2020).

Rasti 24. Dënohet me tre vjet burg me kusht e akuzuara se ofroi shërbime logjistike për ISIS-in

GjTh në Prishtinë

Numri i lëndës: PS.nr.1/20,

Vepra penale: *“Bashkimi apo pjesëmarrja në ushtrinë ose policinë e huaj, në formacionet e jashtme paraushtarake ose para policore, në organizimet grupore apo individualisht jashtë territorit të Republikës së Kosovës”*,

Gjykatësi: Valon Kurtaj

Prokurore: Merita Bina-Rugova,

E pandehura: Mimoza Tahiri

Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë e ka dënuar me tri vjet burgim me kusht të akuzuarën për vepra që lidhen me terrorizmin, Mimoza Tahiri. Ky dënim nuk do të ekzekutohet nëse ajo nuk kryen vepër tjetër penale brenda tri viteve.¹⁵⁹

Paraprakisht, e akuzuara Tahiri në shqyrtim fillestar kishte pranuar fajësinë për këtë vepër.

PSRK-ja e akuzonte Tahirin se në qershor të vitit 2014, ishte larguar nga Kosova në drejtim të Sirisë, ku i është bashkëngjitur organizatës terroriste “ISIS” dhe ka marrë pjesë në veprimtarinë e kësaj organizate.

Gjetjet e IKD-së lidhur me trajtimin e rastit

DKT e Policisë së Kosovës më 26 shtator 2017 ka ushtruar kallëzimin penal kundër të pandehurës Mimoza Tahiri, në drejtim të veprës penale të lartcekur në PSRK.

Më 2 tetor 2017, PSRK-ja kishte filluar të ndërmarrë veprime hetimore kundër të pandehurës Tahiri, por që ky hetim, më 20 dhjetor 2017 ishte pezulluar me arsyetimin se e pandehura ndodhej në Siri, dhe ishte e paarritshme për organet e drejtësisë.

Aktakuza ndaj Tahirit për bashkime apo pjesëmarrje në ushtrinë ose policinë e huaj është ngritur më 8 janar 2020 nga PSRK.

Seanca fillestare ndaj saj është mbajtur më 24 janar 2020, ndërsa shpallja e aktgjykimit është bërë tre ditë më vonë, më 27 janar.

Ky gjykim, që nga ngritja e aktakuzës e deri me shpalljen e vendimit në shkallë të parë ka zgjatur 20 ditë. Sipas aktgjykimit të shpallur, të akuzuarës Tahiri i ishte shqiptuar dënimi me kusht në kohëzgjatje prej tre viteve.

¹⁵⁹ “Dënohet me tre vjet burg me kusht e akuzuara se ofroi shërbime logjistike për ISIS-in”. Betimi për Drejtësi. 27 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-tre-vjet-burg-me-kusht-e-akuzuara-se-ofroi-sherbime-logjistike-per-isis-in/>). (Qasur së fundmi më 22 prill 2020).

18.Përfundimet

- Duke marrë parasysh se sistemi i drejtësisë në Kosovë ka kaluar nëpër etapa të ndryshme dhe se në sistemin e drejtësisë kanë pasur autorizime të mëdha misionet e ndryshme ndërkombëtare, UNMIK dhe EULEX, ka bërë që të ndikoj që të shpërndahet edhe mos përgjegjësia e mos efikasitetit si në drejtësinë e këtyre institucioneve ndërkombëtare, ashtu edhe në ato vendore.
- Edhe pse Kosova kishte themeluar Prokurorinë Speciale në vitin 2008, me të cilin veprim synohej që të luftoheshin krimet e rënda, rezultatet gjatë gjithë këtyre viteve kanë treguar se kjo gjë nuk është arritur ashtu siç është pritur.
- KPK gjatë viteve 2016-2019, ka dështuar të rris numrin e prokurorëve të PSRK-së, pasi gjatë këtyre viteve, nga 10 prokurorë sa ishin në vitin 2016, janë shtuar vetëm katër (4) prokurorë.
- Për më tepër, kjo ngritje e numrit të prokurorëve ka rezultuar edhe me ulje të efikasitetit të punës së kësaj prokurorie, pasi gjatë viteve 2016-2019, kjo prokurori nuk ka arritur asnjëherë që të zgjidh më shumë se 31.89% sa i kishte zgjidhur në vitin 2016. Pas vitit 2016, në raport me lëndët në punë me ato të zgjidhura ka pasur gjithmonë e më shumë rënie të efikasitetit të lëndëve të zgjidhura, pasi në vitin 2017 ishin zgjidhur vetëm 29.58% e lëndëve, në vitin 2018 13.06% ndërsa në vitin 2019, 17.89%.
- Gjatë viteve 2016-2019, PSRK në total për katër (4) vite ka zgjidhur vetëm 1,018 lëndë, ndërsa në fund të vitit 2019 kanë mbetur të pa zgjidhura edhe 1,799 lëndë.
- Me tempon e zgjidhjes së lëndëve si në vitin 2019, pa pranuar lëndë të reja, në mënyrë që të zgjidhen lëndët e pa zgjidhura duhet të kalojnë afërsisht pesë (5) vite.
- Nëse analizojmë trendin e zgjidhjes së lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranuar, atëherë i bie se në PSRK, gjendja me lëndë vetëm sa do të përkeqësohet, dhe sipas kësaj tempo, nuk do të ketë stabilizim.
- Edhe pse sipas statistikave të PSRK-së, shumica e aktakuzave të kësaj prokurorie përfundojnë me aktgjykime dënuese, një gjë e tillë nuk rezulton edhe me aktakuzat e PSRK-së ndaj zyrtarëve të profilit të lartë të cilët akuzohen për vepra penale korruptive, në të cilat përfshihen pesë (5) kryetar komunash, katër (4) ministra, një (1) kryetar gjykate dhe një (1) kryetari OSHP-së. Sipas të dhënave të IKD-së, nga 11 aktakuza ndaj zyrtarëve të profilit të lartë të ngritura në këtë periudhë raportuese, asnjëra nga to nuk kanë përfunduar me aktgjykim dënues. Në këto raste janë shqiptuar dy (2) aktgjykime liruese, tre (3) refuzuese, ndërsa gjashtë (6) aktakuza janë hedhur pa filluar shqyrtimi gjyqësor. Vendimet e tilla dëshmojnë dështimin e kësaj prokurorie në ndjekjen e zyrtarëve të profilit të lartë.
- PSRK-ja ashtu si në rastet e dështimit të aktakuzave për korrupsion e krim të organizuar ndaj profilit të lartë, ka dështuar edhe në rastet e shënjestruara, pasi në bazë të dy raporteve periodike të IKD-së, edhe pse koordinator i këtyre rasteve është kryeprokurori i PSRK-së, shënjestrimi i rasteve është bërë duke i shkelur Procedurat Standarde të Veprimit, që vetë sistemi prokurorial i ka përcaktuar, duke shënjestruar raste që nuk trajtohen si krime të rënda, ku të dyshuar janë kryesisht persona të profilit të ulët dhe në të cilat raste mundësia e sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme është shumë e vogël, ndërsa nuk ka shënjestruar raste për të cilat mundësia për të konfiskuar pasuri të fituar me vepër penale është më e madhe.

- Edhe pse PSRK në vitin 2016 kishte themeluar një departament të veçantë për hetimin e krimeve të luftës, ky departament gjatë viteve 2016-2019 ka zgjidhur vetëm 196 lëndë, nga të cilat lëndë kanë ngritur vetëm 11 aktakuza, ndërsa në fund të vitit 2019 kanë mbetur të pa zgjidhura edhe 1,166 lëndë.
- PSRK gjatë vitit 2019 nuk ka treguar transparencë në kërkesat për qasje në dokumentet zyrtare dhe informata që ka bërë IKD, pasi në 19 kërkesa për qasje në dokumente publike dhe informata, të parashtruara sipas Ligjit për Qasje në Dokumente Publike, është përgjigjur pozitivisht vetëm për gjashtë (6) prej tyre, 11 të tjera nuk kanë marrë fare përgjigje, ndërsa dy kanë qenë përgjigje negative.
- Edhe pse Kosova e kishte themeluar Prokurorinë Speciale në vitin 2008, nga ajo kohë e deri në vitin 2019 nuk ekzistonte një gjykatë e nivelit të njëjtë. Kjo ishte bërë vetëm pas hyrjes në fuqi të Ligjit për Gjykatat në të cilin ishte përcaktuar themelimi i Departamentit Special në shkallë të parë në GjTh Prishtinë dhe në Gjykatë të Apelit si shkallë e dytë, të cilat janë funksionalizuar në korrik të vitit 2019.
- Deri në fillimin e punës së këtyre departamenteve, KGJK kishte vepruar në kundërshtim me rregullat që vet i kishte përcaktuar. Më 23 prill 2019, KGJK edhe pse nuk e kishte diskutuar gjatë mbledhjes, kishte marrë vendim për shpalljen e konkursit për 15 gjykatës, pa specifikuar pozitën. Ndërsa, edhe pse me vendim ishte përcaktuar që të shpallet konkursi për këto 15 pozita, ai ishte shpallur vetëm për 12 gjyqtarë, mirëpo edhe pse në shkallën e parë konkursi ishte shpallur për nëntë (9) pozita në DS të GjTh në Prishtinë dhe tri (3) pozita në GjA, KGJK kishte emëruar vetëm gjashtë (6) gjyqtarë në DS të GjTh në Prishtinë. Tërë këtë proces, kryesuesi i KGJK-së Skender Çoçaj, e arsyeton me faktin se kjo është bërë për shkak se ka qenë hera e parë e themelimit të një departamenti të tillë dhe se gjatë muajve në vazhdim do të rritet edhe numri i gjyqtarëve. Sfidë për numrin e ulët të gjyqtarëve në këto departamente e konsiderojnë edhe udhëheqësit e këtyre departamenteve, Valon Kurtaj në shkallë të parë dhe Vatton Durguti në shkallë të dytë.
- Gjatë viti 2019, Departamenti Special në GjTh Prishtinë ka pranuar 79 lëndë, prej të cilave janë zgjidhur vetëm tetë (8), derisa nëntë (9) të tjera janë dërguar në kompetencë brenda në gjykatë, ndërsa të pa zgjidhura kanë dhe të bartura për vitin 2020 kanë mbetur 62 lëndë.
- Bazuar në monitorimin e IKD-së në Departamentin Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, gjatë kësaj periudhe raportuese rezultoi se nga 11 raste me 13 persona, janë shpallur 13 aktgjykime dënuese, ndërsa nuk ka pasur asnjë aktgjykim lirues apo refuzues. Nga këto 13 aktgjykime dënuese, shtatë (7) prej tyre janë dënime me burgim efektiv, gjashtë (6) dënime me burgim me kusht dhe tre (3) dënime me gjobë. Dënimi më i lartë i shqiptuar nga ky departament është pesë (5) vite e gjashtë (6) muaj burgim dhe 500 euro gjobë.
- Sa i përket afateve ligjore, Departamenti Special ka arritur që në masë të madhe të procedojë me kohë me lëndët që kanë qenë objekt shqyrtimi, duke marrë parasysh faktin se gjyqtarët e këtij departamenti kanë pasur një numër jo aq të madh të lëndëve në punë gjatë kësaj periudhe raportuese, gjë që tregon se themelimi i këtij departamenti deri tani ka treguar rezultat pozitiv në zgjidhjen e këtyre lëndëve.
- IKD që nga themelimi i Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë e deri në mars të vitit 2020, ka monitoruar gjithsej 25 raste të terrorizmit, prej të cilave 28 persona janë të akuzuar, nga të cilët gjashtë (6) persona i takojnë gjinisë mashkullore, ndërsa 22 persona të tjerë i takojnë gjinisë femërore.

Krimet Speciale – Ligji vs Praktika

- Gjatë kësaj periudhe raportuese, Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë ka shqiptuar aktgjykime dënuese ndaj 25 personave, ndërsa nuk kanë shqiptuar asnjë aktgjykim lirues apo refuzues. Prej këtyre 25 aktgjykimeve dënuese, pesë (5) persona janë dënuar me burgim efektiv, 20 persona janë dënuar me kusht, dhe ndaj një (1) personi krahas dënimit me burg, është shqiptuar edhe dënimi me gjobë.
- Nga gjithsej 22 gra të akuzuara për vepra terroriste në Departamentin Special, vetëm dy (2) prej tyre ishin deklaruar të pafajshme, ndërsa 20 prej të tjera kishin pranuar fajësinë për vepra që lidhen me terrorizmin.
- Ndaj 19 grave të akuzuara për pjesëmarrje në grupe terroriste, gjyqtarët e DS shqiptuar dënim me kusht në kohëzgjatje prej dy vitesh.
- Departamenti i Gjykatës së Apelit, që nga funksionalizimi i tij e deri më 31 dhjetor 2019, kishte pranuar në punë 17 lëndë, prej të cilave shtatë (7) i kishte zgjidhur, ndërsa kishin mbetur të pazgjidhura 10 lëndë, ndërsa kjo gjykatë nuk ka treguar për mënyrën e zgjidhjes së tyre.

19.Rekomandimet

- KPK të trajtojë me prioritet absolut punën e PSRK-së, duke marrë parasysh shkallën jo të kënaqshme të ndjekjes penale të veprave më të rënda penale.
- KPK ta rris numrin e prokurorëve të PSRK-së, me qëllim të procedimit më të shpejtë dhe më me efikasitet të lëndëve që janë pjesë e kësaj prokurorie.
- KPK të bëjnë një analizë gjithëpërfshirëse të ngarkesës së PSRK-së me lëndë, në mënyrë që të ulët numri i lëndëve të pazgjidhura.
- KGJK dhe KPK të ri analizojnë rregulloret mbi normat orientuese, në mënyrë që të krijohen indikatorë të saktë mbi matjen e efikasitetit të secilit gjyqtar dhe prokurorë.
- KGJK dhe KPK të harmonizojnë bazat e të dhënave të tyre në mënyrë që këto institucione të kenë të dhëna unike dhe të informohet publiku në baza mujore për progresin dhe sfidat në e DKR-ve të Gjykatave dhe Prokurorive.
- KGJK dhe KPK të marrin masa ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, të cilët nuk respektojnë afatet ligjore në trajtimin e rasteve.
- KGJK dhe KPK të publikojnë raporte mujore dhe vjetore mbi përfomancën e gjykatësve të DS dhe prokurorëve të PSRK-së, në mënyrë që publiku të informohet në baza të rregullta për efikasitetin e tyre.
- PSRK-ja të trajtojë me seriozitet të shtuar aktakuzat për korrupsion e veçanërisht atë të profilit të lartë dhe në këtë mënyrë të mos lejoj që asnjë aktakuzë e profilit të lartë të mos vërtetohet nga gjykata.
- Kryeprokurori i PSRK-së, në mënyrë që të siguroj një luftë më efektive të kompetencave të veçanta dhe plotësuese të prokurorëve të kësaj prokurorie, duhet që sa më shpejt të bëjë profilizimin e prokurorëve.
- Kryeprokurori i PSRK-së të ndërmer hapa konkret që të ndalohet praktika e mos përgjigjes së kërkesave për qasje në dokumente zyrtare dhe informata dhe në këtë mënyrë të jetë transparente për publikun, mediat dhe shoqërinë civile.
- Prokuroret e PSRK-së dhe gjykatësit e departamenteve speciale, të respektojnë në vazhdimësi afatet ligjore veçanërisht në rastet të cilat janë me prioritet.
- Gjykatësit e Departamentit Special të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të ushtrojnë një praktikë unike të aktgjykimeve dënuese, duke respektuar dispozitat e Kodit Penal, të Procedurës Penale dhe Udhëzuesit për Politikë Ndëshkimore të Gjykatës Supreme.